



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 494 Akti

Nr. 689 Vendimi
Tiranë, më 24.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Steven Kessler, në datën 20.7.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ervin Pollozhani**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr.

76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bektoshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.6.2020, u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

➤ *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë nr. *** prot., datë 16.10.2018.

- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 30.6.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kritere për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 30.6.2023 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 3.7.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve në datën 14.7.2023, dorëzuar në protokollin e Komisionit, si dhe në rrugë elektronike, me *email*.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 17.7.2023.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 20.7.2023, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

17.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur e parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

² Raporti mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 31.10.2017.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 23.11.2021.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Ervin Pollozhani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

18.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga

⁴“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuara në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

21.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.

21.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

22. Pasuria e paluajtshme e llojit banesë (apartament), përfituar me kontratën e shitblerjes së datës 12.7.2016, me vlerë 120,000 euro. Subjekti ka deklaruar se shuma prej 120,000 euro është likuiduar totalisht, nga e cila 108,000 euro është paguar në datën 22.9.2014, me lidhjen e kontratës nëpërmjet transfertës në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. (pala shitëse) dhe 12,000 euro është paguar në datën 2.3.2016 nga llogaria bankare e bashkëshortes, menjëherë me hartimin e procesverbalit të dorëzimit të apartamentit.

22.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm. Evidentohet se në këtë deklaratë subjekti ka pasqyruar në mënyrë kronologjike të gjitha transaksionet e kryera për blerjen e kësaj pasurie, si dhe për pasurinë e mëparshme të shitur, duke referuar dhe burimin e krijimit të saj.

22.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite

- Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë shitblerjeje (paraprake) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2014, e noteres A. Gj, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Ervin Pollozhani, A.P, me vlerë 120,000 euro, nga të cilat 108,000 euro të paguara menjëherë me lidhjen e kontratës me anë të transfertës në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe 12,000 euro do të paguheshin në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes. Zotëron 50% të pjesë takuese.”*

- Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë përfundimtare shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.7.2016, e noteres A.Gj, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Ervin Pollozhani, A.P. Shuma 120,000 euro e likuiduar tërësisht, ku 108,000 euro janë paguar menjëherë në datën 22.9.2014, me lidhjen e kontratës shitblerjeje (paraprake) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2014, e noteres A.Gj, me anë të transfertës në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe 12,000 euro janë paguar në datën 2.3.2016, nga llogaria personale bankare, menjëherë me hartimin e procesverbalit të dorëzimit të apartamentit. Shuma 120,000 euro (50% + 50% me bashkëshorten).”*

22.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e institucioneve.

22.4 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe pagesat e kryera në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së saj⁵, Komisioni konstaton se:

i) Në datën 22.9.2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja A.P, në cilësinë e palës blerëse, kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes (paraprake)⁶ me shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt shitblerjen e pasurisë së llojit apartament banimi, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 113.32 m², sipërfaqe neto 99.17 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 14.15 m², në objektin e ndërtuar/që po ndërtohej nga shoqëria e sipërcituar në rrugën “****”, Tiranë, për çmimin 120,000 euro.

Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar plani i pagesave si vijon: (a) 108,000 euro do t'i paguhet shitësit pas nënshkrimit të kësaj kontrate nëpërmjet Credins Bank, në numrin e llogarisë së shoqërisë “****” sh.p.k.; (b) 12,000 euro do të likuidohen me nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitjes nëpërmjet numrave të llogarisë që ka shoqëria “****”, të specifikuara në kontratë.

ii) Po në datën 22.9.2014, nga llogaria e personit të lidhur në Credins Bank është transferuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shuma prej 108,000 euro, me përshkrimin “**** sh.p.k., pagesë blerjeje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., A.P”.

iii) Në datën 1.3.2016, mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori M.D, është nënshkruar dokumenti noterial “Procesverbal dorëzim apartamenti”⁷, në referim të të cilit shoqëria “****” sh.p.k. u dorëzon të përfunduar e me çelësa në dorë porositësve Ervin Pollozhani dhe A.P apartamentin nr. *** , të ndodhur në katin e *** të banimit (kati *** nga toka), kuota + 20.80, me sipërfaqe 113.32 m², nga e cila 99.17 m² sipërfaqe shfrytëzimi dhe 14.15 m² sipërfaqe pjesë takuese në ambientet e përbashkëta. Gjithashtu, në këtë procesverbal është përcaktuar se: (a) porositësit marrin në dorëzim apartamentin me të dhënat e sipërcituara, duke deklaruar se janë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale dypalëshe për këtë apartament; (b) porositësit marrin përsipër me vullnetin e tyre dhe mirëkuptim me njëri-tjetrin që detyrimin e tyre të pashlyer dhe që lidhet me këstin e dytë të kontratës së shitjes paraprake nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2014, nenet 5/a dhe 8 të saj në vlerën 12,000 euro, do ta shlyejnë menjëherë pas nënshkrimit të këtij procesverbali në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., sipas përcaktimeve të bëra në këtë kontratë.

iv) Në datën 2.3.2016, nga llogaria e personit të lidhur pranë Credins Bank është transferuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shuma prej 12,000 euro, me përshkrimin “**** sh.p.k., kalim sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol.”.

⁵ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në Aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) dokumentacioni i përcjellë me *email*-in e datës 12.10.2018 nga zyra e regjistrimit të pasurive, pjesë e hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja, ndodhur në Aneksin ***; (iii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Jug me nr. *** prot., datë 5.11.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.11.2020); (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni; (v) shkresa e Credins Bank me nr. *** prot., datë 25.12.2020, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 30.12.2020.

⁶ Dokumenti, “Kontratë shitblerjeje (paraprake)” nr. *** rep., nr. *** kol, datë 22.9.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. A.Gj .

⁷ Dokumenti noterial “Procesverbal dorëzim apartamenti” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. A.Gj .

v) Në datën 12.7.2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e palës blerëse, nënshkruajnë kontratën përfundimtare të shitblerjes⁸ me shoqërinë “****” sh.p.k, në cilësinë e palës shitëse, me objekt shitblerjen e pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sipërfaqe neto prej 99.7 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

Në këtë kontratë është referuar çmimi i shitjes së kësaj pasurie në shumën prej 120,000 euro (neni 3 i kontratës), duke u evidentuar se: (1) blerësit deklaruan se çmimi i kësaj kontrate është likuiduar nga blerësit në favor të shitësit, sipas kontratës së shitjes (paraprake) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2014, notere A. Gj, Tiranë dhe procesverbal dorëzim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2016, notere A.Gj , Tiranë; (2) shitësi deklaroi se çmimin e kësaj kontrate e ka marrë dhe është likuiduar nga blerësit sipas kontratës së shitjes (paraprake) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2014, notere A.Gj , Tiranë dhe “Procesverbal dorëzim apartamenti” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2016, notere A.Gj , Tiranë.

vi) Pas nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes, kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë (sot ASHK) në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, duke u lëshuar në datën 14.7.2016 dokumenti “Certifikatë për vërtetim pronësie”, nr. ***.

22.4.1 Verifikimet e kryera mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie

Siç u evidentua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm.

Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008, në deklarin e bërë veçmas, në cilësinë e pjesëtarit të familjes që mbart detyrimin për deklarin e pasurisë, bashkëshortja e subjektit, znj. A.P, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme” ka deklaruar: *“Kontratë sipërmarrjeje nr. *** kol., nr. *** rep., datë 18.9.2007, me shoqërinë “****” sh.p.k., për apartament me sipërfaqe 117 m², me vlerë 117,000 euro. Blerë me të ardhurat nga familja e saj, nga aktiviteti i tyre tregtar dhe nga kursimet familjare e personale si mjeke e përgjithshme”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit për këtë subjekt, Komisioni konstaton se në datën 18.9.2007, personi i lidhur, znj. A.Ç (mbiemri para martesë), ka porositur⁹ nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë e llojit apartament banimi, me sipërfaqe totale 117 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për shumën 117,000 euro. Referuar kontratës së sipërmarrjes për këtë pasuri, porositësi detyrohet të derdhë ditën e nënshkrimit të saj shumën prej 115,000 euro, që përfaqëson këstin e parë të apartamentit objekt kontrate, ndërsa shuma e mbetur prej 2,000 euro, që përfaqëson këstin e fundit, do të paguhet me marrjen e apartamentit në dorëzim, pas hipotekimit të apartamentit, duke shlyer kështu vlerën e plotë të tij (referojuni nenit 3 të kësaj kontrate).

- Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për porositjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, kanë shërbyer të ardhurat familjare nga aktiviteti i biznesit të familjes së bashkëshortes që prej vitit 1995 e në vijim (fillimisht regjistruar në emrin e bashkëshortes së tij dhe më pas në emrin e prindërve të saj) nga kursimet e familjes së bashkëshortes dhe të ardhurat personale të saj si mjeke e përgjithshme dhe si mjeke promocioni.

- Në DIPP-në e vitit 2011, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. (shitësi) dhe A.P e Ervin Pollozhani (blerësi) – në mbështetje të*

⁸ Kontratë shitjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.7.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. A.Gj .

⁹ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** kol., nr. *** rep., datë 18.9.2007, redaktuar nga noteri publik, z. A. M.

kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2007, të lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k. (sipërmarrësi) dhe A.Ç (porositësi), me vlerë 11,700,000 lekë”.

Rezulton se në datën 20.1.2012 është nënshkruar kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, ku në cilësinë e palës blerëse shfaqet subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në referim të së cilës palët kanë rënë dakord që prona do të shitet për çmimin 11,700,000 lekë dhe se kjo shumë është paguar plotësisht nga ana e blerësve tek shitësi përpara përpilimit të kësaj kontrate.

I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ¹⁰, duke i kërkuar të japë shpjegime mbi faktin e rezultuar se në kontratën përfundimtare të shitblerjes së këtij apartamenti paraqitet edhe ai në cilësinë e blerësit, ndërkohë që ka referuar se kjo pasuri është e krijuar nga bashkëshortja para martesë, me burim të ardhurat e familjes së saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...kjo ka ndodhur thjesht dhe vetëm me dakordësinë e A dhe dëshirën e saj që kjo pasuri të ishte pjesë e regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, pasi në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes të dy bashkëshortët jo vetëm që kishin krijuar familjen e tyre (lidhur martesë në datën 27.7.2008), por ishin trashëguar dhe me një djalë¹¹”.

Në datën 28.8.2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja e tij, shesin¹² apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për shumën 130,000 euro, së bashku me orenditë e tij. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se në datën 3.9.2014, nga llogaria e noterit publik L.Sh (K) është transferuar në llogarinë e personit të lidhur në Credins Bank¹³ shuma prej 130,000 euro, me përshkrimin “L.Sh PF kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.8.2014, P.A”. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie, siç u evidentua edhe më sipër, rezulton se këto fonde janë përdorur nga personi i lidhur për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie mbi mënyrën e fitimit, burimin e të ardhurave dhe pagesat e kryera në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së saj.

Në vijim të hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni¹⁴ mbi rrethanat e njohjes me bashkëshorten, fillimin e bashkëjetesës, mbi dijeninë e tij për porositjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007, si dhe mbi rrethanat të tjera që lidhen me transaksionet e kryera për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...njohja (prezantimi mes tyre) është bërë në një festë shoqërie të përbashkët në fundvitin 2005. Njohja familjare është bërë në mars të vitit 2007. Për faktin që të dy (si “subjekti i rivlerësimit” dhe A.Ç) kishin angazhime në qytete të ndryshme, takimet mes tyre ishin të rralla.

¹⁰ Pyetjet nr. 1/c) të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹¹ Ka referuar vendimin nr. 262, datë 17.10.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. E.P, ku ndër të tjera Komisioni është shprehur se: “Në përfundim, trupi gjykoës vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe përputhen me faktet e rezultuara gjatë hetimit. Pavarësisht se si bashkëpronare mbi këtë pasuri rezulton të jetë regjistruar edhe subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkak të procedurës së kryer në vitin 2011, për blerjen nga ALUIZNI të truallit në bashkëpronësi mes të gjithë pronarëve të apartamenteve të pallatit, kjo pasuri rezulton e blerë në vitin 2006 (para martesë) dhe se nuk mund të lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit, znj. E.P”.

¹² Kontratë shitjeje apartamenti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.8.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. L.Sh.K.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 25.12.2020, e Credins Bank, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 30.12.2020.

¹⁴ Referojuni pyetësorit nr. 4.

Ka filluar të bashkëjetojë me znj. A.Ç disa muaj pas martesës ligjore, konkretisht në muajin shtator 2008, kur A filloi punë në qytetin e Tiranës. Përpara muajit shtator 2008 midis “subjektit të rivlerësimit” dhe A.Ç nuk ka pasur bashkëjetesë qoftë dhe në periudha të shkurtra kohore, kjo për faktin se subjekti i rivlerësimit punonte gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe jetonte me prindërit në Tiranë dhe A.Ç punonte në qendrën shëndetësore B, Tropojë dhe jetonte me prindërit e saj në Bajram Curri.

*Negociatat dhe porositja e apartamentit në rrugën “***” është bërë nga A.Ç dhe i ati i saj. Sikurse është pohuar në përgjigje të pikës “b” të pyetjes 1 në pyetësin nr. 2, ky apartament është porositur për t’u përdorur nga ata si bazë mbështetëse në Tiranë... Ai nuk ka qenë në dijeni dhe as prezent në momentin e porositjes dhe negocimit të kësaj pasurie... Nuk ka biseduar paraprakisht me A.Ç apo prindërit e saj për blerjen e kësaj pasurie. Si A. Ç, edhe i ati i saj nuk janë konsultuar me të përpara porositjes së këtij apartamenti në shtator të vitit 2007, jo vetëm për faktin që ky apartament u porosit për vetë familjen Ç, jo vetëm për faktin që të dy jetonin e punonin fizikisht në distanca të largëta, por dhe për faktin që lidhja midis tij dhe A.Ç, pavarësisht prezantimit familjar, nuk ishte ende e konsoliduar në atë nivel, që çonte në domosdoshmërinë e marrjes bashkërisht midis tyre të nismave apo vendimeve.*

Nuk e ka vizituar objektin përpara porositjes së apartamentit nga A.Ç dhe as në momentin e porositjes së tij... E ka vizituar apartamentin vetëm pas martesës me A.Ç (korrik 2008). Në këtë kohë, apartamenti ka qenë i papërfunduar. Që pas këtij momenti, apartamenti është vizituar prej tij në vijim në mënyrë sporadike, deri në marrjen në dorëzim të tij (prill 2010).

Mënyra e likuidimit e shumës 115,000 euro është bërë cash nga bashkëshortja e “subjektit të rivlerësimit” dhe i ati i saj, cituar kjo (mënyra e likuidimit) edhe në kontratën e sipërmarrjes. Kjo vlerë disponohej cash nga ajo dhe prindërit e saj. Mënyra e krijimit të shumës prej 115,000 euro është shpjeguar e detajuar në përgjigje të pikës “b” të pyetjes 1 në pyetësin 2”.

22.4.2 Verifikimet e kryera nga Komisioni mbi porositjen e apartamentit të banimit nga personi i lidhur në vitin 2007 dhe të ardhurat e deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie.

Komisioni vëren se në vazhdimësi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka kontribut në blerjen e kësaj pasurie, pasi ajo është blerë para martesë me të ardhurat familjare të personit të lidhur, duke referuar se ata kanë lidhur martesë në datën 27.7.2008, dhe se bashkëjetesa e tyre ka nisur në muajin shtator të vitit 2008, pasi nga shkurti 2006 e deri në këtë periudhë personi i lidhur ka jetuar me prindërit e saj në qytetin e Bajram Currit, ku ka punuar si mjeke e përgjithshme¹⁵.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me personin e lidhur në datën 27.7.2008. Pra, rezulton e provuar se pasuria objekt verifikimi është porositur dhe paguar para lidhjes së martesës.

Në përgjigje të pyetësit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ subjekti ka parashtruar se nuk ka detyrim ligjor për të provuar burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 115,000 euro, të paguar nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007, për porositjen e apartamentit të banimit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë. Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka referuar pjesë nga vendime të Komisionit, Kolegjit dhe GJEDNJ-së, që lidhen me procesin e rivlerësimit kalimtar, duke pretenduar se tashmë është një praktikë e konsoliduar për trajtimin e pasurive të krijuara nga personat e lidhur para martesë¹⁶. Por, gjithsesi, pavarësisht këtij pretendimi, vërehet se në përgjigjet e tij subjekti

¹⁵ Konfirmohet se deri në shtator të vitit 2008 personi i lidhur ka qenë në marrëdhënie pune me qendrën shëndetësore B, Tropojë.

¹⁶ Ka referuar pjesë arsyetuese nga vendimet si vijon: (i) vendimi i Kolegjit nr. 19 (JR), datë 10.6.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. A. G; (ii) vendimi i Kolegjit nr. 15 (JR), datë 18.6.2022, për subjektin e rivlerësimit, z. K. S; (iii) vendimi i Kolegjit nr. 37 (JR), datë 24.11.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. S. N; (iv) vendimi i

ka referuar se në respektim të detyrimit ligjor për të qenë shterues mbi pyetjen e dërguar nga Komisioni, në përputhje me standardet e transparencës, qenies bashkëpunues dhe koherent në shpjegimet e tij, deklaroi sërish të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për porositjen e apartamentit nga bashkëshortja e tij në vitin 2007, duke depozituar edhe dokumentacion justifikues në mbështetje të deklaramëve të tij.

Bazuar në: (i) deklaramet e bëra nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2008 dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*; (ii) shpjegimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI me “Procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit deklarues”¹⁷, datë 21.11.2014; (iii) dokumentin “Relacion shpjegues” të nënshkruar nga personi i lidhur, znj. A.Ç (P), depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në Aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së; (iv) deklaramet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ (përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, të dërguar nga Komisioni) – konstatohet se subjekti ka referuar të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim për kryerjen nga personi i lidhur në datën 18.9.2007 të pagesës në shumën prej 115,000 euro për porositjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, si më poshtë vijon:

a. Të ardhurat e përfituara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar nga bashkëshortja dhe familjarët e saj për periudhën nga viti 1995 e në vijim

Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: “...A.Ç ka filluar aktivitetin privat në dhjetor 1995 deri në mars 2002, vërtetuar kjo me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tropojë nr. ***, datë 28.12.1995, në fushën “tregtim artikuj të ndryshëm ushqimorë e industrialë”. Aktivitet ky i regjistruar në organet tatimore dhe i pajisur me kod fiskal nr. *** e nr. serial ***. Ky aktivitet ka vazhduar deri në mars të vitit 2002. Sipas subjektit, në këto vite fitimi i realizuar ishte rreth 6,000,000 lekë. Theksohet se aktiviteti zhvillohej në një dyqan (njësi) pronësi e familjes Ç, vërtetuar kjo me certifikatën për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZVRPP Tropojë, për pasurinë nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, z. k. *** pronësi I.Ç (i ati). Për faktin që ky aktivitet ushtrohej në pronësi të tyre, pra nuk kishte shpenzime për qira dhe as shpenzime për punonjës, pasi nuk kishte asnjë të punësuar tjetër, fitimi në periudhë normale ishte rreth 40% e xhiros së realizuar (prezumuar xhiroja minimale 2,000,000 lekë në vit). Në vitet 1998, 1999 e 2000 pati një rritje të konsiderueshme të xhiros për shkak të rritjes jo vetëm të numrit të klientëve (kujtojmë ardhjen në një numër të konsiderueshëm të refugjatëve nga Kosova), por edhe të rritjes së çmimeve të shitjes së mallrave. Në këtë periudhë fitimi shkante edhe 50 deri 60% të xhiros (prezumuar xhiroja minimale 2,000,000 lekë në vit)”.

Në vijim të deklaramëve lidhur me aktivitetin tregtar të familjarëve të bashkëshortes së tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “...në datën 15.3.2002 e në vijim ka regjistruar aktivitetin në fushën “tregti me pakicë artikuj të ndryshëm e transport mallrash vetëm për njësinë e vet”, e ëma e A, znj. S.Ç, ku gama e artikujve ka qenë jo vetë ushqimorë dhe industrialë, por edhe artikuj të tjerë si fruta-perime, materiale ndërtimi etj., aktivitet ky i identifikuar me NIPT ***, i cili është aktiv, vërtetuar edhe nga ekstrakti historik (printim në datën 19.4.2023). Nga ky aktivitet, të ardhurat deri në shtator 2007 janë 4,500,000 lekë. Fitimi dhe në këtë rast, sikurse u sqarua më sipër, ka ruajtur të njëjtën masë, rreth 40% të xhiros (prezumuar xhiroja minimale 2,000,000 lekë në vit).

Kolegjit nr. 20 (JR), datë 14.6.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. I.Gj; (v) vendimi i Komisionit nr. 393, datë 3.6.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. G.H; (vi) vendimi i Kolegjit nr. 27 (JR), datë 6.7.2022, për subjektin e rivlerësimit, z. G.H; (vii) vendimi i Komisionit nr. 254, datë 4.6.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. E.Sh; (viii) vendimi i Komisionit nr. 181, datë 18.7.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. E.K; (ix) vendimi i Komisionit nr. 262, datë 17.10.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. E. P; (x) vendimi i Komisionit nr. 584, datë 7.11.2022, për subjektin e rivlerësimit, z. I.T; (xi) vendimi i Kolegjit nr. 15 (JR), datë 17.9.2019, për subjektin e rivlerësimit, z. D.R; (xii) vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) nr. 40662/19, datë 13.12.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. A.S.

¹⁷ Procesverbal i dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.1.2023).

*Në datën 24.3.2005 deri në datën 17.5.2013 ka regjistruar aktivitetin në fushën “tregti me pakicë të artikujve të ndryshëm” i ati i A, z. I.Ç, tashmë si aktivitet i dytë krahas atij të bashkëshortes S.Ç, aktivitet ky i identifikuar nr. NIPT ***, i cili vërtetohet edhe nga ekstrakti historik (printim në datën 19.4.2023). Nga ky aktivitet, të ardhurat deri në shtator 2007 janë 1,808,300 lekë. Fitimet në këtë aktivitet z. I. Ç i pretendon në masën 30-40%, mesatarisht 35% (prezumuuar xhiroja minimale 2,000,000 lekë në vit), pasi aktivitetin e ushtronte në një ambient të marrë në përdorim. Kjo vërtetohet dhe me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.4.2023, notere E. A. D-L”.*

Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar të personit të lidhur dhe prindërve të saj¹⁸, Komisioni vëren se rezulton e provuar se bashkëshortja e subjektit dhe prindërit e saj kanë ushtruar aktivitet tregtar si subjekte të regjistruara për periudha të ndryshme, konkretisht nga viti 1996 e në vijim.

Kështu, sa i përket ushtrimit të aktivitetit tregtar nga bashkëshortja e subjektit, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 28.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, A.Ç është njohur si person fizik privat në njësi me artikuj të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë. Konstatohet se në emër të znj. A.Ç është lëshuar certifikata për regjistrimin në organin tatimor si person fizik, pajisur me kodin fiskal nr. *** dhe nr. serial ***, lëshuar nga Dega e Tatimeve Tropojë, për periudhën 15.2.1996 – 31.12.1996¹⁹.

Lidhur me provueshmërinë e kryerjes së aktivitetit tregtar nga bashkëshortja e subjektit në vitin 1996 si person fizik i regjistruar në organin tatimor, Komisioni evidentoi edhe dokumentacionin shkresor si vijon: (1) mandatarëtimi nr. ***, datë 24.1.1996, për pagesën e vlerës 10,000 lekë nga znj. A.Ç për taksë regjistrimi pranë Degës së Tatimeve Tropojë; (2) mandatarëtimi nr. ***, datë 24.1.1996, për pagesën e vlerës 1,500 lekë nga znj. A.Ç për taksë pastrimi pranë Degës së Tatimeve Tropojë; (3) kërkesë për regjistrimin e veprimtarisë private, dorëzuar nga znj. A.Ç, datë 15.2.1996; (4) deklaratë për çelje veprimtarie nga znj. A.Ç sipas vendimit nr. ***, datë 29.12.1995, me adresë në lagjen “****”, Bajram Curri, me 1 punonjës, me aktivitet “tregti artikujsh të ndryshëm, tregti në dyqan”, me datë krijimi 15.2.1996; (5) deklaratë paraprake mbi të ardhurat e dy muajve të parë të veprimtarisë private, e dorëzuar nga znj. A.Ç, datë 15.2.1996, pranë Degës së Tatimeve të Rrethit Tropojë, në të cilën referohet se xhiroja e pritshme deri në fund të vitit 1996 është 200,000 lekë; (6) fletë njoftimi tatimi, datë 15.2.1996, lëshuar nga Dega e Tatimeve Tropojë për A.Ç, në të cilën është përlllogaritur shuma e tatimit mbi të ardhurat për 4 tremujorë në vitin 1996, ndarë përkatësisht tremujori i parë 2,500 lekë, tremujori i dytë 5,000 lekë, tremujori i tretë 5,000 lekë dhe tremujori i katërt 5,000 lekë – në total 17,500 lekë; (7) mandatarëtimi nr. ***, datë 15.3.1996, në vlerën 2,500 lekë, për pagesën e tatimit për 3-mujorin e parë 1996, A. Ç; (8) mandatarëtimi nr. ***, datë 17.6.1996, në vlerën 5,000 lekë, për pagesën e tatimit për 3-mujorin e dytë 1996, A.Ç; (9) mandatarëtimi nr. ***, datë 26.9.1996, në vlerën 5,000 lekë, për pagesën e tatimit për 3-mujorin e tretë 1996, A. Ç; (10) mandatarëtimi nr. ***, datë 10.12.1996, në vlerën 5,000 lekë, për pagesën e tatimit për 3-mujorin e katërt 1996, A.Ç; (11) fletë njoftimi lëshuar në datën 15.2.1996 nga përgjegjësi i zyrës së tatim-taksave për pagesën e tatimit mbi pasurinë e ndodhur në lagjen “****”, Bajram Curri, për znj. A.I.Ç, për godinën me sipërfaqe 21 m² * 100 lekë/m², në total 2,100 lekë; (12)

¹⁸ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në Aneksin *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti në ILDKPKI, bashkëlidhur “Procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, datë 21.11.2014, përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 26.1.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.1.2023); (iii) shkresa e DRT-së Kukës nr. *** prot., datë 5.7.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së; (iv) shkresa e Bashkisë Tropojë nr. *** prot., datë 5.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së; (v) shkresa e QKB-së nr. *** prot., datë 16.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.9.2020; (vi) shkresa e DRT-së Kukës nr. *** prot., datë 28.10.2020, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 2.11.2020; (vi) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

¹⁹ Këto rrethana të regjistrimit të subjektit tregtar konfirmohen edhe me dokumentin, vërtetimin nr. *** prot., datë 14.10.2014, lëshuar nga DRT-ja Kukës, depozituar si provë nga subjekti në vitin 2014, në ILDKPKI.

mandatarkëtimi nr. ***, datë 6.8.1996, për pagesën e vlerës 2,100 lekë, A.Ç, taksë toke pranë Degës së Tatimeve Bajram Curri; (13) procesverbal i datës 31.1.1997 (i mbajtur me inspektor të degës së tatim-taksave), në referim të të cilit duket se nga subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, është paguar me këste tatimi në vlerën 17,500 lekë dhe tatimi mbi pasurinë në vlerën 2,100 lekë. Referuar këtij procesverbali duket se znj. A.Ç ka deklaruar se ka humbur librin e xhiros të vitit 1996, si dhe ka bërë parashikimin për xhiron e vitit 1997 në shumën 250,000 lekë.

Gjithashtu, evidentohet dokumentacion shkresor në dukje për regjistrimin e subjektit tregtar “A.Ç”, person fizik, për ushtrimin e aktivitetit për vitin 1997, si vijon: (1) mandatarkëtimi nr. ***, datë 15.1.1997, për pagesën e vlerës 1,500 lekë nga A. Ç, për taksë pastrimi + tabele pranë Degës së Tatimeve Tropojë; (2) vërtetim i datës 15.1.1997, lëshuar nga Zyra e Kontrollit dhe Kalibrimit të Mjeteve Matëse të rrethit Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se A.Ç, pronar i njësisë private ushqimore ka kryer regjistrimin dhe verifikimin e mjeteve matëse që përdor në aktivitetin e saj privat (vërtetimi lëshohet për Degën e Tatim-Taksave për të vazhduar aktivitetin në vitin 1997); (3) kërkesë për regjistrimin e veprimtarisë private, datë 31.1.1997, nga A.Ç, për Degën e Tatimeve Bajram Curri; (4) deklaratë, datë 31.1.1997, mbi të ardhurat e realizuara për periudhën janar – dhjetor 1996, në referim të së cilës znj. A.Ç ka deklaruar të ardhura gjithsej “xhiroja i ka humbur”, derdhur deri në datën e sotme 17,500 lekë; (5) deklaratë paraprake mbi të ardhurat e dy muajve të parë të veprimtarisë private, e dorëzuar nga znj. A.Ç në datën 31.1.1997 pranë Degës së Tatimeve të Rrethit Tropojë, në të cilën referohet se xhiroja e pritshme deri në fund të vitit 1997 është 250,000 lekë; (6) vërtetim i lëshuar nga Zyra e Punës Tropojë, në të cilën konfirmohet se “A.Ç”, person fizik, është regjistruar si veprimtari njësi private shitjeje me nr. regjistri ***, datë 31.1.1997. Bashkëlidhur, lista emërore e punonjësve, A.Ç, me profesion shitës, me pagën bazë 4,910 lekë, me adresë në lagjen “****”, Bajram Curri; (7) fletë njoftimi lëshuar në datën 24.2.1997 nga përgjegjësi i Zyrës së Tatim-Taksave për pagesën e tatimit mbi pasurinë e ndodhur në lagjen “****”, Bajram Curri, për znj. A.I.Ç, për godinën me sipërfaqe $28 \text{ m}^2 * 100 \text{ lekë/m}^2$, në total 2,800 lekë; (8) fletë njoftimi tatimi, datë 24.2.1997, lëshuar nga Dega e Tatimeve Tropojë për znj. A.Ç, në të cilën është përlllogaritur shuma e tatimit mbi të ardhurat për 4 tremujorë në vitin 1997, të ndara përkatësisht tremujori i parë 5,000 lekë, tremujori i dytë 5,000 lekë, tremujori i tretë 5,000 lekë dhe tremujori i katërt 5,000 lekë. Në total 20,000 lekë.

Referuar vërtetimit nr. *** të DRT-së Kukës, konfirmohet se subjekti person fizik “A.Ç”, me nr. *** dosjeje, me kod fiskal ***, ka përmbushur konform ligjit të gjitha detyrimet tatimore dhe rezulton se për të gjitha periudhat tatimore të jetë subjekt aktiv dhe se në asnjë periudhë tatimore nuk rezulton të ketë deklaruar pezullim aktiviteti apo humbje.

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e sipërcituar, rezulton e provuar se personi i lidhur znj. A.Ç (P) ka zhvilluar aktivitet tregtar si person fizik i regjistruar në organin tatimor për vitet 1996 – 1997.

Në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se xhiroja e deklaruar nga bashkëshortja e tij, nga ushtrimi i aktivitetit tregtar për vitet 1996 – 1997, nuk ka qenë reale, kjo për shkak se ka ndodhur në kushtet e konkurrencës së pandershme, ku aktivitete të ngjashme ishin të paregjistruara në organin tatimor dhe nuk paguanin asnjë lloj detyrimi. Rrethana e deklaramit të ulët të xhiros vjetore është pranuar edhe nga personi i lidhur në shpjegimet e dhëna prej saj në dokumentin “Relacion shpjegues”, depozituar me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, duke shtuar se për efekt të detyrimeve fiskale, siç ka ndodhur rëndom në realitetin shqiptar, këto deklarime janë kryer si të tilla në vlera të ulëta, ndonjëherë edhe me udhëzim nga vetë tatimorët e zonës.

Për të evidentuar qarkullimin e mundshëm të realizuar nga subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, në një vlerësim alternativ dhe sa më objektiv të gjithë dokumentacionit dhe rrethanave të përfituara gjatë hetimit administrativ, Komisioni iu referua kuadrit ligjor të kohës mbi bazën e të cilit rregullohej aktiviteti tregtar i biznesit të vogël.

Kështu, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën “a” të nenit 3 të ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, masa e tatimit për tregtarët që bëjnë tregti me pakicë, ishte 5% e të ardhurave, por jo më pak se 12,000 lekë/vit. Në kushtet kur referuar dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se për vitin 1996 subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, ka paguar në total detyrimin tatimor në shumën prej 17,500 lekë, duket se rrjedhimisht pagesa e kësaj vlere i përgjigjet qarkullimit vjetor në shumën prej 350,000 lekë²⁰.

Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 1486, datë 6.5.1996, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, neni 1 i ligjit nr. 7679/1993, ndryshon si vijë: *“Të gjithë personat fizikë e juridikë që kryejnë apo do të kryejnë një qarkullim më të vogël se 2,000,000 lekë në një vit kalendarik dhe që nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen tatimit mbi biznesin e vogël”*.

Bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi për kohën, në mungesë të depozitimit të vërtetimit të shumës së paguar nga subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, për tatimin mbi të ardhurat për vitin 1997, si dhe nisur nga vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, në të cilat referohet se ky subjekt ka kryer pagesat e detyrimeve tatimore/nuk ka detyrime të papaguara, sa i përket këtij viti, paraprkisht u vlerësua se janë paguar detyrimet tatimore për qarkullimin e realizuar deri në fashën 2,000,000 lekë.

Pra, duket se qarkullimi i subjektit tregtar “A.Ç”, person fizik, për vitet 1996 – 1997 ka qenë në total në shumën 2,350,000 lekë.

Në lidhje me të ardhurat nga paga e znj. A.Ç si e vetëpunësuar në subjektin tregtar për vitet 1996 – 1997, referuar dokumentacionit të sipërcituar, evidentohet lista emërore e punonjësve, ku kjo shtetase figuron e regjistruar me profesion shitëse, me pagë bazë 4,910 lekë në muaj. Për efekt analize, Komisioni paraprkisht vlerësoi se personi i lidhur A.Ç ka përfituar të ardhura nga paga për vitet 1996 – 1997, në total në shumën prej 117,840 lekësh²¹.

Gjithashtu, subjekti dhe personi i lidhur në deklaratimet e tyre kanë sqaruar se pas viteve 1997, për shkak të trazirave të kohës, formalisht janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet institucionale me Degën e Tatim-Taksave Tropojë, por se aktiviteti tregtar ka vazhduar, pra nuk është ndërprerë zhvillimi i tij. Më tej, prej tyre referohet se ky biznes u regjistrua në mars të vitit 2002 në emër të nënës së bashkëshortes, znj. S.Ç.

DRT Kukës²² konfirmon se shtetasja S.Ç, me NIPT ***, me aktivitet tregti me pakicë të mallrave të përdorur në dyqane, figuron e çregjistruar në datën 15.3.2002.

²⁰ Kjo shumë përfaqëson tatimin e paguar mbi përqindjen e tatimit të përcaktuar për t'u paguar mbi qarkullimin (17,500 lekë/0.05 = 350,000 lekë).

²¹ Kjo shumë përfaqëson vlerën totale të pagesës të përllogaritur për 2 vite të plota (24 muaj * 4,910 lekë në muaj = 117,840 lekë).

²² Shkresë e DRT-së Kukës nr. *** prot., datë 5.7.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së,

Bashkia Tropojë²³ konfirmon se shtetasja S.Ç ka të regjistruar një biznes (aktivitet tregti me pakicë) dhe është me status aktiv. Në referim të kësaj shkrese, aktualisht nuk ka shlyer taksat dhe tarifatat vendore.

QKB-ja²⁴ konfirmon se: (i) shtetasja S.Ç figuron e regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 12.3.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me NIPT ***, me status aktiv; (ii) shtetasja S.Ç figuron e regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 12.3.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe është çregjistruar me vendimin nr. ***, datë 21.3.2005, të kësaj Gjykate.

Gjithashtu, DRT Kukës²⁵ konfirmon se shtetasja S. Ç, me NIPT ***, me aktivitet “tregti me pakicë të mallrave të përdorur”, në Tropojë, duke informuar se nuk disponon të dhëna për të ardhurat, fitimet, humbjet, pagesat e sigurimeve shoqërore, TAP, tatim në burim dhe çdo lloj tjetër tatimi, pasi subjekti është regjistruar në datën 15.3.2002 dhe është çregjistruar nga DRT-ja Kukës më 15.3.2002.

Lidhur me provueshmërinë e kryerjes së aktivitetit tregtar nga nëna e bashkëshortes së subjektit, znj. S.Ç, si person fizik i regjistruar në organin tatimor, për periudhën përpara kryerjes së pagesës për porositjen nga personi i lidhur, në shator të vitit 2007, të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, Komisioni evidentoi edhe dokumentacionin shkresor si vijon: (1) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me nr. ***, datë 12.3.2002, për regjistrimin e kërkueses S.Ç si person fizik privat për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së artikujve të ndryshëm; (2) kërkesë për regjistrimin e veprimtarisë private, dorëzuar nga znj. S.Ç në datën 15.3.2002; (3) vërtetim datë 28.2.2002, lëshuar nga Zyra e Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit Tropojë, në të cilin konfirmohet se S.Ç, pronare e dyqanit, ka kryer regjistrimin dhe verifikimin e mjeteve matëse si peshore etj. (vërtetimi lëshohet për në Degën e Tatim-Taksave); (4) vërtetim i lëshuar në datën 12.3.2002 nga Zyra e Punës Tropojë, në të cilin konfirmohet se S.Ç është regjistruar si veprimtari njësi (dyqan) me nr. regjistri ***, datë 12.3.2002 dhe ka të regjistruar si të punësuar vetëm veten; (5) vërtetim i datës 13.3.2002, lëshuar nga Bashkia Bajram Curri, në të cilin konfirmohet se S.Ç ka paguar për vitin 2002: (a) taksë regjistrimi 20,000 lekë; (b) taksë pastrimi 5,000 lekë; (c) taksë tabele 500 lekë; (ç) taksë pasurie 1,600 lekë; (d) taksë ndriçimi 360 lekë; në total 27,460 lekë, me mandatarkëtim nr. ***, datë 13.3.2002; (6) certifikatë regjistrimi në organin tatimor, biznes i vogël, me kodin fiskal nr. ***, nga ku duket se subjekti tregtar “S.Ç”, person fizik, është regjistruar në gjykatë me vendimin nr. ***, datë 12.3.2002, është regjistruar në organin tatimor në mars të vitit 2002 dhe periudha e veprimtarisë është mars 2002 – 31.12.2002; (7) deklaratë çeljeje aktiviteti nga znj. S.Ç, me kod fiskal nr. *** të aktivitetit tregti artikujsh të ndryshëm, me datë fillimi aktiviteti 15.3.2002; (8) deklaram për regjistrimin e detyrueshëm në Sigurimet Shoqërore për të vetëpunësuarit, në të cilin referohet se znj. S.Ç ka datën e fillimit të aktivitetit më 15.3.2002 dhe është regjistruar me nr. *** në regjistrin e kontributeve të vitit 2002; (9) fletë njoftimi tatimi, lëshuar nga Dega e Tatimeve dhe Taksave Tropojë për znj. S.Ç, në të cilin është përlllogaritur shuma e tatimit mbi të ardhurat për periudhën mars – dhjetor të vitit 2002, të ndarë përkatësisht: (a) tremujori i parë 12,500 lekë; (b) tremujori i katërt 12,500 lekë – në total 25,000 lekë; (10) vërtetim, datë 23.1.2003, lëshuar nga Zyra e Drejtorisë Metrologjisë dhe Kalibrimit Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se znj. S. Ç, pronare e njësisë së shitjes, ka kryer regjistrimin dhe ka kryer veprimet pranë kësaj zyre (vërtetimi lëshohet për ta paraqitur në Degën e Tatim-Taksave Tropojë); (11) vërtetim i datës 18.3.2003, lëshuar nga Zyra e Drejtorisë së Metrologjisë dhe Kalibrimit Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se znj. S.Ç, pronare e dyqanit, ka kryer regjistrimin dhe ka kryer veprimet pranë kësaj zyre (vërtetimi lëshohet për ta paraqitur në Degën e Tatim-Taksave Tropojë); (12) vërtetim, datë 20.3.2003,

²³ Shkresë e Bashkisë Tropojë nr. *** prot., datë 5.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴ Shkresë e QKB-së nr. *** prot., datë 16.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.9.2020.

²⁵ Shkresë e DRT-së Kukës nr. *** prot., datë 28.10.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.11.2020.

lëshuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se znj. S.Ç është anëtarësuar në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2003; (13) vërtetim, datë 25.3.2003, lëshuar nga Bashkia Bajram Curri, Seksioni i Tatim-Taksave, në referim të të cilit konfirmohet se znj. S.Ç ka likuiduar të gjitha detyrimet tatimore me mandat arkëtimi nr. ***, në datën 25.3.2003, me nr. regjistrimi ***, kodi vendor ***, në Bashki; (14) aplikim, datë 27.3.2003, për regjistrimin në tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe taksave lokale mbi biznesin e vogël nga S.Ç, për një qarkullim në vlerën 1,000,000 lekë; (15) deklaratë, datë 27.3.2003, për qarkullimin e parashikuar për vitin 2003 nga personi fizik “S.Ç”, në vlerën 1,000,000 lekë; (16) formular përlllogaritjeje i tatimit të thjeshtuar dhe taksës vendore për biznesin e vogël për znj. S.Ç (***), për vitin 2003, për qarkullimin 1,000,000 lekë, përkatësisht në shumat 10,000 lekë dhe 13,500 lekë për t’u paguar brenda datës së regjistrimit 27.3.2003 dhe shuma 20,000 lekë tatim fitimi i thjeshtuar për t’u paguar deri në datën 30.9.2003; (17) urdhërpagesë e datës 27.3.2003, në referim të së cilës S.Ç (NIPT ***) ka paguar detyrimet 10,000 lekë të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 13,500 lekë taksë vendore mbi biznesin e vogël; (18) vërtetim, datë 27.3.2003, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Tropojë, mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore për/nga S. Ç; (19) vërtetim, lëshuar në datën 27.3.2003, nga Zyra e Punësimit Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se S.Ç është regjistruar si veprimtari njësi (dyqan) me nr. regjistri ***, datë 27.3.2003, dhe ka regjistruar si të punësuar vetëm veten; (20) certifikatë regjistrimi në organin tatimor, biznes i vogël, me kodin fiskal nr. *** me NIPT ***, nga ku duket se subjekti tregtar “S. Ç”, person fizik, është regjistruar në gjykatë me vendimin nr. ***, datë 12.3.2002, është regjistruar në organin tatimor në datën 27.3.2003, dhe periudhën e veprimtarisë janar 2003 – 31.12.2003; (21) certifikatë regjistrimi në organin tatimor, biznes i vogël, me kodin fiskal nr. *** me NIPT ***/serial ***, nga ku duket se subjekti tregtar “S.Ç”, person fizik, është regjistruar në gjykatë me vendimin nr. ***, datë 12.3.2002, është regjistruar në organin tatimor në datën 26.3.2004, për periudhën e veprimtarisë 1.1.2004 – 31.12.2004; (22) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga ISSH dega Tropojë, për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2004, nga ku konfirmohet paga bruto e përfituar nga S.Ç, përkatësisht: (a) viti 2002 shuma 106,794 lekë; (b) viti 2003 shuma 118,476 lekë; (c) viti 2004 shuma 130,314 lekë; (23) mandatarkëtim nr. ***, datë 28.3.2003, me anë të të cilit konfirmohet se S.Ç ka likuiduar librat e shitjes dhe të blerjes për personin fizik “S.Ç”; (24) certifikatë regjistrimi, datë 13.3.2004, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës Tropojë për personin fizik “S.Ç”, për regjistrimin e këtij subjekti për vitin 2004; (25) vërtetim, datë 23.3.2004, lëshuar nga Zyra e Punësimit Tropojë, në të cilin konfirmohet se S.Ç është regjistruar si veprimtari njësi (dyqan) me nr. regjistri ***, datë 23.3.2004, dhe ka regjistruar si të punësuar vetëm veten; (26) vërtetim, datë 25.3.2004, lëshuar nga ISSH-ja mbi shlyerjen e detyrimeve të Sigurimeve Shoqërore për/nga personi fizik “S.Ç”, të cilat i përkasin vitit 2003 dhe konfirmon regjistrimin për vitin 2004; (27) deklaram, datë 25.3.2004, për regjistrim vjetor në sigurimin shoqëror për të vetëpunësuarit në ISSH, për S.Ç; (28) aplikim, datë 26.3.2004, për regjistrimin në tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe taksave lokale mbi biznesin e vogël për S.Ç për një qarkullim në vlerën 1,000,000 lekë; (29) deklaratë, datë 26.3.2004, për qarkullimin e parashikuar për vitin 2004 nga personi fizik “S.Ç” në vlerën 1,000,000 lekë; (30) procesverbal rakordimi, mars 2004, mbajtur në Degën e Tatim-Taksave Tropojë për biznesin e subjektit tregtar “S.Ç”, në të cilin konfirmohet se për vitin 2003 janë likuiduar pagesat e taksave vendore dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin; (31) formular përlllogaritjeje i tatimit të thjeshtuar dhe taksës vendore për biznesin e vogël për S.Ç (***) për vitin 2004 për qarkullimin 1,000,000 lekë, përkatësisht në shumat 10,800 lekë dhe 20,000 lekë për t’u paguar brenda datës së regjistrimit 26.3.2004 dhe shuma 20,000 lekë tatim fitimi i thjeshtuar për t’u paguar deri në datën 30.9.2004; (32) vërtetim datë 2.4.2005, lëshuar nga Zyra e Drejtorisë së Metrologjisë dhe Kalibrimit, Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet se S.Ç, tregtare pakice, ka kryer regjistrimin dhe ka kryer veprimet pranë kësaj zyre (vërtetimi lëshohet për ta paraqitur në Degën e Tatim-Taksave Tropojë); (33) deklaratë mbi qarkullimin e realizuar gjatë vitit 2004 nga personi fizik “S.Ç”, deklaruar në shumën 750,000 lekë;

(34) vendim i Gjykatës së Rrethit Tropojë, datë 21.3.2005, me anë të të cilit është vendosur çregjistrimi i kërkuesit S.Ç si person fizik; (35) procesverbal rakordimi, datë 23.3.2005, mbajtur në degën e Tatim-Taksave Tropojë, për rakordimin e detyrimeve tatimore për vitin 2004, në referim të të cilit konfirmohet se është kryer qarkullimi 750,000 lekë dhe se janë paguar taksa vendore të biznesit të vogël 10,800 lekë dhe tatim i thjeshtuar 30,000 lekë; (36) deklaratë mbylljeje aktiviteti, datë 23.3.2005, nga S.Ç; (37) vendim me nr. *** prot., datë 23.3.2005, lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave Tropojë, me anë të të cilit është kryer çregjistrimi i përhershëm i personit fizik “S.Ç”, me kod fiskal ***/serial *** dhe NIPT ***, me aktivitet “tregti me pakicë”, pasi është plotësuar procesverbali i rakordimit të detyrimeve deri në datën e këtij vendimi.

Gjithashtu, referuar vërtetimit të DRT-së Kukës me nr. *** prot., datë 14.10.2014, konfirmohet se znj. S.Ç, regjistruar në datën 15.3.2002, me NIPT ***, ka ushtruar aktivitet “tregti me pakicë e artikuj të përdorur në dyqane”, i cili rezulton i mbyllur. Ndërsa, me vërtetimin nr. ***, datë 13.11.2014, të DRT-së Kukës, konfirmohet se subjekti tregtar “S.Ç”, person fizik, me nr. *** dosjeje, me NIPT ***, ka përmbushur konform ligjit të gjitha detyrimet tatimore dhe rezulton se për të gjitha periudhat tatimore të jetë subjekt aktiv dhe se në asnjë periudhë tatimore nuk rezulton të ketë deklaruar pezullim aktiviteti apo humbjeje.

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e sipërcituar, rezulton e provuar se nëna e bashkëshortes së subjektit ka ushtruar dhe zhvilluar aktivitet tregtar si person fizik i regjistruar në organin tatimor për periudhën mars 2002 – mars 2005.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar duket se prej subjektit tregtar “S.Ç”, person fizik, janë shlyer të gjitha pagesat e detyrimeve tatimore për periudhën që ka ushtruar aktivitet, e konkretisht 15.3.2002 – 21.3.2005. Në këto kushte, si dhe në konsideratë të faktit se nga DRT-ja Kukës nuk konfirmohet qarkullimi i kryer dhe fitimi neto i realizuar për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe rrethanat e përfituara gjatë hetimit administrativ, Komisioni fillimisht evidentoi në mënyrë alternative qarkullimin e mundshëm të realizuar nga ky subjekt tregtar, duke iu referuar kuadrit ligjor të kohës mbi bazën e të cilit rregullohej aktiviteti tregtar i biznesit të vogël.

Për periudhën 15.3 2002 – 31.12.2002, në referim të pikës 2 të nenit 3, si dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000 dhe ligjin nr. 8842, datë 11.12.2001, përcaktohet se subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Bajram Currit, për qarkullimin deri në 2 milionë lekë, kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse, në shumën 30,000 lekë në vit. Ndërsa, referuar nenit 5 të ligjit të sipërcituar, për subjektet që realizonin qarkullim në shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë, tatimi që kanë pasur detyrim për këtë fashë xhiroje, ka qenë në shumën 4%. Referuar dokumentit fletë njoftim tatimi, për vitin 2002, të lëshuar nga Agjencia e Tatimeve dhe Taksave Tropojë, duket se për subjektin tregtar “S.Ç”, person fizik, është përlllogaritur detyrimi tatimor në shumën 25,000 lekë (e ndarë në dy këste nga 12,500 lekë secili)²⁶ si vlerë proporcionale²⁷ e detyrimit nga muaji mars e në vijim si pjesë e vlerës së plotë vjetore prej 30,000 lekë. Në mungesë të evidentimit të dokumentacionit mbi qarkullim të mundshëm të realizuar nga ky subjekt tregtar (biznes i vogël) mbi vlerën 2 milionë lekë dhe/apo tatim të paguar mbi këtë qarkullim (për qarkullimin 2-8 milionë lekë), si dhe në kushtet kur duket se është paguar tatimi në kuotë fikse për

²⁶ Pika 1 e nenit 8, kreu IV i ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, përcakton se: “Për subjektet që çelin veprimtari në çfarëdo periudhë të vitit, kësti i parë, sipas tabelës, paguhet me regjistrimin (fillimin e veprimtarisë), kurse kësti i dytë deri në 15 dhjetor.”

²⁷ Pika 4 e nenit 3, kreu II i ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, përcakton se kur veprimtaria e biznesit fillon në një muaj çfarëdo të vitit, atëherë masa e tatimit vjetor llogaritet duke shumëzuar kuotën fikse të tatimit në tabelë me raportin (thyesën) që si numërues ka numrin e muajve të mbetur të vitit (përfshirë muajin e regjistrimit), kurse si emërues ka numrin 12 të muajve të vitit. Kjo mënyrë llogaritjeje përdoret edhe në rastet e ndërprerjes së përkohshme ose mbylljes së veprimtarisë.

qarkullimin deri në fashën prej 2 milionë lekësh në vit, Komisioni paraprakisht vlerëson se ky subjekt për vitin 2002 ka realizuar minimalisht qarkullimin në shumën 2,000,000 lekë.

Për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2003, referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”: (i) objekt i taksës vendore për biznesin e vogël është një kuotë fikse vjetore, e pagueshme, e realizuar për çdo vendndodhje ku një person kryen biznes; (ii) subjekt i taksës vendore për biznesin e vogël është çdo person që kryen biznes në territorin e njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, në çdo periudhë të vitit kalendarik dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, TVSH-së – nga ku duket se subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Bajram Currit kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën 15,000 lekë/vit²⁸. Ndërsa, sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në masën 4% të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik. Referuar dokumenteve: (i) aplikim i datës 27.3.2003 për regjistrimin në tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe taksave lokale mbi biznesin e vogël; (ii) formular përlllogaritjeje i tatimit të thjeshtuar dhe taksës vendore për biznesin e vogël, për subjektin tregtar “S.Ç ” (***) për vitin 2003, mbi qarkullimin e vlerësuar 1,000,000 lekë, është përcaktuar se ka pasur detyrimin për të paguar: (a) shumën 13,500 lekë taksë vendore mbi biznesin e vogël gjithsej, me afat për t’u paguar brenda datës së regjistrimit 27.3.2003²⁹; (b) shumën 10,000 lekë si kësti i parë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin³⁰ me afat për t’u paguar brenda datës së regjistrimit 27.3.2003; (c) shumën 20,000 lekë si kësti i dytë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin³¹ me afat për t’u paguar brenda datës 30.9.2003. Rezulton e provuar se subjekti “S.Ç ”, person fizik, në datën 27.3.2003 ka paguar shumën 23,500 lekë dhe se referuar rakordimit të bërë me DRT-në Kukës, në mars të vitit 2004 (akt rakordimi i administruar në dosje – cituar si më sipër), duket se është paguar edhe kësti i dytë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën 20,000 lekë, për qarkullimin deri në shumën prej 1 milion lekësh (mbartet detyrimi prej 10,000 lekë për vitin pasardhës).

Pra, duket se për vitin 2003 subjekti tregtar “S.Ç ”, person fizik, ka realizuar qarkullimin prej 1,000,000 lekësh, xhiro mbi të cilën provohet se janë paguar detyrimet tatimore.

Për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004, referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Bajram Currit, kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën 15,000 lekë në vit³². Ndërsa, sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar³³, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në masën 4 për qind të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik. Referuar dokumenteve të administruara në dosje: (i) aplikim i datës 26.3.2004, për regjistrimin në tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe taksave lokale mbi biznesin e vogël; (ii) formular përlllogaritjeje i tatimit të thjeshtuar dhe taksës vendore për biznesin e vogël, për subjektin tregtar “S.Ç” me NIPT ***,

²⁸ Sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur si aneks i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”.

²⁹ Referuar pikës nr. 2, neni 9 i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, përcaktohet se nëse taksapaguesi paguan shumën e plotë të detyrimit të taksës në kohën e reregjistrimit, atëherë kjo shumë i zvogëlohet me 10% (shuma 15,000 lekë – 10% zbritje = 13,500 lekë detyrimi i subjektit person fizik).

³⁰ Shuma 10,000 lekë është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 1,000,000 lekë * 4% * 25% = 10,000 lekë, referuar nenit 32/6 (nënndarja “i”, shkronja “a”, pika 2), të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

³¹ Shuma 20,000 lekë është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 1,000,000 lekë * 4% * 50% = 20,000 lekë, referuar nenit 32/6 (nënndarja “ii”, shkronja “a”, pika 2), të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

³² Sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur si aneks i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”.

³³ Ndryshuar me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

për vitin 2004, mbi qarkullimin e vlerësuar 1,000,000 lekët, është përcaktuar se ka pasur detyrimin për të paguar: (a) shumën 10,800 lekë taksë vendore mbi biznesin e vogël gjithsej, me afat për t'u paguar brenda datës së regjistrimit 26.3.2004³⁴; (b) shumën 10,000 lekë si kësti i parë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me afat për t'u paguar brenda datës së regjistrimit 26.3.2004; (c) shumën 20,000 lekë si kësti i dytë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me afat për t'u paguar brenda datës 30.9.2004. Rezulton e provuar se subjekti "S.Ç", person fizik, ka paguar shumën 10,800 lekë si taksë vendore mbi biznesin e vogël për vitin 2004 dhe shumën prej 30,000 lekësh tatim i thjeshtuar mbi fitimin, i cili i korrespondon me 4% të qarkullimit të konfirmuar prej 750,000 lekësh³⁵.

Pra, duket se për vitin 2004 subjekti tregtar "S.Ç", person fizik, ka realizuar qarkullimin prej 750,000 lekësh, xhiro mbi të cilën provohet se janë paguar detyrimet tatimore.

Për periudhën 1.1.2005 – 23.3.2005, nuk duket të jetë depozituar/administruar dokumentacion, i cili të referojë të dhëna për pagesa detyrimesh të taksave vendore, tatim të thjeshtuar mbi fitimin apo për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që lidhen me subjektin tregtar "S.Ç", person fizik. Nga ana tjetër, në kushtet kur DRT Kukës ka konfirmuar se ky subjekt nuk ka detyrime tatimore të papaguara, pra nuk evidentohen detyrime tatimore të papaguara për këtë periudhë të ushtrimit të aktivitetit, Komisioni paraprakisht vlerësoi se ka realizuar ¼ e qarkullimit mesatar të vlerësuar/evidentuar si të realizuar për vitet 2002 – 2004, në përpjesëtim me periudhën e ushtrimit të aktivitetit për këtë vit (për një periudhë 3-mujore), e konkretisht vlerën prej 312,500 lekësh³⁶.

Pra, duket se për vitin 2005 subjekti tregtar "S.Ç", person fizik, ka realizuar qarkullimin prej 312,500 lekësh.

Në lidhje me të ardhurat nga paga e S.Ç– si e vetëpunësuar në subjektin tregtar, konfirmohet se për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2004 janë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vlerën e pagës bruto, në total në shumën 355,584 lekë.

Në vijim, referuar deklarimeve të subjektit dhe personit të lidhur, por edhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se në të njëjtën datë që është vendosur çregjistrimi i personit fizik "S.Ç", është regjistruar si person fizik për ushtrimin e aktivitetit tregtar babai i bashkëshortes së subjektit, z. I.Ç.

DRT Kukës³⁷ konfirmon se I.Ç, me NIPT ***, me aktivitet në tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije, duhan etj., me adresë lagjja "****", Bajram Curri, figuron me status "kërkesë për çregjistrim në datën 7.3.2013". Aktualisht ka në sistem detyrime 35,000 lekë, ndërsa në QKB figuron i çregjistruar në datën 17.5.2013.

³⁴ Referuar pikës 4, neni 5 i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, "Për taksën vendore për biznesin e vogël", duket se është aplikuar një zbritje nga Këshilli Bashkiak në masën prej 20%. Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 9 të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, "Për taksën vendore për biznesin e vogël", përcaktohet se nëse taksapaguesi paguan shumën e plotë të detyrimit të taksës në kohën e reregjistrimit, atëherë kjo shumë i zvogëlohet me 10%. Pra, duket se nga shuma totale e detyrimit prej 15,000 lekësh, pas aplikimit të zbritjes 20% (3,000 lekë) dhe aplikimit të 10% të zbritjes për pagesë të parakohshme (1,200 lekë), detyrimi për t'u paguar është përcaktuar në shumën prej 10,800 lekë.

³⁵ Referojuni dokumentit procesverbal - rakordimi i detyrimeve tatimore, datë 23.3.2005 (administruar në dosje).

³⁶ Shuma totale e qarkullimit të vlerësuar/evidentuar për vitet 2002–2004, në vlerën prej 3,750,000 lekë/3 vite aktivitet = 1,250,000 lekë. Në vijim, qarkullimi mesatar vjetor i evidentuar / 4 tremujorë = 312,500 lekë.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2017, e DRT-së Kukës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së;

Bashkia Tropojë³⁸ konfirmon se I.Ç , me NIPT ***, i cili e ka regjistruar këtë biznes vite më parë sipas ekstraktit historik bashkëlidhur, sa u përket detyrimeve tatimore ky subjekt nuk rezultoi të jetë në listën e debitorëve.

DRT Kukës³⁹ informon se I.Ç , me NIPT ***, konfirmohet se ka ushtruar aktivitet në tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, me mbizotërim artikujsh ushqimore, pije, duhan për periudhën 24.3.2005 – 17.5.2013 dhe se nuk ka detyrime të papaguara dhe nuk ka të dhëna për të ardhurat, fitimet, humbjet, TAP dhe çdo lloj tjetër tatimi. Për pagesat e sigurimeve shoqërore subjekti ka deklaruar dhe paguar për pagën minimale si i vetëpunësuar i vetëm.

Lidhur me provueshmërinë e kryerjes së aktivitetit tregtar nga babai i bashkëshortes së subjektit, z. I.Ç , si person fizik i regjistruar në organin tatimor, për periudhën përpara kryerjes së pagesës për porositjen nga personi i lidhur, në shtator të vitit 2007, të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, Komisioni evidentoi edhe dokumentacionin shkresor si vijon: (1) vendim i Gjykatës së Rrethit Tropojë, me nr. ***, datë 21.3.2005, në referim të të cilit është vendosur regjistrimi i kërkuesit I.Ç si person fizik, në fushën e tregtisë së artikujve të ndryshëm; (2) shkresë datë 21.3.2005 “Deklarim për regjistrim vjetor në sigurimin shoqëror për të vetëpunësuarit në ISSH” për z. I. Ç; (3) certifikatë regjistrimi në organin tatimor, biznesi i vogël, me NIPT ***, me nr. serial ***, si subjekt tregtar “I.Ç ” person fizik, me periudhë të veprimtarisë nga viti 2005 e në vijim; (4) shkresë “Kërkesë për regjistrim”, paraqitur në Drejtorinë e Tatimeve në datën 23.3.2005 nga I.Ç si person fizik, me adresë në lagjen “****”, Tropojë, për qarkullim të parashikuar në vlerën 750,000 lekë për vitin 2005; (5) shkresë “Deklaratë mbi qarkullimin e parashikuar për vitin 2005”, datë 23.3.2005, në të cilën I.Ç ka deklaruar, vlerën 750,000 lekë; (6) vërtetim datë 23.3.2005, lëshuar nga Bashkia Bajram Curri, në referim të të cilit konfirmohet se z. I.Ç ka likuiduar të gjitha detyrimet tatimore pranë seksionit të Tatim-Taksave të Bashkisë për vitin 2005, me nr. mandati ***, datë 23.3.2005, me nr. regjistri *** të Bashkisë dhe me kod vendor ***; (7) formular regjistrimi në ISHP për procesin e licencimit të subjekteve, lëshuar në datën 23.3.2005 nga Inspektorati Shtetëror i Punës Tropojë për vitin 2005; (8) vërtetim datë 23.3.2003, lëshuar nga ISSH, Drejtoria Rajonale Kukës, Agjencia Tropojë, në të cilin referohet shlyerja e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore, për/nga I.Ç , për vitin 2005; (9) vërtetim datë 23.3.2005, lëshuar nga Zyra e Punësimit Tropojë, në të cilin referohet se I.Ç është regjistruar si veprimtari njësi (dyqan) me nr. regjistri ***, datë 23.3.2005, dhe ka të regjistruar si të punësuar vetëm veten; (10) tabela e përlllogaritjes së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin biznesi i vogël për vitin 2005, datë 23.3.2005, për I.Ç (***) për qarkullimin 750,000 lekë, përkatësisht në: (a) shumën 5,625 lekë deri më 20.4.2005; (b) shumën 5,625 lekë deri më 20.7.2005; (c) shumën 5,625 deri më 20.10.2005; (ç) shumën 5,625 lekë deri më 20.12.2005 – në total 22,500 lekë tatim i thjeshtuar i fitimit dhe shuma 10,000 lekë taksa vendore; (11) urdhërpagesë, datë 24.3.2005, paguar nga I.Ç , me NIPT ***, për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në shumën 5,625 lekë dhe për taksë vendore mbi biznesin e vogël në vlerën 10,000 lekë; (12) leje tekniko - teknologjike për prodhimin e produkteve ushqimore me nr. ***, datë 22.4.2005, në referim të të cilës I.Ç plotëson kushtet për transport, magazinim dhe tregtim të produkteve ushqimore; (13) vërtetim datë 4.4.2006, lëshuar nga Bashkia Bajram Curri, në referim të të cilit konfirmohet se personi fizik I.Ç ka likuiduar të gjitha detyrimet tatimore pranë seksionit të Tatim-Taksave të Bashkisë për vitin 2006, me mandat nr. ***, datë 4.4.2006, me nr. *** regjistri, me kod vendor ***; (14) vërtetim datë 4.4.2006, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Kukës, Agjencia Tropojë, në referim të të cilit konfirmohet shlyerja e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore për z. I.Ç , për vitin 2005; (15) vërtetim, lëshuar nga Zyra e Punësimit Tropojë, datë 4.4.2006, në referim të të cilit konfirmohet se I.Ç është i regjistruar me veprimtari si person fizik me nr. regjistri ***, datë 4.4.2006, duke regjistruar si të punësuar vetëm veten; (16) formular regjistrimi në ISHP për procesin e

³⁸ Shkresë e Bashkisë Tropojë nr. *** prot, datë 5.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2020, e DRT-së Kukës, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 2.11.2020.

licencimit të subjekteve, lëshuar në datën 4.4.2006 nga Inspektorati Shtetëror i Punës Tropojë; (17) formular i deklaramentit të qarkullimit të biznesit të vogël për vitet 2005 – 2006 i datës 5.4.2006, në të cilin referohet se personi fizik “I.Ç ” ka konfirmuar se në vitin 2005 janë realizuar 750,000 lekë qarkullim, ndërsa qarkullimi i parashikuar për vitin 2006 do të ishte 1,500,000 lekë; (18) “Tabela e përlllogaritjes së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin biznes i vogël për vitin 2006”, datë 5.4.2006, për I.Ç (***), për qarkullimin 1,500,000 lekë, përkatësisht në shumat: (a) 5,625 lekë deri më 20.4.2006; (b) 5,625 lekë deri më 20.7.2006; (c) 5,625 lekë deri më 20.10.2006; (ç) 5,625 lekë deri më 20.12.2006 – në total 22,500 lekë tatim i thjeshtuar i fitimit dhe shuma 7,500 lekë taksa vendore; (19) urdhërpagesë datë 5.4.2006, paguar nga I.Ç , me NIPT ***, për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në shumën 5,625 lekë dhe për taksë vendore mbi biznesin e vogël në vlerën 7,500 lekë; (20) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagesën neto mesatare, lëshuar nga ISSH dega Tropojë, për periudhat 1.1.2005 – 31.12.2008 dhe 1.1.2009 – 31.12.2012, në referim të të cilit konfirmohet paga bruto e përfutur nga I.Ç , përkatësisht: (a) për vitin 2005, shuma prej 144,478 lekësh; (b) për vitin 2006, shuma prej 153,924 lekësh; (c) për vitin 2007, shuma prej 157,680 lekësh – totali 456,082 lekë.

Gjithashtu, referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 13.11.2014, të DRT-së Kukës, konfirmohet se subjekti tregtar “I.Ç ”, person fizik, me nr. *** dosjeje, me NIPT ***, ka përmbushur konform ligjit të gjitha detyrimet tatimore dhe rezulton që për të gjitha periudhat tatimore të jetë subjekt aktiv dhe se në asnjë periudhë tatimore nuk rezulton të ketë deklaruar pezullim aktiviteti apo humbje.

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e sipërcituar, rezulton e provuar se babai i bashkëshortes së subjektit ka ushtruar dhe zhvilluar aktivitetet tregtar si person fizik i regjistruar në organin tatimor për periudhën mars 2005 – maj 2013.

Në kushtet kur nga DRT-ja Kukës apo nga ndonjë dokument tjetër, pjesë e dosjes së këtij subjekti tregtar, nuk konfirmohet qarkullimi i kryer dhe fitimi neto i realizuar për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe rrethanat e përfutura gjatë hetimit administrativ, Komisioni fillimisht evidentoi në mënyrë alternative qarkullimin e mundshëm të realizuar nga ky subjekt tregtar për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri para blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, duke iu referuar kuadrit ligjor të kohës, mbi bazën e të cilit rregullohej aktiviteti tregtar i biznesit të vogël.

Për periudhën 23.3.2005 – 31.12.2005, referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, i ndryshuar, subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Bajram Currit, kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse⁴⁰. Ndërsa, me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është përcaktuar në masën 3% të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik. Referuar dokumenteve, pjesë e dosjes së hetimit: (i) deklaratë mbi qarkullimin e parashikuar për vitin 2005, e datës 23.3.2005; (ii) tabelë e përlllogaritjes së tatimit të thjeshtuar dhe taksës vendore për biznesin e vogël për “I.Ç” me NIPT *** për vitin 2005 mbi qarkullimin e vlerësuar prej 750,000 lekësh, ka pasur detyrimin për të paguar: (a) shumën 10,000 lekë taksë vendore mbi biznesin e vogël⁴¹; (b) shumën 5,625

⁴⁰ Sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur si Aneks i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”.

⁴¹ Referuar pikës nr. 4, neni 5 i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël” duket se është aplikuar një zbritje nga Këshilli Bashkiak në masën prej 20%. Gjithashtu, në pikën 6 të nenit 5 të këtij ligji përcaktohet se, nëse biznesi fillon ose pushon së vepruari gjatë vitit ose ndërpritet përkohësisht, detyrimi i taksës për atë vit llogaritet në bazë të numrit të muajit efektiv të veprimtarisë. Pra, duket se nga shuma totale e detyrimit prej 15,000 lekësh, pas aplikimit të zbritjes 20% (3,000 lekë) dhe të taksës në bazë të muajve efektivë të veprimtarisë, llogaritet si vijon: 12,000 lekë vit /12 muaj * 10 muaj = 10,000 lekë.

lekë si kësti i parë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin⁴² me afat për t'u paguar brenda datës së regjistrimit 20.4.2005; (c) shumën 5,625 lekë si kësti i dytë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me afat për t'u paguar brenda datës 20.7.2005; (ç) kësti i tretë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën prej 5,625 lekësh është përcaktuar për t'u paguar brenda datës 20.10.2005; (d) kësti i katërt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën prej 5,625 lekësh është përcaktuar për t'u paguar brenda datës 20.12.2005. Rezulton e provuar se në datën 24.3.2005, "I.Ç", person fizik, ka paguar shumën 10,000 lekë si taksë vendore mbi biznesin e vogël dhe këstin e parë të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën 5,625 lekë, për vitin 2005. Nga ana tjetër, referuar informacionit të dërguar nga DRT-ja Kukës, duket se ky subjekt tregtar nuk ka pasur detyrime të papaguara për vitin 2005 e, për rrjedhojë, paraprakisht do vlerësohet se ky tatimpagues për vitin 2005 ka realizuar në total qarkullimin prej 750,000 lekësh.

Për periudhën 1.1.2006 – 31.12.2006, rezulton se me ligjin nr. 9432, datë 13.10.2005, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, "Për taksën vendore për biznesin e vogël" i ndryshuar, është përcaktuar se subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Bajram Currit kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse⁴³, në vlerën 7,500 lekë/vit. Ndërsa, me ligjin nr. 9431, datë 13.10.2005, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është përcaktuar në masën 1.5% të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik. Referuar dokumentit "Tabelë e përlogaritjes së tatimit të thjeshtuar dhe taksës vendore për biznesin e vogël për I.Ç (***) për vitin 2006", mbi qarkullimin e vlerësuar 1,500,000 lekë, ka pasur detyrimin për të paguar: (a) shumën 7,500 lekë taksë vendore mbi biznesin e vogël; (b) shumën 5,625 lekë si kësti i parë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin⁴⁴ me afat për t'u paguar brenda datës 20.4.2006; (c) shumën 5,625 lekë si kësti i dytë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me afat për t'u paguar brenda datës 20.7.2006; (ç) kësti i tretë i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën 5,625 lekë të përcaktuar me afat për t'u paguar brenda datës 20.10.2006; (d) kësti i katërt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën 5,625 lekë të përcaktuar me afat për t'u paguar brenda datës 20.12.2006. Rezulton e provuar se në datën 5.4.2006, "I.Ç" person fizik, ka paguar shumën 7,500 lekë si taksë vendore mbi biznesin e vogël dhe këstin e parë të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në shumën 5,625 lekë, për vitin 2006. Nga ana tjetër, referuar informacionit të dërguar nga DRT Kukës duket se ky subjekt tregtar nuk ka pasur detyrime të papaguara për vitin 2006, e për rrjedhojë paraprakisht do vlerësohet se ky tatimpagues për vitin 2006, ka realizuar në total qarkullimin prej 1,500,000 lekësh.

Për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2007, referuar pikës 3 të nenit 10, kreu III i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", çdo subjekt i cili kryen një biznes me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8,000,000 lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël. Ndërsa, në pikën 4 të nenit 11, kreu III i këtij ligji, është përcaktuar se për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1.5% me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje nuk duket të evidentohen të dhëna për pagesa të taksave dhe detyrimeve tatimore nga subjekti "I.Ç" për vitin 2007. Por, nga ana tjetër, në kushtet kur rezulton e provuar se ky tatimpagues ka ushtruar aktivitet dhe nuk rezultojnë detyrime të papaguara për këtë periudhë, Komisioni paraprakisht vlerëson se

⁴² Duket se shuma prej 5,625 lekësh është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 750,000 lekë * 3% * 25% = 5,625 lekë.

⁴³ Sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur si Aneks i ligjit nr. 9432, datë 13.10.2005, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, "Për taksën vendore për biznesin e vogël", i ndryshuar.

⁴⁴ Shuma 5,625 lekë është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 1,500,000 lekë * 1.5% * 25% = 5,625 lekë.

qarkullimi i realizuar për vitin 2007 ka qenë minimalisht në shumën prej 2,000,000 lekësh. Për periudhën deri para pagesës së kryer për porositjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, paraprakisht do të vlerësohet se qarkullimi i realizuar nga subjekti tregtar “I.Ç ” person fizik ka qenë në shumën prej 1,500,000 lekësh (3/4-ta e shumës prej 2,000,000 lekësh).

Në lidhje me të ardhurat nga paga e z. I.Ç , si i vetëpunësuar në subjektin tregtar, konfirmohet se për periudhën 1.1.2005 – 30.9.2007 janë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vlerën e pagës bruto, në total në shumën prej 416,662 lekësh.

Sa i përket normës së fitimit të realizuar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar i familjes Ç ndër vite, në kushtet kur ky biznes është kryer në ambient në pronësi të tyre e në vazhdimësi me një punonjës të regjistruar, nisur nga realiteti social-ekonomik i kohës, si dhe në konsideratë të pretendimeve të bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ, paraprakisht do të vlerësohet se fitimi neto ka qenë sa 45% e qarkullimit të realizuar/evidentuar/përlllogaritur në mënyrë alternative nga Komisioni.

Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si dhe referuar vlerësimit alternativ të kryer mbi qarkullimin dhe fitimin neto të realizuar nga subjektet tregtare të familjes Ç, për periudhën deri para pagesës së kryer për porositjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, duket se të ardhurat totale të mundshme të realizuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Emërtimi i subjektit tregtar - të vetëpunësuarit	Periudha	Qarkullimi	Fitimi neto nga qarkullimi / të ardhurat nga paga
“A. Ç”, person fizik	28.12.1995 – 31.12.1997	2 350 000	1 057 500
Paga si e vetëpunësuar, A. Ç	28.12.1995 - 31.12.1997		117 840
“S.Ç”, person fizik	15.3.2002 – 23.3.2005	4 062 500	1 828 125
Paga bruto, S. Ç	2002 – 2004		355 584
“I.Ç ”, person fizik	24.3.2005 – 18.9.2007	3 750 000	1 687 500
Paga bruto, I. Ç	1.1.2005 – 18.9.2007		416 662
Totali	28.12.1995 - 18.9.2007	10 162 500	5 463 211

b. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nga puna si përkthyes

Sa i përket pretendimit për realizimin e të ardhurave nga puna e bashkëshortes si përkthyes, gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar: “...Në periudhën prill 1999 – shtator 2000, A ka punuar edhe si përkthyes pranë misioneve *** dhe *** në ndihmë të refugjatëve kosovarë, misione këto të vendosura dhe në qytetin e Tropojës. Në këtë detyrë ajo paguhej cash në masën 1,300 USD në muaj, vërtetuar kjo si me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2021, notere Dh.Q, deklaruar nga personi i kontaktit të misioneve znj. P, por edhe me gjithë korrespondencën me email me këto misione, bashkëlidhur procesverbalit për bërje inventari noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.7.2021, notere Dh. Q. Në këtë periudhë, të ardhurat janë 23,400 USD, të cilat të konvertuara në lekë me kursin e kohës (referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë) kapin shumën 3,263,000 lekë. Mbahet në rezervë kjo shumë, pasi kursi i konvertimit i kohës në tregun e lirë ishte më i madh se ai zyrtar i publikuar nga Banka e Shqipërisë. Po kështu, në referim të ligjit të kohës nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33 i tij, detyrimet tatimore nuk paguheshin nga A⁴⁵”.

⁴⁵ Në lidhje me këtë situatë, subjekti ka referuar opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, z. S.K, në lidhje me vendimin e Komisionit nr. 362, datë 31.3.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. G. Q.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, duket se personi i lidhur gjatë viteve 2020 – 2021 ka bërë komunikime elektronike nëpërmjet *email*-it me ***, në përpjekje për të provuar të ardhurat e saj të pretenduara nga puna e kryer si përkthyes pranë kësaj organizate, nga adresa ***@outlook.com, drejtuar adresave ***@unhcr.gov; ***@unhcr.org; ***@unhcr.org, nga ku duket se pasi ajo ka evidentuar emrin e personit përgjegjës nga pala shqiptare me të cilin pretendon se ka punuar dhe prej së cilës është paguar, konkretisht znj. P.P, në njërin nga *email*-et i referohet se kjo shtetase ka qenë punonjëse pranë organizatës ***.

Pas komunikimit të bërë me këtë shtetase, nëpërmjet dokumentit noterial të datës 24.7.2021⁴⁶, znj. P.P, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...Është kontaktuar nga *** në lidhje me kërkesën që ka bërë znj. A (Ç) P mbi angazhimin e saj si përkthyes e gjuhës angleze dhe shoqëruese e personelit të huaj gjatë kohës së menaxhimit të krizës së refugjatëve kosovarë në periudhën 1999 – 2000 në Tropojë. Gjithashtu, konfirmon se është njohur me korrespondencën elektronike me email midis A.Ç dhe ***, e cila i bashkëlidhet deklaratës. Për sa më sipër, deklaron se znj. A (Ç) P ka qenë e kontraktuar si përkthyes e gjuhës angleze dhe shoqëruese e personelit të huaj gjatë zhvillimit të veprimtarive humanitare të shpërndarjes së ndihmave për refugjatët e ardhur nga Kosova në periudhën prill 1999 – shtator 2000. Referon se ajo ka qenë përgjegjësjë e shpërndarjes së ndihmave në rrethin e Tropojës për *** dhe *** dhe znj. Ç ka qenë personi që kishte një njohje shumë të mirë të gjuhës angleze. Në vijim deklaron se znj. A.Ç është paguar për shkak të ofrimit të shërbimit të saj të përkthimit dhe shoqërimit të koordinatorëve të huaj në zonat dhe fshatrat e rrethit Tropojë, në shumën mujore 1,300 USD. Pagesa kryhej cash në dorë. Ajo ka shoqëruar personelin e *** dhe të *** së bashku me shoferin në gjithë rrethin e Tropojës për të kontrolluar dhe ndihmuar me ndihma të ndryshme sipas nevojës, refugjatët kosovarë të shpërndarë në rrethin e Tropojës... ”.

Sa më sipër, pas analizimit të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar në mbështetje të tyre, duket se nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga puna e personit të lidhur si përkthyes dhe në shërbim të organizatave ndërkombëtare *** dhe ***, për periudha të caktuara që u përkasin viteve 1999 – 2000.

c. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij si asistente promocioni, mjeke promocioni/konsulente teknike dhe mjeke e përgjithshme

Lidhur me të ardhurat e referuara me burim nga puna e kryer prej personit të lidhur si asistente dhe/apo mjeke promocioni, si dhe si mjeke e përgjithshme, gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...Në periudhën mars 2002 deri në shkurt 2006 (pa përfshirë muajin shkurt të këtij viti), A ka punuar si asistente mjeke promocioni në vitet 2002–2005 dhe mjeke promocioni me kontratë në vitet 2005–2006 pranë shoqërisë “***” sh.p.k., identifikuar me nr. NIPT ***, vërtetuar kjo si me vërtetimin Nr. *** prot., datë 7.4.2023, të shoqërisë, ashtu dhe me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2016, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë... Në këtë periudhë të ardhurat janë 1,533,000 lekë.

“...Në periudhën qershor 2007 deri në dhjetor 2007 A ka punuar pranë A.R.O.T me detyrë përfaqësuese mjekësore për zonën e veriut, vërtetuar kjo me vërtetimin datë 11.10.2016, lëshuar nga kjo shoqëri. Nga ky aktivitet, të ardhurat deri në shtator 2007 janë 169,770 lekë.

...Në periudhën 6.2.2006 deri më 13.9.2008, A ka punuar në qendrën shëndetësore B si mjeke e përgjithshme familjeje, vërtetuar kjo me vërtetimin nr. *** prot., datë 14.10.2016, të qendrës shëndetësore B, rrethi Tropojë. Nga ky aktivitet të ardhurat nga shkurt 2006 deri në shtator 2007 janë 1,008,480 lekë”.

⁴⁶ Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2021, redaktuar nga noteri publik znj. Dh.Q, depozituar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, dërguar nga Komisioni.

Shoqëria “****” sh.p.k. konfirmon⁴⁷ se personi i lidhur A.Ç (P) ka pasur marrëdhënie pune për periudhën mars 2002 – qershor 2005 me kontratë provizore pune (këtu përjashtohen muajt korrik-gusht të çdo viti) me detyrën e asistentes mjeke promovionale, ndërsa për periudhën tetor 2005 – shkurt 2006, me kontratë të rregullt pune si mjeke promovionale dhe si konsulente teknike. Referuar vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., paga e znj. A.Ç (P) ka qenë 40,000 lekë/muaj, por se është në pamundësi për paraqitjen e mandatpagesave, pasi që nga viti 2014 ka filluar të asgjësojë dokumentacionin financiar më të hershëm se 5-vjeçar.

ISSH-ja⁴⁸ konfirmon marrëdhënien e punësimit dhe të ardhurat e realizuara bruto nga znj. A.Ç pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën tetor 2005 – janar 2005, në total në shumën 133,000 lekë.

Qendra shëndetësore B⁴⁹ konfirmon se znj. A.Ç ka qenë e punësuar pranë kësaj qendre për periudhën 1.2.2005 – 30.9.2008, paguar me pagë bruto mujore 66,613 lekë. Gjithashtu, qendra shëndetësore B⁵⁰ konfirmon se znj. A.Ç ka punuar në qendrën shëndetësore B si mjeke e përgjithshme në periudhën 6.2.2006 – 13.9.2008, me pagë bruto 60,741 lekë dhe pagë neto 50,424 lekë.

“**A.R.O.T**”⁵¹ konfirmon se znj. A.Ç ka punuar në detyrën e përfaqësueses mjekësore për periudhën 1.6.2007 – 31.12.2007, me pagë totale bruto 339,960 lekë dhe neto 288,819 lekë.

Pas analizimit të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar në mbështetje të tyre, duket se nuk provohet plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga puna e personit të lidhur si asistente apo mjeke promovioni në shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “A.R.O.T”.

ç. Të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga babai i personit të lidhur prej ushtrimit të aktivitetit (i paregjistruar) në fushën e tregtimit të bimëve medicinale

Sa i përket të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti i tregtimit të bimëve medicinale nga babai i bashkëshortes, gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se: “*...Në periudhën 1998 deri në vitin 2000, z. I.Ç ka furnizuar, shitur dhe transportuar bimë mjekësore me individin I.M, e nga viti 2000 deri në vitin 2010 po furnizues, shitës dhe transportues i bimëve mjekësore me shoqërinë “****” sh.p.k., identifikuar me nr. NIPT ***, me administrator z. I.M, vërtetuar kjo me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2023, notere E.T, dhe me disa mandatpagesa si të individit I.M , edhe të subjektit “****” sh.p.k. në favor të I.Ç , njësuar me dokumentin noterial nr. *** rep., datë 20.4.2023, notere A.Gj . Kjo marrëdhënie ka qenë një marrëdhënie shërbimi, ku sipas legjislacionit në fuqi njëhej pagesa cash, ndërsa detyrimet fiskale i ka paguar shoqëria “****” sh.p.k. Nga ky aktivitet, z. I të ardhurat deri në shtator 2007 i pretendon në rreth 18,000,000 lekë”.*

⁴⁷ Referojuni dokumentit “Vërtetim” nr. *** prot., datë 7.4.2023, lëshuar nga “****” sh.p.k., depozituar si provë e re nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

⁴⁸ Referojuni dokumentit “Vërtetim” nr. *** prot., datë 18.10.2016, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror.

⁴⁹ Referojuni dokumentit “Vërtetim” nr. *** prot., datë 13.10.2014, lëshuar nga qendra shëndetësore B, depozituar nga subjekti në vitin 2014 në ILDKPKI, bashkëlidhur “Procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit deklarues”.

⁵⁰ Referojuni dokumentit “Vërtetim” nr. *** prot., datë 14.10.2016, lëshuar nga qendra shëndetësore B.

⁵¹ Vërtetim i datës 11.10.2016, lëshuar nga “A.R.O.T”.

Sikurse ka referuar edhe në përgjigjet e dhëna, në përpjekje për të mbështetur deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa mandatpagesa (të njësuara me origjinalin), të cilat në dukje referojnë shitjen e bimëve medicinale, të kryera nga z. I.Ç shoqërisë “***” sh.p.k., si dhe deklaratën noteriale datë 16.1.2023, të bërë nga përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie (I.M)⁵², i cili e konfirmon këtë marrëdhënie.

Pas analizimit të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar në mbështetje të tyre, duket se nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga aktiviteti tregtar i pretenduar i shitjes së bimëve medicinale nga babai personit të lidhur.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në shpjegimet e dhëna nga personi i lidhur nëpërmjet dokumentit “Relacion shpjegues”, të depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ka pretenduar se për një periudhë të caktuar nëna dhe babai i saj kanë ushtruar aktivitet tregtar paralelisht edhe në një njësi në tregun e qytetit, krahas aktivitetit në dyqanin në pronësi të tyre.

Me dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar si provë të re deklaratën noteriale të shtetasit U.H⁵³, të datës 24.4.2023, në referim të së cilës ka pohuar: “...*Është mik prej më se 30 vitesh me shtetasin I.Ç , të cilit në fund të vitit 2003 i kishte marrë hua shumë prej 300,000 lekësh për arsye personale, me afat kthimi për periudhën maksimumi 1 vit. Në pamundësi shlyerjeje të shumës, të dy ranë dakord në muajin shkurt 2005, që pronën e tij njësi dyqan, sot identifikuar si pasuria me nr. ***, z. k. ***, regjistruar në volum ***, faqe ***, në ZVRPP-në Tropojë Bajram Curri, në zonën e tregut të qytetit, t’ia linte I në përdorim pa pagesë për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga mars 2005 deri në fund të shkurtit 2008, si kompensim për moskthimin e huas dhe pas kësaj periudhe do të paguhej një vlerë qiraje 8,000 lekë në muaj, siç edhe ka ndodhur. Për këto marrëdhënie nuk kanë hartuar kontrata formale me shkrim, por kanë qenë verbale*”.

Në vijim, Komisioni evidentoi të ardhurat e pretenduara dhe ato të verifikuara me dokumentacion justifikues ligjor, bazuar edhe në vlerësimin alternativ të kryer mbi të ardhurat e përfituara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar të familjes Ç (ku përfshiheshin edhe të ardhurat e përfituara nga paga e personit të lidhur dhe prindërve të saj, paga si të vetëpunësuar në subjektet tregtare, me statusin e personit fizik, të regjistruar në emër të tyre) për periudhën para pagesës së shumës 115,000 euro për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt verifikimi, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

⁵² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. E.T.

⁵³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.4.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. E.D(L).

Tabela nr. 2

Burimi i të ardhurave	Periudha	Fitimi neto nga aktiviteti i pretenduar (vlerat në lekë)	Totali i të ardhurave të pretenduara (vlerat në lekë)	Qarkullimi vlerësuar nga Komisioni (vlerat në lekë)	Fitimi neto nga qarkullimi/ të ardhurat nga paga të dokumentuara (vlerat në lekë)
“A.Ç”, p. fizik	28.12.1995 – 31.12.1997	6 000 000	6 000 000	2 350 000	2 350 000
Paga si e vetëpunësuar, A.Ç	28.12.1995 – 31.12.1997				117 840
“S.Ç”, p. fizik	15.3.2002 – 23.3.2005	4 500 000	4 500 000	4 062 500	1 828 125
Paga si e vetëpunësuar, S.Ç (bruto)	2002 – 2004				355 584
“I.Ç”, p. fizik	24.03.2005 – 18.9.2007	1 808 333	1 808 333	3 750 000	1 687 500
Paga si i vetëpunësuar, I.Ç (bruto)	1.1.2005 – 18.9.2007				416 662
Aktiviteti i bimëve medicinale, I.Ç	2000 - 2007	18 000 000	18 000 000	-	-
Puna si përkthyes, A.Ç	1.4.1999 – 30.9.2000		3 263 300	-	-
Puna si asistente/mjeke promocioni “***” sh.p.k., A. Ç	1.3.2002 – 1.2.2006		1 533 000	-	-
Puna si përfaqësues mjekësore “***”, A.Ç	1.6.2007 – 18.9.2007		169 770	-	-
Puna si mjeke qendra shëndetësore B, A.Ç	6.2.2007 – 18.9.2007		964 797		964 797
TOTALI	28.12.1995 – 18.9.2007		36 239 200	10 162 500	6 551 353

Sa më sipër, duket se familja Ç nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të provuara me dokumentacion të plotë ligjor, për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer nga personi i lidhur në datën 18.9.2007, në shumën 115,000 euro, për porositjen e apartamentit në rrugën “***”, Tiranë. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

22.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancën dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar pretendimit të bërë gjatë hetimit administrativ se në kushtet kur rezulton e provuar se ai nuk ka asnjë lidhje me porositjen dhe pagesën e kryer në shtator të vitit 2007, për porositjen e apartamentit te rruga “****”, Tiranë, periudhë për të cilën referon se nuk kishte lidhur martesë dhe nuk kishte filluar bashkëjetesë, nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e çmimit të blerjes së kësaj pasurie. Pra, për sa kohë kjo pasuri është porositur e paguar para lidhjes së martesës dhe para fillimit të bashkëjetesës, si dhe në konsideratë të faktit se nuk ka asnjë lidhje dhe/apo kontribut në blerjen e saj, vlerëson se kjo situatë nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimit për të si subjekt i ligjit nr. 84/2016, bazuar edhe në praktikën e konsoliduar të organeve të *Vetting*-ut.

Subjekti, gjatë hetimit administrativ, pas kërkesave të bëra nga Komisioni, bazuar edhe në pohimet e bashkëshortes dhe prindërve të saj, ka shpjeguar mbi momentin e porositjes së kësaj pasurie, negocimit të çmimit të blerjes, nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes dhe pagesën e kryer në shtator 2007, si dhe mbi arsyet e lënies së kësaj pasurie për gezim vetëm në favor të bashkëshortes së tij dhe vullnetit të shfaqur prej saj në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes për vendosjen e emrit të tij në këtë kontratë, pavarësisht se nuk kishte kontribut në shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij apartamenti, por tashmë, në atë periudhë, të lidhur në martesë prej më shumë se 3 vjetësh dhe të shtuar në familjen e tyre edhe me një fëmijë. Në këtë kontekst, në kuadrin e të qenit bashkëpunues për efekt të procesit të rivlerësimit, si dhe për të shmangur çdo dyshim të mundshëm, referon se gjatë hetimit administrativ ka deklaruar të ardhurat e përfituara ndër vite nga familja Ç, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, pavarësisht se në momentin e pagesës së kryer për blerjen e saj bashkëshortja dhe prindërit e saj nuk rezultojnë të kenë qenë persona të lidhur apo të tjerë të lidhur me të si subjekt rivlerësimi, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 të kishin detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave, që kanë shërbyer si burim për shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

Krahas sa më sipër, subjekti parashtron se, sikurse është shprehur edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në respektim të detyrimit ligjor për të qenë shterues, në përputhje me standardet e transparencës, të qenët bashkëpunues dhe koherencës në shpjegime, ka deklaruar burimet e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e kryer nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007, në vlerën 115,000 euro (konvertuar në atë kohë në shumën 13,800,000 lekë), si dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin, të cilin ka mundur ta sigurojë dhe disponojë lidhur me provueshmërinë e këtyre të ardhurave.

Subjekti sjell në vëmendje se, ashtu sikurse është evidentuar edhe nga Komisioni, krahas deklarimeve të bëra gjatë hetimit administrativ, burimet e krijimit të kësaj pasurie janë referuar në: (1) deklaratet e bëra nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2008 dhe në deklaratën *Vetting* 2017; (2) shpjegimet e dhëna prej tij dhe personit të lidhur në ILDKPKI në vitin 2014, me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 21.11.2014; (3) relacionin shpjegues të nënshkruar nga bashkëshortja e tij, depozituar bashkëlidhur deklaratës *Vetting*. Në këtë kontekst, subjekti parashtron se ndonëse kjo pasuri dhe burimet e krijimit të saj (i referohet apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë) ishin deklaruar më parë në deklaratën periodike të vitit 2008, si dhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2014, si dhe përpos faktit se kjo pasuri nuk ka qenë në zotërim në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në përputhje me standardet e transparencës dhe të qenit bashkëpunues, ka deklaruar burimet e krijimit të saj edhe në deklaratën *Vetting*, duke depozituar një relacion shpjegues dhe dokumentacion mbi të ardhurat e personit të lidhur dhe prindërve të saj, si dhe ka konfirmuar burimet e krijimit gjatë hetimit administrativ, duke depozituar dokumentacion shtesë mbi të ardhurat e familjes Ç. Ai deklaron se si subjekt rivlerësimi përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting*, pas dorëzimit të saj, para fillimit të hetimit administrativ, si dhe gjatë hetimit administrativ, ka bërë çdo përpjekje

për të siguruar dokumentacion provues për të ardhurat e personit të lidhur dhe të prindërve të saj, të deklaruara si burim të krijimit të kësaj pasurie. Referon se vetë provat e depozituara prej tij dhe të administruara nga Komisioni tregojnë që ato janë mbledhur në vazhdimësi edhe përpara dërgimit të pyetësorëve specifikë, me anë të të cilëve është kërkuar depozitimi i dokumentacionit provues në mbështetje të deklarimeve të bëra.

Për sa më sipër, subjekti pretendon se është gjendur në kushtet e pamundësisë objektive për sigurimin e dokumentacionit të plotë ligjor provues në përputhje me parashikimet e përcaktuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i familjes Ç, të ardhurat e realizuara nga puna e bashkëshortes si përkthyesë për organizatat ndërkombëtare dhe si asistente/mjeke promovoni në dy shoqëri private në Shqipëri, si dhe të ardhurat e pretenduara nga puna e z. I.Ç (babai i bashkëshortes) në aktivitetin e bimëve medicinale. Nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, bazuar në parimin e proporcionalitetit, kërkon nga Komisioni që të ardhurat e familjes Ç të vlerësohen dhe pranohen si të tilla për një nivel më të ulët provueshmërie, duke u vlerësuar në tërësi ligjshmëria e tyre në kuptim të verifikimit të përfitimit prej një aktiviteti të ligjshëm dhe jo në nivelin e kërkuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Në vijim të prapësimeve të tij, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka analizuar në mënyrë të detajuar edhe një herë të ardhurat e deklaruara si burim për pagesën e kryer nga personi i lidhur, në shtator të vitit 2007, duke paraqitur argumentet e tij në vlerësimin e tyre, si dhe duke depozituar prova të reja shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij.

22.6 Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e provat e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, Komisioni çmoi që fillimisht, por jo nga rëndësia, të vlerësojë përfundimisht në tërësi të ardhurat e deklaruara si burim krijimi për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, porositur nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007, për sa kohë rezulton se të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi, pavarësisht pretendimeve të subjektit se nuk ka detyrimin për të përmbushur standardin kushtetues në justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie, pretendim i cili sigurisht do të trajtohet nga trupi gjykues në këtë vendim, bazuar në parimin e proporcionalitetit, me objektivitet e paanësi të plotë në vlerësimin logjik të të gjitha provave, *indicieve* dhe rrethanave që çojnë në krijimin e bindjes së brendshme, si dhe në nivel ligjor, bazuar edhe në Jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

a. Sa i përket të ardhurave të deklaruara me burim nga aktiviteti tregtar i familjes Ç (ku nuk përfshihet aktiviteti i bimëve medicinale), Komisioni vëren se në prapësimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit i qëndron deklaratimeve të mëparshme mbi vlerën e të ardhurave neto të përfituara nga zhvillimi i aktivitetit tregtar, për periudhën para kryerjes së pagesës për blerjen e apartamentit, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për një total në shumën 12.3 milionë lekë, deklarim për të cilin referon se është tërësisht i pranueshëm në raport me vitet e ushtrimit të aktivitetit.

Gjithashtu, Komisioni vëren se deklaratimet e tij lidhur me përfitim të kësaj shume nga zhvillimi i aktivitetit tregtar të familjes Ç për periudhën deri në shtator të vitit 2007, në ndryshim nga përlllogaritja paraprake e bërë nga Komisioni, subjekti i mbështet në rrethanat dhe/apo pretendimet, sa vijon: (i) pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit të plotë, kjo edhe për shkak se në atë periudhë institucionet kanë qenë në nivel minimal të operacionalitetit funksionues, duke referuar se është gjendur në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016; (ii) deklarimi i bërë në organet tatimore nga familjarët Ç mbi qarkullimin vjetor të realizuar nuk ka qenë real, kjo për shkak se në atë kohë biznesi i tyre rrethohej nga konkurrenca e

pandershme, ku aktivitete te ngjashme ishin të peregjistruara në organin tatimor dhe nuk paguanin asnjë lloj detyrimi; (iii) faktit se nuk janë përllogaritur nga Komisioni të ardhura nga aktiviteti tregtar i familjes Ç për periudhën 1998 – mars 2002; (iv) për një periudhë kohe nga familjarët Ç është ushtruar paralelisht aktivitetet tregtar në dy njësi shërbimi.

Në vlerësim të provave të administruara, Komisioni konstaton se aktiviteti tregtar i regjistruar i familjes Ç është zhvilluar në njësinë e shërbimit në pronësi të tyre (në emër të shtetasit I.Ç , nr. pasurie ***), shtesë pallati e ndërtuar sipas lejes së dhënë nga KRRT-ja Tropojë, datë 26.5.1994⁵⁴. Subjekti pretendon se ky dyqan që nga momenti kur është përfunduar së ndërtuari dhe është vënë në funksion ka qenë gjithnjë dhe pa ndërprerje në shfrytëzim për zhvillimin e aktivitetit tregtar dhe se asnjëherë nuk ka qenë i mbyllur përgjatë periudhës së marrë në analizë (dhjetor 1995 – 18 shtator 2007).

Në këtë kontekst, krahas evidentimit të provave të mëparshme të depozituara në Komision gjatë hetimit administrativ, në referim të të cilave pretendohet se subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, nuk rezulton të ketë deklaruar pezullim apo mbyllje aktiviteti, pasi nuk ka vendim gjykatë për çregjistrimin si subjekt tregtar apo kërkesë pranë organeve tatimore për çregjistrim apo pezullim aktiviteti, subjekti i rivlerësimit, me qëllim provueshmërinë e zhvillimit të aktivitetit tregtar nga ana e këtij tatimpaguesi edhe për periudhën 1998 – mars 2002, ka depozituar si provë të re shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2023, të Bashkisë Tropojë.

Në referim të shkresës së sipërcituar, sipas dokumentacionit që ndodhet në Arkivin e Bashkisë Tropojë, vërtetohet se subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, e regjistruar me vendimin nr. ***, datë 28.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt të veprimtarisë në fushën e tregtimit të artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë dhe e regjistruar në organet tatimore, me adresë ushtrimi aktiviteti në njësinë tregtare në lagjen “****”. me nr. pasurie ***, ka paguar taksat/tarifat vendore pranë Bashkisë Bajram Curri, sot Bashkia Tropojë, nga viti 1996 deri në vitin 2002. Ndërsa, nga viti 2002 e në vijim për këtë “njësi” taksat/tarifat vendore janë paguar nga subjektet tregtare “S.Ç”, person fizik, me NIPT *** dhe “I.Ç”, person fizik.

Gjithashtu, me qëllim provueshmërinë e zhvillimit të aktivitetit tregtar në këtë njësi shërbimi edhe për periudhën 1998 – në mars 2002, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar si prova të reja: (i) shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2023, të K.E.Sh; (ii) dokumentin “Vërtetim debie” nr. *** prot., datë 4.7.2023, lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në referim të të cilave pretendon se për njësinë e shërbimit të regjistruar në emër të shtetasit I.Ç , me kontratë furnizimi nr. ***, lagja “****”, ka pasur konsum të energjisë elektrike në mënyrë të pandërprerë që nga fillimi i vënies në shfrytëzim e në vijim deri në vitin 2023, ku brenda kësaj periudhe përfshihen edhe vitet 1998 – 2002. Si rrjedhim, argumenton se fakti se edhe për këtë periudhë ka pasur konsum energjie elektrike në këtë njësi tregon se në të është ushtruar aktivitetet tregtar.

Pas analizimit në tërësi të provave të administruara në harmoni me deklaratimet e bëra në vazhdimësi nga subjekti dhe personi i lidhur, trupi gjykues krijoi bindjen se edhe për periudhën janar 1998 – mars 2002, në njësinë e shërbimit në pronësi të familjes Ç është ushtruar aktivitet tregtar dhe, si rrjedhojë, janë përfituar të ardhura nga ky aktivitet. Kështu, rezulton e provuar se tatimpaguesi “A.Ç” person fizik, ka paguar taksat/tarifat vendore pranë Bashkisë Bajram Curri, sot Bashkia Tropojë, nga viti 1996 deri në vitin 2002.

Në këtë optikë, Komisioni vlerëson përpjekjen e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit për të disponuar nga institucionet përkatëse dokumentacion ligjor mbi ushtrimin e aktivitetit tregtar nga ana e personit të lidhur dhe familjarëve e saj, duke çmuar se edhe pse ka provuar se ky aktivitet është ushtruar edhe për periudhën janar 1998 – mars 2002, ai ka qenë në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion të plotë ligjor provues për qarkullimin e realizuar,

⁵⁴ Referojuni dokumentit “Leje ndërtimi” nr. *** prot., datë 26.5.1994, të KRRT-së Tropojë, depozituar nga subjekti.

fitimin neto, si dhe për pagesën e detyrimeve tatimore – krahas dokumentimit të pagesës së taksave/tarifave vendore për të ardhurat e përfituara për këtë periudhë, duke u gjendur në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, trupi gjykues çmon se mosparaqitja e dokumenteve të plota për këtë periudhë është për shkaqe të arsyeshme, marrë në konsideratë këtu realitetin social-ekonomik të kohës, duke sjellë në vëmendje trazirat e vitit 1997 dhe luftën e Kosovës, të nisur në fillim të vitit 1998, fakte këto të njohura botërisht, të cilat kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin normal të institucioneve shtetërore të administratës qendrore dhe lokale në një vend kufitar si Tropoja.

Për sa më sipër, në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit mbi qarkullimin e realizuar si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitetit tregtar për periudhën janar 1998 – mars 2002, në një vlerësim alternativ dhe objektiv, Komisioni vendosi që për efekt analize është realizuar qarkullimi vjetor prej 2 milionë lekësh, i cili i përgjigjet fashës së qarkullimit të përcaktuar në ato vite për biznesin e vogël. Pra, vlerësohet se subjekti tregtar “A.Ç”, person fizik, për periudhën janar 1998 – mars 2002 ka realizuar qarkullimin total në shumën 8,500,000 lekë⁵⁵. Sjellim në vëmendje këtu se në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, por edhe në prapësimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar një normë më të lartë fitimi për këtë periudhë nga ajo sa ka vlerësuar Komisioni, duke referuar se fluksi i punës ka qenë më i madh për shkak të ardhjes së një numri të konsiderueshëm të refugjatëve nga Kosova, çka solli rritje të lëvizjeve të njerëzve në rrethin e Tropojës dhe, si rrjedhim, rritje të qarkullimit, të çmimeve dhe të normës së fitimit. Por, trupi gjykues vlerëson të aplikojë të njëjtën normë fitimi, të vlerësuar paraprakisht për periudhat e tjera objekt analize⁵⁶, duke pranuar për efekt analize si të ardhura neto të realizuara nga aktiviteti tregtar për këtë periudhë shumën 3,825,000 lekë.

Gjithashtu, Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të tij, në mbështetje dhe me qëllim provueshmërinë e deklarimeve të bëra më parë për ushtrimin e aktivitetit tregtar nga familja Ç, paralelisht edhe në një njësi tjetër tregtare (njësinë e lënë në përdorim nga shtetasi U.H) – për një periudhë të caktuar kohe subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë të re shkresën e Furnizuesit të Shërbimit Universal nr. *** prot., datë 7.7.2023, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj.

Referuar informacionit të disponuar nga FSHU-ja dhe dokumentacionit bashkëlidhur rezulton e provuar se pas kërkesës së bërë nga shtetasi U.H dhe depozitimit prej tij të dokumentacionit të pronësisë mbi këtë njësi, kontrata e furnizimit me energji elektrike e lidhur më parë në emër të babait të bashkëshortes së subjektit, z. I.Ç, ka kaluar në emër të shtetasit U.H (kontrata me kod klienti ***). Në verifikim të të dhënave të kësaj kontrate duket se lidhja e saj është bërë në datën 28.2.2006, si dhe i përket njësisë me adresë rruga “****”, lagjja “****”, kabina “****”. Në vlerësimin e kësaj prove të re, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë qenë të vërtetë në deklaratimet e tyre mbi këtë rrethanë (deklarime të bëra më parë në ILDKPKI në vitin 2014, në relacionin shpjegues të depozituar me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ), duke çmuar se këto deklarime të bëra më parë e të mbështetura nga pohimet e shtetasit U.H (nëpërmjet deklaratës noteriale), tashmë të mbështetura edhe me prova direkte, si dhe koherenca e treguar në shpjegimet e dhëna, të krijon bindjen se ata kanë qenë të vërtetë në të gjitha deklaratimet e bëra në lidhje me aktivitetin tregtar të familjes Ç.

Parë në këtë optikë, në vijim të vlerësimit të pretendimeve të subjektit mbi fitimin total neto të realizuar për periudhën 1996 – shtator 2007, si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitetit tregtar prej

⁵⁵ Është përlloritur se për tremujorin e parë të vitit 2002, ka realizuar qarkullimin prej 500,000 lekësh, që përgjigjet ¼ së qarkullimit vjetor të vlerësuar, prej 2,000,000 lekësh.

⁵⁶ Sa i përket normës së fitimit të realizuar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar i familjes Ç ndër vite, në kushtet kur ky biznes është kryer në ambient në pronësi të tyre e në vazhdimësi me një punonjës të regjistruar, nisur nga realiteti social – ekonomik i kohës, si edhe në konsideratë të pretendimeve të bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni është vlerësuar se fitimi neto ka qenë sa 45%.

familjes Ç, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i bërë në shumën prej 12.3 milionë lekësh është tërësisht proporcional dhe brenda logjikës ekonomike – në raport me vitet e ushtrimit të aktivitetit (rreth 12 vjet), nga ku duket se referohet pak a shumë vlera prej rreth 1 milion lekësh si e ardhur neto vjetore nga ushtrimi i aktivitetit tregtar. Në këtë kontekst vërehet se subjekti ka sjellë si shembull qarkullimin e vlerësuar nga Komisioni në mënyrë alternative për vitin 1996, në shumën 350,000 lekë, duke referuar se nëse marrim të mirëqenë se ky ka qenë qarkullimi i realizuar, xhiroja ditore e realizuar nga ky aktivitet ka qenë rreth 1,000 lekë në ditë, në dukje qarkullim më i vogël se i një ambulanti “tezgë”.

Gjithsesi, trupi gjykues çmon se për efekt analize, nuk mund të merret në konsideratë ky pretendim, për sa kohë në vlerësimin e të ardhurave neto të përfituara nga aktiviteti tregtar për periudhën në fjalë vërehet se nga ana e Komisionit janë ndrequr këto të meta, në dukje duke u korrigjuar rezultati nëpërmjet aplikimit të normës së fitimit, pranimit të ushtrimit të aktivitetit edhe për periudhën janar 1998 – mars 2002 dhe vlerësimin të qarkullimit të realizuar për këtë periudhë, por edhe për disa periudha të tjera për të cilat mungonte dokumentacion ligjor për evidentimin e qarkullimit të realizuar dhe pagesës së detyrimeve tatimore.

Si përfundim, Komisioni vendosi që për efekt analize do të reflektojë si të ardhura neto të përfituara nga aktiviteti tregtar i familjes Ç (përfshirë edhe pagat si të vetëpunësuar), për periudhën 1996 – shtator 2007, shumën prej 9,288,211 lekësh, shumë e cila vlerësohet se është pranuar si e tillë pas një analize tërësisht objektive në përputhje me kuadrin ligjor të kohës dhe duket se përmbush kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

b. Sa i përket të ardhurave të pretenduara nga puna e bashkëshortes së subjektit si përkthyes dhe në shërbim të organizatave ndërkombëtare, Komisioni vëren se personi i lidhur ka bërë përpjekje të vazhdueshme (edhe para dërgimit të pyetësorëve në funksion të hetimit administrativ të kryer) për sigurimin e dokumentacionit ligjor për të provuar përfitimin e tyre. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë gjendur në kushtet e pamundësisë objektive për sigurimin e dokumentacionit të plotë ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave, në përputhje me parashikimet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Por, nga ana tjetër, pas përpjekjeve të bëra evidentohen se janë siguruar *indicie* e prova të tërthorta, të cilat tregojnë se personi i lidhur ka punuar me organizatat ndërkombëtare (***) (***) , për periudhën që i përket viteve 1999 – 2000 dhe ka përfituar të ardhura nga puna e kryer, por mbetet i paqartë përcaktimi i detyrimit për pagesën e tatimit mbi to. Në vlerësim të këtyre të dhënave, si dhe koherencës së treguar në deklarin e përfitimit të këtyre të ardhurave, Komisioni vendosi që në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, për efekt analize të pranojë “me rezervë” përfitimin e këtyre të ardhurave sipas deklarin të bërë nga subjekti, në mbështetje të pohimeve të dhëna nga përfaqësuesja e *** në Shqipëri, vlerësuar kjo rrethanë sigurisht në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie, për sa kohë kemi të bëjmë me të ardhura të përfituara nga personi i lidhur shumë vite përpara martesës dhe fillimit të bashkëjetesës. Komisioni çmon se, si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, deklarimi i dhënë nga ish-punëdhënësi direkt i bashkëshortes së subjektit për atë periudhë merr vlerë provuese të rëndësishme – i kombinuar me *indiciet* e tjera të evidentuara në *email*-et e shkëmbyera nga personi i lidhur me adresat zyrtare elektronike të këtyre organizatave.

Për rrjedhojë, në vlerësimin përfundimtar të të ardhurave të familjes Ç, do të përfshihet “me rezervë” edhe shuma prej 3,263,000 lekësh, me burim krijimi punën e personit të lidhur në organizatat ndërkombëtare.

c. Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga puna e personit të lidhur si përfaqësuese në subjektin “A.R.O.T”, subjekti ka depozituar si provë të re dokumentin “Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme” me nr. * prot., datë 4.7.2023, lëshuar nga ISSH, Drejtoria e Arkivit Tiranë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se për periudhën qershor 2007 – dhjetor 2007 bashkëshortja e subjektit ka realizuar të ardhura në subjektin “***”, duke përfituar pagesën bruto, në total në shumën 264,965 lekë. Bazuar në të dhënat e referuara në dokumentin e sipërcituar, Komisioni vendosi të reflektojë në analizën e të ardhurave vlerën 155,760 lekë, që i përgjigjet të ardhurave të përfituara nga ky burim për periudhën përpara pagesës së kryer në shtator të vitit 2007 për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë.**

Ndërsa, sa i përket të ardhurave totale të deklaruara me burim nga puna e bashkëshortes si asistente/mjeke promovimi në shoqërinë “***” sh.p.k., subjekti kërkon që krahas të ardhurave të reflektuara në analizë, që i përkasin periudhës për të cilën provohet deklarimi i personit të lidhur për efekt sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore në institucion përkatës dhe pasqyrohet paga e përfituar prej saj (regjistruar si mjeke promovimi), të përfshihen edhe të ardhurat shtesë të referuara në shkresën e kësaj shoqërie – depozituar si provë në Komision për periudhën kur ajo ka punuar si asistente/mjeke promovimi gjatë së cilës ka qenë studente, duke pretenduar se pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura ka qenë detyrim i shoqërisë.

Komisioni vlerëson se, bazuar në nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile, shkresa e shoqërisë “***” sh.p.k. merr fuqi provuese për efekt të këtij procesi, për sa kohë gjen mbështetje dhe harmonizohet me të dhënat e informacionet e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të kryer, si dhe me deklaratimet e dhëna në vazhdimësi nga subjekti dhe bashkëshortja e tij për marrëdhënien e punësimit të personit të lidhur me këtë shoqëri.

Në vlerësim të pretendimit të subjektit se ishte detyrimi i shoqërisë, pagesa e tatimit për të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur për periudhën në të cilën nuk ka qenë e regjistruar si punonjëse e saj në listëpagesat përkatëse, e në këtë rast duke vlerësuar se kemi të bëjmë me një marrëdhënie shërbimi – nisur edhe nga natyra e punës – Komisioni vlen të evidentojë se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilën rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat në tri kategori kryesore: (i) tatimi mbi të ardhurat personale; (ii) tatimi mbi fitimin; (iii) tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 4 të këtij ligji, “Burimi i të ardhurave”, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to dhe një nga kategoritë e këtyre të ardhurave janë të ardhurat e parashikuara në shkronjën “b”, *të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera personale në Republikën e Shqipërisë.*

Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat për kategoritë e të ardhurave personale shtrihet mbi të ardhurat e individëve (neni 6), të cilët janë rezidentë në kuptim të Kodit Civil dhe në kuptim të nenit 7 të ligjit të sipërcituar i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.

Për sa më sipër, si dhe bazuar në parashikimet e nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Komisioni vlerëson se të ardhurat e referuara si të përfituara nga personi i lidhur në funksion të shërbimeve të kryera për shoqërinë “***” sh.p.k. janë të ardhura të tatueshme.

Por, nga ana tjetër, Komisioni vëren se në referim dhe interpretim të përcaktimeve të bëra në nenin 33 të këtij ligji (i cili ka pësuar vazhdimisht ndryshime), “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër i njohur nga legjislacioni në fuqi janë të detyruar të mbajnë në burim nga shuma bruto e pagesave edhe mbi

pagesat e kryera ndaj individëve për shërbimet e kryera prej tyre. Edhe me anë të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e konkretisht në pikën 5.1 të tij është përcaktuar se në zbatim të nenit 33 të ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë, rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës.

Pra, duke e analizuar këtë marrëdhënie nën prizmin e një shërbimi të kryer nga subjekti i rivlerësimit si individ, detyrimi për deklarimin, mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi këto të ardhura i takonte shoqërisë “**** ” sh.p.k., e cila, në këtë rast, do të luante rolin e agjentit tatimor.

Si konkluzion, për sa u argumentua më sipër, si dhe në kushtet kur rezultoi e provuar me dokumentacion justifikues ligjor marrëdhënia e bashkëshortes së subjektit me shoqërinë “**** ” sh.p.k., marrëdhënie e cila rezulton se është brenda fushës së veprimtarisë së profesionit të saj, Komisioni çmon të pranojë, megjithëse me rezervë dhe të reflektojë në analizën e të ardhurave si të ardhura shtesë nga kjo marrëdhënie, vlerën e të ardhurave të referuar në shkresën e shoqërisë “**** ” sh.p.k., në total në shumën 1,400,000 lekë.

ç. Në lidhje me të ardhurat e pretenduara me burim nga aktiviteti i grumbullimit dhe i shitjes së bimëve medicinale, vërehet se me dërgimin e prapësimeve subjekti ka evidentuar si prova e *indicie* të rëndësishme – krahas atyre të pasqyruara nga Komisioni në materialin “Rezultatet e hetimit administrativ – dokumentet si vijon: (i) kontratë shitblerjeje pasurie të luajtshme automjet, datë 12.10.2000⁵⁷, ku evidentohet se babai i bashkëshortes, z. I.Ç , shfaqet në cilësinë e blerësit të pasurisë; (ii) kontratë shitblerjeje pasurie, datë 26.7.2012, ku rezulton se z. I.Ç shfaqet në cilësinë e shitësit dhe provohet se automjeti i blerë prej tij në datën 12.10.2000 është i llojit “kamion”; (iii) leje nr. ***, datë 16.1.2003, e Bashkisë Bajram Curri, Seksioni i Transportit, për transport mallrash, për periudhën deri më 31.12.2003 dhe certifikata përkatëse për kryerjen e transportit të mallrave për vete e të tretë; (iv) leje nr. ***, datë 23.1.2004, e Bashkisë Bajram Curri, Seksioni i Transportit, për transport mallrash, për periudhën deri më 31.12.2004 dhe certifikata përkatëse për kryerjen e transportit të mallrave për vete e të tretë; (v) leje nr. ***, datë 17.1.2005, e Bashkisë Bajram Curri, Sektori i Punëve Publike dhe Transportit, për transport mallrash, për periudhën deri më 17.1.2006 dhe certifikata përkatëse për kryerjen e transportit të mallrave për vete e të tretë – dokumente këto të cilat, sipas tij, të vlerësuara në harmoni me deklaratimet e bëra dhe provat e tjera të disponuara, tregojnë se babai i bashkëshortes, z. I.Ç , është marrë me aktivitetin e grumbullimit, transportit dhe tregtimit të bimëve medicinale.

Në shqyrtim të provave të administruara dhe në vlerësim të deklaratimeve të bëra, përfshirë edhe deklaratimin noterial të bërë nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., z. I.M , i cili në kuptim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, merr vlerë provuese – vlerësuar sigurisht në harmoni me provat dhe *indiciet* e tjera, Komisioni gjen të pranueshëm pretendimin e subjektit se babai i bashkëshortes ka ushtruar aktivitet në fushën e grumbullimit, transportit dhe tregtimit të bimëve medicinale. Por, nga ana tjetër nuk ka asnjë evidencë mbi shumën e të ardhurave të përfituara dhe për pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se mbetet e karakterit deklarativ vlera e të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti i grumbullimit, transportit dhe tregtimit të bimëve medicinale dhe, si rrjedhojë, nuk do të përfshihen në analizë të të ardhurave të familjes Ç, të ardhura nga ky burim.

Pas analizës së kryer, trupi gjykues konstaton se është provuar në nivel të kënaqshëm ligjor totali i të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur dhe prindërit e saj, për periudhën para

⁵⁷ Kontratë shitblerje pasurie të luajtshme, datë 12.10.2000, konfirmuar me “Autentifikim nënshkrimi” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. M.V.

pagesës së kryer në shtator të vitit 2007, për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, të paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Burimi i të ardhurave	Periodha	Të ardhurat totale neto (në lekë)
Aktiviteti tregtar i familjes Ç	1996 – shtator 2007	8 398 125
Paga si e vetëpunësuar, A.Ç	28.12.1995 – 31.12.1997	117 840
Paga si e vetëpunësuar (bruto), S.Ç	15.3.2002 – 23.3.2005	355 584
Paga si e vetëpunësuar (bruto), I.Ç	1.1.2005 – 18.9.2007	416 662
Të ardhura nga puna si përkthyes në shërbim të org. ndërkombëtare, bashkëshortja (me rezervë)	1999 – 2000	3 263 000
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit, Qendra Shëndetësore B	6.2.2007 – 18.9.2007	964 797
Të ardhura e përfituara si asistente/mjeko promovime “****” (një pjesë me rezervë)	1.3.2002 – 1.2.2006	1 533 000
Të ardhura e përfituara si përfaqësuese mjekësore “****” (bruto)	1.6.2007 – 18.9.2007	155 760
TOTALI		15 204 768

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm, në përmbushje të kërkesave të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, përfitimin e të ardhurave nga personi i lidhur dhe familjarët e saj deri në shtator të vitit 2007, në total në shumën rreth 15 milionë lekë.

Si rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se personi i lidhur dhe prindërit e saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të provuara në nivel ligjor, të cilat kanë mundësuar plotësisht pagesën e shumës 115,000 euro në shtator të vitit 2007 (konvertuar në atë periudhë në shumën prej rreth 14,000,000 lekësh). Ky konkluzion vjen në përputhje me qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në rastet e kërkesës së provueshmërisë së të ardhurave për dhurimet apo huat nga personat e tjerë të lidhur, duke u çmuar se edhe në këtë rast është më se e mjaftueshme provueshmëria e përfitimit të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në shtator të vitit 2007, duke supozuar se nga tërësia e të ardhurave të pretenduara, të ardhurat e tjera të referuara si të përfituara nga aktiviteti i ligjshëm, por të paprovuara plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor (të ardhurat shpesh nga aktiviteti tregtar, ku përfshihet edhe ai i bimëve medicinale), mund të kenë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të tjera të familjes Ç, duke mos cenuar në vetvete ligjshmërinë e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën në fjalë.

Në vijim të arsytimit, vlen të theksohet se Komisioni nuk evidentoi asnjë provë/fakt apo *indicie* që e lidh subjektin e rivlerësimit me porositjen dhe kryerjen e pagesës në shumën 115,000 euro në shtator të vitit 2007, se ai mund të ketë kontribut në pagesën e çmimit të blerjes apo rrethana të tjera të cilat do të çonin në situatë të dyshuar për pasuri të fshehur e, në këtë optikë, të vlerësoheshin si të tilla që do të kërkonin një verifikim rigoroz dhe të thelluar të të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie dhe kryerjen e një analize të mirëfilltë financiare, shqyrtuar dhe vlerësuar kjo si një rrethanë e rëndësishme në verifikim të situatës së dyshuar për fshehje pasurie.

Në këtë kontekst, në mungesë të evidencave të cilat do të çonin në situatë të dyshuar për pasuri të fshehur të subjektit, në kushtet kur rezulton e provuar se kjo pasuri është blerë (kryer pagesa) para lidhjes së martesës, si dhe në mungesë të provave dhe/apo *indicieve* të tjera për ekzistencën e bashkëjetesës së subjektit dhe personit të lidhur para porositjes së saj, në vlerësim të deklarimeve dhe qëndrimeve koherente të subjektit dhe personit të lidhur, përpjekjeve të bëra për konfirmimin e të ardhurave të realizuara ndër vite nga personi i lidhur dhe prindërit e saj (referuar si burime të krijimit të kësaj pasurie) – duke disponuar dhe depozituar dokumentacion shkresor me qëllim provueshmërinë e tyre, kjo në funksion të pasqyrimin të

situatës së shëndoshë financiare të familjes Ç – përpara porositjes së apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, duken të mjaftueshme për efekt të këtij procesi, duke pranuar se verifikimi i ligjshmërisë së burimit të kësaj pasurie arrihet në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie, për shkak të rrethanave të referuara si më sipër.

Në këto rrethana, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit⁵⁸, Komisioni çmon se periudha në të cilën bashkëshortja e subjektit ka investuar për blerjen e apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit ishin në kushtet e bashkësisë ligjore dhe kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur vepronin financiarisht në autonomi të plotë. Për më tepër, trupi gjykues çmon se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur dhe prindërve të saj, të cilat janë deklaruar se kanë shërbyer si burim për pagesën e kryer në shtator të vitit 2007 për blerjen e apartamentit në Tiranë, nga gjithë hetimi i kryer nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të tyre.

Për të gjitha këto arsye, pavarësisht se trupi gjykues vlerësoi në tërësi se personi i lidhur dhe familjarët e saj kanë pasur të ardhura të provuara në nivel të kënaqshëm ligjor për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007 për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vlerësim të situatës faktike çmohet gjithësesi se problematikat e konstatuara në vlerësimin e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues është bazuar edhe në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuar para martesë në mungesë të kontributit financiar nga subjekti si dhe në mosevidentimin e ndonjë të dhëne tjetër për deklaram të rremë, fshehje pasurie, apo që të ardhurat e deklaruara për blerjen e saj të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme – fakt që mund të cenonte pozitën e tij në këtë proces. Për sa u arsyetua më sipër, ligjshmëria e të ardhurave për pasurinë e krijuar para martesë, analizuar në nivelin e provave dhe rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky konkluzion i trupit gjykues, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) për çështjen “S kundër Shqipërisë”⁵⁹, ku në paragrafin 96 të tij, citohet: “...Gjykata vlerëson se në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit”.

⁵⁸ Më specifikisht, referojuni arsyetimit të bërë nga paragrafi nr. 24 deri në paragrafin nr. 25, në vendimit nr. 19 (JR), datë 10.6.202, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. A.G.

⁵⁹ Vendimi i GJEDNJ Nr. 40662/19, datë 13.12.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. A.S.

23. Pasuria automjet tip “**”,** vit prodhimi 2006, blerë në datën 8.7.2015, në vlerën 500,000 lekë. Si burim krijimi i kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitblerjet e automjeteve të mëparshme, duke referuar se automjeti i fundit i shitur është i markës “****”, tip “****”, në datën 1.7.2015, për vlerën 950,000 lekë.

23.1 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitblerjeje automjeti (blerë) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2015, notere M. Sh. Blerë për shumën 500,000 lekë.

23.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e DPSHTRR-së.

23.3 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

DPSHTRR-ja⁶⁰ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin me targë AA ***, i cili më parë ka mbajtur targën AA ***, tip “****”, deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti konstatohet se: (i) në datën 18.2.2013, shtetasi F. Gj. e blen këtë automjet në Itali për çmimin 1,500 euro; (ii) në datën 25.3.2013 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij mjeti, duke u paguar detyrimi doganor në total në shumën 162,016 lekë; (iii) në datën 22.12.2014, shtetasi F. Gj. ia shet⁶¹ këtë automjet shtetasit A. T., për çmimin 5,000 euro; (iv) në datën 8.7.2015, shtetasi A. T. ia shet⁶² këtë automjet subjektit të rivlerësimit, për shumën 500,000 lekë; (v) në datën 9.2.2018, subjekti i rivlerësimit e shet këtë automjet për vlerën 400,000 lekë.

Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, duket se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja në datën 1.7.2015 e automjetit “****”, tip “****”, për shumën 950,000 lekë. Rezulton se në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “Kontratë shitblerjeje automjeti (shitur) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2015, notere M.Sh. Shitur për vlerën 950,000 lekë”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, pjesë e dosjes së hetimit administrativ, konstatohet se kemi të bëjmë me automjetin e markës “****”, tip “****”, targuar AA ***, blerë nga subjekti në datën 11.1.2013, shitur më 1.7.2015. Më konkretisht, nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja, Komisioni konstaton se: (i) në datën 11.1.2013, shtetasi G. D., i cili e kishte të regjistruar këtë automjet në emrin e tij në shtetin gjerman, ia shet⁶³ subjektit të rivlerësimit me çmimin 1,350,000 lekë; (ii) po në datën 11.1.2013, subjekti i rivlerësimit kryen procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti, nga ku duket se vlera statistikore e tij është shënuar në shumën 1,391,871 lekë dhe se subjekti ka paguar detyrimet doganore, në total në vlerën 287,374 lekë; (iii) në datën 1.7.2015, subjekti i rivlerësimit e shet⁶⁴ këtë automjet për shumën 950,000 lekë (në kontratë referohet se shuma prej 950,000 lekësh është likuiduar në total jashtë zyrës noteriale).

Sa më sipër, Komisioni konstaton se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të tip “****” në datën 1.7.2015, mundësojnë plotësisht likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi – automjetit tip “****”, në datën 8.7.2015. Për më tepër, referuar analizës financiare të kryer nga

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2020, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.9.2020.

⁶¹ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Sh.

⁶² Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. M. Sh.

⁶³ Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme automjet, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. Sh. Gj.

⁶⁴ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2015.

Komisioni⁶⁵, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2013, ku përfshihet edhe blerja e automjetit tip “***”.

23.4 Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

24. Pasuria e llojit likuiditet – depozitë me afat me interes preferencial në Credins Bank, datë 20.6.2016, me afat 1-vjeçar, me interes 1.2% në vit, në vlerën 4,891,092 lekë. Subjekti ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie dhe se kjo depozitë rrjedh nga ripërtëritja e depozitës së krijuar me kontratën e depozitës me afat me interes preferencial, pranë Credins Bank, datë 3.6.2014.

24.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare, duke evidentuar krijimin e depozitave bankare ndër vite, nga të cilat ka rrjedhur krijimi i kësaj depozite, si vijon:

i) Kontratë depozite në shumën 1,000,000 lekë pranë Intesa Sanpaolo Bank, datë 7.6.2007, me afat 1-vjeçar, e rinovueshme, me burim të ardhurat e përfituara nga pagat ndër vite si: (a) jurist pranë P.T.U.U; (b) student intershipi pranë ***; (c) pagat nga Shkolla e Magjistraturës; (ç) pagat nga mësimdhënia në Fakultetin e Drejtësisë “****”; (d) pagat si gjyqtar nga viti 2005 e deri në këtë vit kur është krijuar depozita.

ii) Kontratë depozite me afat në shumën 3,000,000 lekë pranë Credins Bank, datë 25.5.2012, me afat 1-vjeçar, me interes 6.6%, depozitë që rrjedh nga të ardhurat e përfituara bashkërisht me bashkëshorten nga deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012. Interesat në shumën 177,905 lekë të përfituara nga kontrata e depozitës me afat 1-vjeçar, datë 25.5.2012, pranë Credins Bank.

iii) Kontratë depozite me afat në shumën 3,177,905 lekë pranë Credins Bank, datë 25.5.2013, me afat 1-vjeçar, me interes 6.3%, depozitë që rrjedh nga kontrata e mëparshme depozitë me afat 1-vjeçar, plus interesat sa më sipër pranë Credins Bank, datë 25.5.2012, me interes 6.6%.

iv) Kontratë depozitë me afat në shumën 1,500,000 lekë pranë Credins Bank, datë 1.10.2013, me afat 237 ditë, me interes 3.8%, depozitë që rrjedh nga mbyllja e depozitës tjetër pranë Intesa Sanpaolo Bank, datë 1.10.2013, e mbyllur në shumën 1,383,906 lekë, plus shtesë nga të ardhurat nga kursimet familjare.

v) Kontratë depozite me afat me interes preferencial në shumën 4,891,092 lekë pranë Credins Bank, datë 3.6.2014, me afat 2-vjeçar, me interes 4.1% në vit, depozitë që rrjedh nga bashkimi në datën e maturimit të dy depozitave të mëparshme, shtuar edhe interesat pranë kësaj banke, të deklaruara në vitin 2014, atë me afat 1-vjeçar datë 27.5.2013 dhe atë me afat 237 ditë, datë 1.10.2013.

24.2 Deklarimi i bërë ndër vite mbi likuiditetet gjendje në llogari bankare

- Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar depozitë bankare, Banka Amerikane e Shqipërisë, vlera 1,000,000 lekë (depozituar në prill të vitit 2007).

- Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar kontratë depozite me afat pranë Credins Bank, datë 25.5.2013⁶⁶, me afat 1-vjeçar, me interes 6.6%, në shumën 3,000,000 lekë. Depozitë që

⁶⁵ Referojuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, Aneks – 1, pjesë e këtij vendimi.

⁶⁶ Duket se subjekti i referohet datës së maturimit të kësaj depozite, pasi rezulton se ajo është investuar në datën 25.5.2012, pranë Credins Bank.

rrjedh nga të ardhurat e përfituara nga deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012.

- Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: (a) kontratë depozite pa afat pranë Credins Bank, datë 27.5.2013, me afat 1-vjeçar, me interes 6.3%, depozitë që rrjedh nga kontrata e mëparshme depozitë me afat 1-vjeçar pranë Credins Bank, datë 25.5.2012, me interes 6.6%. Shuma 3,177,905 lekë; (b) kontratë depozite pa afat pranë Credins Bank, datë 1.10.2013, me afat 237 ditë, me interes 3.8%, depozitë që rrjedh nga mbyllja e depozitës tjetër pranë Intesa Sanpaolo Bank në datën 1.10.2013, e deklaruar në vitin 2008, në shumën 1,383,906 lekë, plus shtesë nga të ardhurat nga paga vjetore, shuma 1,500,000 lekë; (c) interesa të përfituara nga kontrata e depozitës me afat 1-vjeçar, datë 25.5.2012, pranë Credins Bank, shuma 177,905 lekë; (ç) interesa të përfituara deri në datën 1.10.2013 nga kontrata e depozitës pranë Intesa Sanpaolo Bank, deklaruar në vitin 2008 shuma 383,906 lekë.

- Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar kontratë depozite me afat me interes preferencial pranë Credins Bank, datë 3.6.2014, me afat 2-vjeçar, me interes 4.1% në vit. Depozitë që rrjedh nga bashkimi në datën e maturimit të dy depozitave të mëparshme shtuar dhe interesat pranë kësaj banke, të deklaruara në vitin 2014, me afat 1-vjeçar, datë 27.5.2013 dhe me afat 237 ditë, datë 1.10.2013. Vlera: 4,891,092 lekë.

- Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar interesa bankarë të përfituara për vitin e parë nga depozita: kontratë depozite me afat me interes preferencial pranë Credins Bank, datë 3.6.2014, me afat 2-vjeçar, me interes 4.1% në vit. Shuma: 170,455 lekë.

- Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar interesa bankarë të përfituara për vitin e dytë nga depozita "Kontratë depozite me afat" me interes preferencial pranë Credins Bank, datë 3.6.2014, me afat 2-vjeçar, me interes 4.1% në vit. Shuma: 170,725 lekë.

24.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e Credins Bank.

24.4 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

Bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit kryesisht, duket se shuma e kësaj depozitë (pasuria objekt vlerësimi) është krijuar nga: (i) të ardhurat e depozituara nga subjekti në llogari bankare në vitin 2007, në Bankën Amerikane të Shqipërisë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2007, në shumën 1,000,000 lekë; (ii) shuma prej 3,000,000 lekësh e depozituar në vitin 2012 në Credins Bank, me burim krijimi të ardhurat e përfituara si rezultat i kthimit të shumës 4,446,000 lekë, si diferencë midis çmimit të kontratës së sipërmarrjes, të lidhur midis shtetas A.Ç (P) dhe shoqërisë "F" sh.p.k., me çmimin e paguar realisht, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme; (iii) të ardhurat e përfituara nga interesi bankar dhe të tjera nga kursimet.

a. Depozita në shumën 1,000,000 lekë, investuar në vitin 2007 në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot ISP Bank)

Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank⁶⁷ (ish-Banka Amerikane), rezulton se në datën 14.6.2007 në këtë bankë është hapur llogaria e subjektit të rivlerësimit në monedhën lekë (me nr. bazë ***). Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie konstatohet se brenda së njëjtës ditë është kryer një depozitim *cash* nga ana e subjektit në shumën 1,000,000 lekë, duke e investuar në depozitë me afat.

Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar krijimin e llogarisë depozitë bankare në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në shumën 1,000,000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

⁶⁷ Shkresa e ISP Bank nr. *** prot., datë 21.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.9.2020.

Rezulton se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.3.2006), në seksionin “Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “400,000 lekë të ardhura nga puna si jurist pranë P.U.U, Bashkia Tiranë dhe të ardhura nga puna part-time”.

Pasi Komisioni i kërkoi të konfirmojë duke deklaruar nëse shuma prej 400,000 lekësh e deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë është gjendje likuiditetesh si pasuri apo referon të ardhura, si dhe të japë shpjegimet e tij mbi deklaratimet e likuiditeteve *cash* ndër vite, burimin e të ardhurave për krijimin e këtyre shumave dhe destinacionin e përdorimit të tyre⁶⁸, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “...Shuma prej 400,000 lekësh e pohuar në deklaratën fillestare të pasurisë ka qenë disponuar në gjendje *cash*... para fillimit të punës si gjyqtar. Burimi i krijimit të kësaj shume ish-in të ardhurat e referuara në këtë deklaratë. Sqarohet se brenda viteve kjo gjendje *cash* është përdorur... dhe gjithashtu është zëvendësuar. Për shembull, në qershor 2007 është përdorur gjendja *cash* për plotësimin e shumës 1,000,000 lekë të çeljes së depozitës pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe po brenda muajve korrik – dhjetor, po të vitit 2007, është plotësuar me burim krijimi nga të ardhurat e tij nga pagat dhe mësimdhënia në universitetin “***””.

Sa më sipër, bazuar në deklarin e bërë në ILDKPKI, si dhe në sqarimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, rezulton se shuma prej 400,000 lekësh e deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë ka qenë pasuri e disponuar në gjendje *cash* nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës në shumën 1,000,000 lekë, më 14.6.2007, në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot Intesa Sanpaolo Bank).

Referuar deklaratës fillestare të pasurisë dhe pas verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit kryesisht, duket se deri në ditën e fillimit të detyrës⁶⁹ subjekti i rivlerësimit dispononte si pasuri vetjake: (i) automjetin tip “***”, i blerë⁷⁰ në datën 18.1.2004, në vlerën 250,000 lekë; (ii) gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 400,000 lekë.

Në vijim, Komisioni kreu analizën e treguesve financiare për periudhën tetor 2001 (moment në të cilin evidentohet punësimi i parë i subjektit dhe të ardhura të përfituara prej tij nga kjo marrëdhënie) deri në momentin para fillimit të detyrës (datë 30.9.2005), të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Analiza financiare për periudhën tetor 2001 – 30.9.2005	Vlerat në lekë
A) Pasuri	650 000
Automjet “***”, blerë në datën 18.1.2004	250 000
Ndryshim likuiditeti	400 000
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	650 000
D) Të ardhura	1 408 057
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit	921 675
Të ardhura nga paga si jurist pranë P. U. U, Bashkia Tiranë	334 414
Të ardhura nga paga si jurist pranë Shërbimit Ligjor Falas, Tiranë	151 968
E) Shpenzime	454 388
Shpenzime jetike	399 890
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	54 498
Balanca e fondeve (D-C-E)	303 669

⁶⁸ Pyetjet nr. 3/a) dhe b), të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

⁶⁹ Në formularin e deklarinimit të interesave private/para fillimit të detyrës, kërkohet të deklarohen pasuritë deri në momentin e fillimit të detyrës.

⁷⁰ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2004, redaktuar nga noteri publik, z. A.R.

Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e interesave privatë/para fillimit të detyrës, e konkretisht të pasurisë së llojit automjet me vlerë 250,000 lekë dhe pasurisë së llojit likuiditet – gjendje *cash*, në shumën 400,000 lekë.

Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për krijimin në vitin 2007, të depozitës në shumën prej 1,000,000 lekësh, në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot ISP Bank), Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2007 – 14.6.2007 (data e krijimit të depozitës), të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 5

Analiza financiare për periudhën 1.1.2007 – 14.6.2007	Vlerat në lekë
A) Pasuri	595 692
Ndryshim likuiditeti në bankë	+ 995 692
Ndryshim likuiditeti në <i>cash</i>	- 400 000
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	595 692
D) Të ardhura	728 134
Të ardhura nga paga si gjyqtar, subjekti i rivlerësimit	374 814
Të ardhura nga paga si pedagog, subjekti i rivlerësimit	103 320
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, në datën 15.2.2007 ⁷¹	250 000
E) Shpenzime	61 385
Shpenzime jetike	61 385
Balanca e fondeve (D-C-E)	71 057

Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin në datën 14.6.2007, të pasurisë së llojit depozitë bankare, në Bankën Amerikanë të Shqipërisë (sot ISP Bank), në vlerën 1,000,000 lekë.

Në vijim të verifikimeve të kryera mbi këtë llogari depozitë, Komisioni konstaton se, si rrjedhojë e akumulimit të interesave vjetore vit pas viti nga depozita fillestare e vitit 2007, në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në shumën 1,000,000 lekë, gjendja e saj në datën 1.10.2013 ka qenë në shumën 1,383,906 lekë. Rezulton se në datën 1.10.2013, subjekti ka tërhequr *cash* shumën 1,383,906 lekë.

Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Credins Bank⁷² konfirmohet se, po në datën 1.10.2013, subjekti ka depozituar shumën prej 1,500,000 lekësh⁷³, duke e investuar në depozitë me afat. Pra, duket se si burim krijimi të kësaj depozite në Credins Bank – krahas shumës së tërhequr nga ISP Bank – ka shërbyer edhe një vlerë e shtuar në tetor të vitit 2013, e cila bazuar në vetëdeklarimin e subjektit ka si burim të ardhurat nga kursimet familjare përgjatë viteve, përfshirë edhe ato të vitit 2013.

⁷¹ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2007, redaktuar nga noteri publik, znj. S.Sh.

⁷² Shkresë e Credins Bank nr. *** prot., datë 25.12.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.12.2020.

⁷³ Ka kryer dy depozitime, përkatësisht në shumat 470,000 lekë dhe 1,030,000 lekë.

b. Shuma 3,000,000 lekë e depozituar në vitin 2012, në Credins Bank, me burim krijimi të ardhurat e përfituara si rezultat i kthimit të shumës 4,446,000 lekë, nga shoqëria “****” sh.p.k.

Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2011, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. V.C, për kthim shume lekësh si diferencë midis vlerës së kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2007, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. (sipërmarrësi) dhe A.Ç (porositësi) dhe kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. (shitësi) dhe A.P e Ervin Pollozhanit (blerësit) – shuma 4,446,000 lekë*”.

Siç u evidentua edhe më sipër, në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar kontratë depozitë me afat në Credins Bank, datë 25.5.2013⁷⁴, me afat 1-vjeçar, me interes 6.6%, në shumën 3,000,000 lekë, duke referuar se kjo depozitë rrjedh nga të ardhurat e përfituara nga deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012.

Nga hetimi i kryer rezultoi se personi i lidhur, në datën 18.9.2007, para fillimit të bashkëjetesës dhe para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit, ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k., për porositjen e apartamentit me sipërfaqe prej 117 m², në shumën 117,000 euro. Referuar kësaj kontrate, shuma 115,000 euro, që përfaqëson këstin e parë, është paguar me nënshkrimin e saj, ndërsa shuma prej 2,000 euro, që përfaqëson këstin e fundit, do paguhej me marrjen në dorëzim të apartamentit.

Në datën 20.1.2012 është nënshkruar kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, ku në cilësinë e palës blerëse shfaqet subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në referim të së cilës palët kanë rënë dakord që prona do të shitet/blihet për çmimin 11,700,000 lekë dhe, se kjo shumë është paguar plotësisht nga ana e blerësve tek shitësi, përpara përpilimit të kësaj kontrate. Rezulton se po në datën 20.1.2012, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k. ka deklaruar se⁷⁵ i ka kthyer znj. A.P dhe bashkëshortit të saj, z. Ervin Pollozhani, shumën e konvertuar prej 4,446,000 lekësh, si diferencë e çmimit të kontratës së sipërmarrjes të lidhur midis znj. A.Ç dhe shoqërisë “****” sh.p.k., datë 18.9.2007, me çmimin e paguar realisht, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, datë 20.1.2012. Në vijim, deklaroi se kjo shumë është likuiduar plotësisht, me para në dorë, përpara nënshkrimit të kësaj deklarate, jashtë zyrës noteriale.

Komisioni vëren se në dukje shuma e kthyer përfaqëson diferencën mes vlerës monetare të paguar nga personi i lidhur në vitin 2007, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 18.9.2007 (konvertuar me kursin e këmbimit në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes) dhe çmimit final të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, datë 20.1.2012.

• I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁷⁶, duke i kërkuar të japë shpjegimet/argumentet e tij mbi shkaqet dhe/apo arsyet për të cilat u ndryshua çmimi i shitblerjes së kësaj pasurie nga ai i përcaktuar në kontratën e porosisë së vitit 2007, në atë të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së vitit 2012, si dhe të deklarojë mbi mënyrën e kthimit të shumës prej 4,446,000 lekësh nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe mbi rrethanën e referuar prej tij se kjo shumë i është kthyer subjektit dhe personit të lidhur, ndërkohë që pretendohet se e gjithë shuma prej 115,000 euro është paguar nga bashkëshortja e tij para martesë, me burim të ardhurat e saj familjare, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera deklaroi se: “*Apartamenti në rrugën “****” është porositur si pasuri vetjake e A.Ç me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2007, noter A.M, me palë sipërmarrëse*

⁷⁴ Duket se subjekti i referohet datës së maturimit të kësaj depozite, pasi rezultoi se ajo është investuar në datën 25.5.2012, pranë Credins Bank.

⁷⁵ Dokumenti, “Deklaratë noteriale”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, redaktuar nga noteri publik, z. A.H.

⁷⁶ Pyetjet nr. 1/ d) dhe e) e pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

shoqërinë “***” sh.p.k., me sipërfaqe të përcaktuar 117 m², porosi kjo në shumën 117,000 euro, e ndarë në dy këste: 115,000 euro + 2,000 euro, nga të cilat u pagua shuma 115,000 euro. Në këtë kontratë është përcaktuar ndërmjet të tjerash në nenin 7 se: “Sipërmarrësi detyrohet t’i dorëzojë porositësit apartamentin të përfunduar brenda 6 muajve, që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate”.

Në vijim, subjekti ka parashtruar se: (1) apartamenti sa sipër përfundoi dhe u dorëzua me disa vite vonesë, mbi 3 vite, nga afati i përcaktuar në kontratë, 6 muaj; (2) në rakordimin final të sipërfaqes në m² u vu re që ajo nuk ishte 117 m² por 97.5 m², pra 19.5 m² më e vogël; (3) disa punime specifike të kërkuara nga A në porositje të tij (apartamentit) nuk u realizuan fare nga shoqëria; (4) cilësia e disa prej materialeve, ndonëse ishin porositur ndryshe nga A, gjithashtu nuk u realizuan të tilla nga shoqëria, por ishin me cilësi më të ulët.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “Të gjitha këto sa më sipër, u vlerësuan nga shoqëria kontraktore “***” sh.p.k. e përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, V.C, në vlerën 4,446,000 lekë, të cilat shoqëria vendosi t’i kthejë, vërtetuar kjo me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, noter A. H. Për këtë arsye, në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, noter A.H, kontratë në të cilën palë shitëse është shoqëria “***” sh.p.k., e palë blerëse përveç emrit të A e shënua edhe emri i tij (kjo gjë me dakordësi të A për faktin që tashmë jo vetëm kishin krijuar të dy familje, por dhe ishin trashëguar me një djalë), u fiksua dhe çmimi në 11,700,000 lekë, nga 115,000 euro të paguara në porositje”.

Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar si prova: (i) shkresën e shoqërisë “***” sh.p.k., titulluar “Sqarim”; (ii) deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2023, të nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë “***” sh.p.k., dokumente të cilat duket se i janë dërguar subjektit pas kërkesës së bërë prej tij.

Nga verifikimi i shkresës dhe deklaratës noteriale⁷⁷ të nënshkruar nga përfaqësuesja ligjore e shoqërisë “***” sh.p.k. konstatohet se, ndër të tjera, ka deklaruar: “Në vitin 2007 ndërmjet shoqërisë dhe znj. A.Ç është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2007, noter A.M, për porositjen e një apartamenti në shumën 117,000 euro, e ndarë dhe e paguar në dy këste: 115,000 euro + 2,000 euro. Po në këtë kontratë ishte përcaktuar edhe dorëzimi fizik i apartamentit brenda 6 muajve nga lidhja e kontratës, por që kjo periudhë zgjati mbi 4 vjet, duke mos u realizuar në kohë. Ky apartament u porosit kur ishte akoma në fazë karabina dhe sipërfaqja ishte përcaktuar 117 m², cituar kjo në kontratën e sipërmarrjes nr. *** kol., nr. *** rep., datë 18.9.2007, ndërsa kur u finalizua ndërtimi u saktësua edhe sipërfaqja e kolauduar e apartamentit nga 117 m² në 97.5 m², cituar kjo në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012. Përveç, sa sipër, pra diferencës prej 19.5 m² në sipërfaqe dhe vonesës në dorëzim, në çmimin e kontratës së sipërmarrjes ishte parashikuar jo vetëm porositja me cilësi të lartë sipas atyre të cituara në kontratën e sipërmarrjes, por edhe realizimi i projektit të dakordësuar nga palët për instalimin e linjës së ngrohje/ftohjes që duhej të shtrihej para vendosjes së pllakave në dysheme dhe që duhej të ishte e shpërndarë në të gjitha ambientet e apartamentit, me pajisjen kryesore të vendosur në ballkon, punime këto që kapin edhe vlerën më të konsiderueshme të përfunduar, ashtu dhe shtimi i disa prizave nga ajo e projektuar në shpërndarje të linjës së energjisë elektrike, antenës televizive, kabullit të internetit, të telefonisë dhe citofonisë dhe vendosja e ashensorit në kohën e duhur, të cilat nuk u arrit të realizoheshin. Nga administratori i shoqërisë “***” në vitin 2012, të gjitha punimet e përfunduar, vlerësimi i diferencës në sipërfaqe dhe vonesa në dorëzim, u llogaritën në shumën 4,446,000 lekë. Ajo në atë periudhë ka qenë ortakë dhe është vënë në dijeni të faktit të kthimit nga shoqëria “***” sh.p.k. në atë kohë me administrator V.C, të shumës 4,446,000 lekë në favor të porositëses A.Ç dhe bashkëshortit të saj. Por, ajo që mund të pohoj është se jo vetëm periudha mbi 16 vjet nga porosia apo mbi 11 vjet nga përllogaritja

⁷⁷ Dokumenti “Deklaratë noteriale” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2023, redaktuar nga noteri publik, z. A.M.

e çmimeve të sa më sipër citoi, por edhe faktin që janë ndryshuar administratorët e shoqërisë, nuk mund të shpreh me detaje zërthimin e shumës 4,446,000 lekë, në zëra të punimeve të parealizuara, të ndryshimit të sipërfaqes në zvogëlim, cilësisë së materialeve, apo ndryshimit të kursit euro/lekë të periudhës së porosisë me atë të kthimit mbrapsht të shumës”.

Komisioni konstaton se në kontratën e sipërmarrjes të datës 18.9.2007 (nenin 7 të saj) është përcaktuar se sipërmarrësi detyrohet t'i dorëzojë porositësit brenda kohës prej 6 muajsh apartamentin të përfunduar që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Nga ana tjetër, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, rezulton se apartamenti i porositur nga shoqëria “****” është deklaruar nga subjekti për herë të parë si adresë banimi në DIPP-në e vitit 2010. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në muajin prill të vitit 2010. Pra, duket se ky apartament është dorëzuar rreth 26 muaj me vonesë nga afati i përcaktuar, fakt i pranuar edhe nga pala shitëse.

Gjithashtu, në kontratën e sipërmarrjes është përcaktuar se (neni 1, i kësaj kontrate), sipërfaqja totale e ndërtimit do të jetë 117 m² dhe se sipërfaqja e saktë do përcaktohet pas kolaudimit të objektit, sipas planimetrisë përkatëse. Referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, sipërfaqja e apartamentit është përcaktuar 97.5 m², pa u specifikuar nëse është vetëm sipërfaqja e banimit apo së bashku me sipërfaqet e përbashkëta dhe, si e tillë, është regjistruar në regjistrat hipotekorë.

Mbi mënyrën e kthimit të shumës nga ndërtuesi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Mënyra e kthimit të shumës 4,446,000 lekë është cituar qartë në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, në fjalinë e fundit të pikës ku citohet se kjo shumë është likuiduar plotësisht, me para në dorë, përpara përpilimit të kësaj deklarate, jashtë zyrës noteriale”⁷⁸.*

*Për sa i përket faktit që kjo shumë i është kthyer bashkëshortëve Pollozhani, deklaron se është ndjekur e njëjta logjikë (pra, dëshirë e A.P). Shuma prej 4,446,000 lekësh e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k. në janar të vitit 2012, pra brenda marsit të vitit 2012 kur edhe bëhet deklarimi i DPV-së për vitin paraardhës, është deklaruar si e tillë me gjithë specifikimet përkatëse që në DPV-në e vitit 2011, në rubrikën e ndryshimeve të interesave privatë të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, ku pasqyrohen shtesat dhe pakësimet e pasurive. Sa më sipër, deklaron se kjo vlerë disponohej në gjendje cash prej tij dhe bashkëshortes në janar 2012 e, si e tillë, është deklaruar edhe në ILDKPKI”.*

• Në vijim të hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni⁷⁹ nëse ka qenë aktiv dhe prezent në negociimin e çmimit të ri të shitblerjes së kësaj pasurie në janar të vitit 2012, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Në janar të vitit 2012, tashmë bashkëshort zyrtar prej mbi 3 vjet, ka qenë prezent jo në “negocimin e çmimit të ri”, pasi për këtë apartament nuk u bënë negociata për “çmim të ri”, por në rastin konkret në “kthimin e shumës” për arsye të zvogëlimit të sipërfaqes, për vonesën disavjeçare në përfundimin e punimeve të apartamentit deri në dorëzimin e tij, ashtu edhe për mosrealizim apo realizimin jo në cilësi të disa prej kërkesave specifike teknike të bëra nga A dhe prindërit e saj në porositje të apartamentit, deklaruar kjo edhe në përgjigje të pikës “d” të pyetjes 1 të pyetësorit nr. 2”.*

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Mesa është vënë në dijeni nga bashkëshortja, znj. A.Ç, ajo dhe prindërit e saj kanë filluar që në fillim të vitit 2008 negociimet me shoqërinë ndërtuese për “kthim shume” nga vlera e paguar sipas kontratës së porosisë. Ajo kujton se në këtë periudhë*

⁷⁸ Ka parashtruar se: *“Referuar kuadrin ligjor të kohës, vetëm me udhëzimin nr. 6915/2, datë 30.1.2012 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, i cili sipas përmbajtjes së tij (ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare) ka hyrë në fuqi vetëm në datën 17.1.2013, u përcaktua detyrimi ligjor që çdo transaksion për shitblerje të pasurive të paluajtshme (apo veprime të tjera që lidhen me to), të kryhej nëpërmjet llogarisë bankare të noterit. Në këtë kuptim, para kësaj date transaksionet e kësaj natyre njiheshin ligjërisht edhe cash”.*

⁷⁹ Referojuni pyetësorit nr. 4.

(fillimviti 2008), në apartamentin tashmë të konturuar me muraturë dhe ku kishin filluar dhe disa nga punimet e rifiniturës së brendshme, ishte konstatuar jo vetëm ecuria e ngadaltë e punimeve, që çonte në mosdorëzimin në kohë të apartamentit, jo vetëm cilësia e këtyre punimeve që nuk ishte në atë të porositur e dakordësuar, por çka është më e rëndësishmja ishte konstatuar që kishte ndryshim në zvogëlim të sipërfaqes së apartamentit. Për të gjitha sa ishin konstatuar, ata (A me prindërit) dhe shoqëria kishin rënë dakord verbalisht që do të kishte “kthim shume”, por që rakordimin përfundimtar të vlerës do ta bënë në momentin e kolaudit të objektit dhe nënshkrimit të kontratës përfundimtare. Sikurse është deklaruar edhe më parë, në prill të vitit 2010, në pritje të ardhjes në jetë të fëmijës së tyre të parë, djalit E, ai dhe bashkëshortja, që deri në këtë kohë vijonin të jetonin së bashku me prindërit dhe gjyshen e tij, në një apartament (2+1), apartament në pronësi të prindërve të tij në rrugën “****”, Tiranë, sipërfaqja e të cilit ishte e kufizuar, filluan të banonin në apartamentin në rrugën “***”, ndonëse pa u përfunduar ende disa punime si në ambientet e brendshme të këtij apartamenti, por edhe në ambientet e përbashkëta të pallatit, nga të cilat më evident dhe shqetësues ishte mosinstalimi i ashensorit. Në janar të vitit 2012, A u njoftua nga shoqëria ndërtuese të paraqitej për të bërë rakordimet e shumës që do i kthehej dhe për të lidhur kontratën përfundimtare. Në këtë moment, tashmë duke qenë se ai dhe A kishin kaluar mbi tre vite martesë dhe ishin shtuar dhe me një fëmijë, prindërit e saj ia kishin shprehur që më parë sesa të futeshim në apartament (viti 2010) dëshirën që si një garanci për ekonominë e saj familjare, pjesën e kontributit të tyre në shumën e paguar 115,000 euro, ata do ia linin asaj, duke nënkuptuar jo vetëm apartamentin si pronë, por dhe shumën që do t'i kthehej nga shoqëria. Sigurisht, me propozim të A, ka qenë dhe ai prezent në diskutimin me shoqërinë për “kthimin e shumës” dhe në veprimin noterial kur u lidh kontrata përfundimtare, por pa pasur asnjë rol specifik dhe ndikues, madje ka qenë pasiv. Mban mend që ka qenë vetë shoqëria që paraqiti para tyre shumën e rakorduar për kthim”.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet / argumentet e tij shteruese, si dhe të depozitojë prova të reja të mundshme mbi këtë transaksion, në funksion të dokumentimit të mënyrës së kthimit të kësaj shume dhe disponimit të saj prej tij dhe personit të lidhur.

24.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancën dëgjimore, subjekti ka parashtruar se gjatë hetimit administrativ ka paraqitur shpjegime shteruese dhe disponuar prova të plota, të cilat tregojnë mbi kthimin e kësaj shume dhe arsyet e kthimit të saj. Rezulton se subjekti i ka qëndruar të gjitha shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me kthimin e shumës nga shoqëria “****” sh.p.k..

Kështu, më konkretisht, nëpërmjet prapësimeve të tij subjekti radhit edhe një herë transaksionet e kryera të lidhura me kthimin e shumës nga shoqëria “****” sh.p.k., duke evidentuar fillimisht se në datën 20.1.2012, është nënshkruar kontrata e shitblerjes së apartamentit me këtë shoqëri, të prenotuar më parë nga bashkëshortja e tij në shtator të vitit 2007, ku është përcaktuar çmimi i shitblerjes së kësaj pasurie në shumën 11,700,000 lekë. Subjekti i rivlerësimit sqaron edhe një herë se ky çmim është përcaktuar si i tillë, pasi më parë shoqëria kishte bërë rakordimet përkatëse për kthimin e shumës si pasojë e mungesave që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes së shtatorit të vitit 2007 (sipërfaqe më e vogël, vonesa në dorëzim, punime të pakryera dhe punime e materiale me cilësi të ulët), të pranuar nga vetë shoqëria, konfirmuar me shkresën dhe deklaratën noteriale të përfaqësueses ligjore të shoqërisë datë 20.4.2023, depozituar si prova gjatë hetimit administrativ. Në vijim evidenton faktin se po në datën 20.1.2012, me një numër repertori/koleksioni më të madh se kontrata e shitblerjes është përpiluar deklarata noteriale e shoqërisë “****” sh.p.k., e cila konfirmon kthimin e shumës prej 4,446,000 lekësh në favor të blerësve të referuar në kontratën e shitblerjes së po të njëjtës datë. Gjithashtu, ai sjell në vëmendje se vetë shoqëria ka konfirmuar deklaratimet e bëra prej tij gjatë hetimit administrativ, mbi arsyet e kthimit të kësaj shume.

Subjekti deklaron se gjatë hetimit administrativ ka shpjeguar mbi rolin e tij në momentin e kthimit të kësaj shume, i cili ka qenë totalisht pasiv, pasi vetë më parë familjarët Ç kishin negociuar me këtë shoqëri për shumën që do i kthehej pas rakordimeve përkatëse. Në këtë kontekst, në referim të deklaratës noteriale si dokument, i cili ka forcën e provës së ligjshme dhe të pakontestueshme për palët, subjekti pretendon se rezulton plotësisht e provuar kthimi i shumës nga shoqëria ndërtuese në datën 20.1.2012.

Në lidhje me kërkesën e bërë nga Komisioni për dhënien e shpjegimeve mbi mënyrën e kthimit të kësaj shume, pra të faktit se ajo është kthyer *cash* dhe jo nëpërmjet sistemit bankar, parashtron se kjo vlerë monetare praktikisht ishte pjesë e pasurisë paramartesore të bashkëshortes së tij (pjesë e pasurisë së përbashkët familjare dhuruar tërësisht asaj) dhe se ka qenë dakordësia e saj që në kontratën e shitblerjes të vendosej edhe emri i tij dhe, si rrjedhojë, edhe në deklaratën e kthimit të vendosej edhe emri i tij – duke qenë se tashmë figuronte formalisht në cilësinë e blerësit të pasurisë.

Thënë këto, në vijim subjekti ka parashtruar se sigurisht që mënyra ideale e kthimit të kësaj shume do të kishte qenë nëpërmjet sistemit bankar, por se edhe pse në funksion në atë kohë, nuk ishte në kushtet që të diktonte shoqërinë mbi mënyrën e kthimit të kësaj shume dhe të vendosi standard të ndryshëm nga ai i vepruar nga palët në momentin e dhënies së saj vitin 2007, po *cash*, pasi vetë situata dhe vonesat në kryerjen e rakordimit nuk e mundësonin një gjë të tillë.

Si përfundim, subjekti ka argumentuar se për bashkëshorten e tij ishte e rëndësishme që kjo shumë të kthehej, ndërsa për atë vetë që veprimi të provohej me dokumentacion ligjor provues dhe se mënyra e kthimit të kësaj shume ishte gjëja e fundit që i interesonte bashkëshortes së tij. Për më tepër, referon se ky lloj transaksioni nuk ndalohej nga legjislacioni i kohës. Nga ana tjetër, ai parashtron se në kuadër të transparencës/koherencës rezulton se transaksioni i kthimit të kësaj shume është deklaruar në formularin e ILDKPKI-së së vitit përkatës, duke pranuar pasaktësinë në deklarimin e tij në deklaratën e interesave private të vitit 2011, e cila bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, duhet të vlerësohet si provë e plotë nga Komisioni. Sipas subjektit, një rrethanë tjetër që provon kthimin dhe disponimin e kësaj shume është krijimi i depozitës në shumën 3 milionë lekë në maj të vitit 2012, deklaruar në DIPP-në e vitit 2012, si e krijuar me burim nga të ardhurat prej kthimit të shumës nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 20.1.2012.

24.6 Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe në deklaratat e interesave private/periodikë vjetorë të viteve 2011 dhe 2012, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, Komisioni çmon se rezulton plotësisht i provuar te gjithë dyshimi të arsyeshëm fakti i deklaruar mbi kthimin e shumës prej 4,446,000 lekësh nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., në datën 20.1.2012.

Në vijim të arsytimit, në kushtet kur rezulton se në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie është shprehur me dokumente noteriale të kohës vullneti i palëve për përcaktimin e çmimit final të shitjes dhe kthimi i diferencës përkatëse të çmimit palës blerëse, fakte të deklaruara nga subjekti edhe në formularin e ILDKPKI-së në vitin e ndodhjes së transaksionit, si dhe nisur nga evidentimi i bërë mbi dorëzimin me vonesë të këtij apartamenti, në kundërshtim me parashikimet e bëra në kontratën e sipërmarrjes dhe ndryshimit në dukje të sipërfaqes së tij (zvogëlim i saj), rrethana këto të pranuar edhe nga përfaqësuesi ligjor i palës shitëse si arsye të përcaktimit të çmimit të ri krahas arsyeve të tjera të referuara në deklaratën noteriale të datës 20.4.2023, trupi gjykues krijoi bindjen mbi vërtetësinë e kësaj marrëdhënieje dhe arrin në përfundimin se shuma 4,446,000 lekë, e deklaruar si e kthyer nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., është pjesë e fondeve të paguara

nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007, për porositjen e apartamentit para lidhjes së martesës dhe para nisjes së bashkëjetesës dhe/apo lidhjes së martesës, ligjshmëria e të cilave është pranuar në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie dhe, si të tilla, këto të ardhura do të konsiderohen si burim i ligjshëm për krijimin e depozitës në Credins Bank, duke u vlerësuar se përmbushin kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, marrë në konsideratë këtu rrethanën e pranuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë në mënyrë bindëse dhe të bazuar në dokumentacion provues të ardhurat objekt analizë – të referuara më parë si burim për porositjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë.

24.7 Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar që lidhet me pasurinë objekt vlerësimi, Credins Bank⁸⁰ konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit është hapur llogaria depozitë (nr. ***) në lekë, në të cilën në datën 25.5.2012 është depozituar *cash* nga subjekti i rivlerësimit shuma 3,000,000 lekë, duke u investuar në depozitë me afat njëvjeçar. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se në datën 25.5.2013, pasi është maturuar depozita janë përfituar interesat neto 177,905 lekë dhe e gjithë shuma 3,177,905 lekë është investuar sërish në depozitë me afat. Më pas, në datën 24.5.2014, është maturuar depozita duke u përfituar interesat neto në shumën 180,188 lekë dhe e gjithë shuma prej 3,358,092 lekësh është bashkuar në datën 3.6.2014 me depozitën tjetër të trajtuar si më lart në shumën 1,500,000 lekë edhe me interesat neto të përfituara nga maturimi i kësaj të fundit në vlerën 33,169 lekë, duke krijuar shumën 4,891,092 lekë, e cila investohet në depozitë me afat. Rezulton se kjo depozitë është maturuar në vitet 2015 dhe 2016 dhe interesat rezultojnë të tërhequra *cash* nga subjekti brenda vitit përkatës. Për rrjedhojë, depozita ka mbetur në vlerën 4,891,092 lekë, vlerë që është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

24.8 Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi (depozitës në Credins Bank, në shumën 4,891,092 lekë), si dhe ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

25. Pasuria e llojit likuiditet – gjendje *cash*, në shumën 1,000,000 lekë, me burim krijimi kursimet familjare. Subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese.

25.1 Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.3.2006, në seksionin “Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “400,000 lekë, të ardhura nga puna si jurist pranë P.U.U Bashkia Tiranë dhe të ardhura nga puna part-time”. Në DIPP-të e viteve 2006 – 2015, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë specifike shtesa ose pakësime të likuiditeteve gjendje *cash*. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* shuma 1,000,000 lekë, burimi i krijimit: nga kursimet familjare ndër vite të pagave personale dhe të bashkëshortes”. Ndërsa, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar: (i) “Gjendje *cash*, burimi i krijimit nga kursimet familjare të pagave në shumën 1,000,000 lekë”; (ii) “arredimi i banesës 1,000,000 lekë, nga pakësimi në vitin 2016, i gjendjes *cash* të akumuluar në vite nga kursimet familjare”.

25.2 Siç u evidentua edhe më sipër, gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se shuma prej 400,000 lekësh ka qenë e disponuar si pasuri në gjendje likuiditetesh *cash* në momentin para fillimit të detyrës. Në vijim të shpjegimeve të tij lidhur me deklaratimet e likuiditeteve *cash* ndër vite dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, burimin e të ardhurave për krijimin e këtyre shumave dhe destinacionin e përdorimit të tyre, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Burimi i krijimit i shumës *cash* 1,000,000 lekë pohuar në deklaratën *Vetting* janar 2017, përsëritur dhe në DPV-në e vitit 2016, vjen kryesisht nga diferenca e papërdorur e shumës prej 4,446,000 lekësh e kthyer me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, pas pakësimit me shumën 3,000,000 lekë, që shërbeu

⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 25.12.2020, e Credins Bank (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.12.2020).

për krijimin e depozitës pranë Credins Bank në vitin 2012, deklaruar në DPV-në e vitit 2012, ku burim për këtë është pakësim i likuiditetit cash që disponoheshin këtë vit, pra konkretisht nga të ardhurat e përfituara si rezultat i kthimit të shumës nga ndërtuesi – sipas deklaratës të referuar si më sipër, por dhe nga të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve Pollozhani në vitet 2012 – 2016. Për sa më sipër, duke qenë se në deklaratën e vitit 2012 është referuar pakësimi i shumës prej 3,000,000 lekësh, nga shuma totale prej 4,446,000 lekësh (deklaruar si shtesë pasurie që në DPV-në e vitit 2011), në fund të vitit 2012, bashkëshortët Pollozhani dispononin në total gjendjen e likuiditetit cash në shumën prej rreth 1.5 milion lekë. Kjo gjendje likuiditeti cash e disponuar në fund të vitit 2012, duke i shtuar edhe disa vlera nga kursimet prej të ardhurave familjare për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ka shërbyer si burim për mbulimin e shpenzimeve shtesë të mobilimit të kryera në vitin 2016, deklaruar në shumën prej rreth 1 milion lekë, si edhe krijimin e gjendjes së likuiditetit cash në shumën prej 1 milion lekësh, deklaruar si pasuri gjendje cash në deklaratën Vetting (janar 2017) dhe përsëritur në DPV-në e vitit 2016, plotësuar në mars 2017. Në këtë kontekst, subjekti sqaron se duke qenë se deklarata Vetting, ka qenë një deklaratë specifike, ku është dhënë mundësia edhe për të saktësuar deklaramet – për efekt të procesit të rivlerësimit, është treguar kujdesi i shtuar, për të deklaruar gjendjen e likuiditetit cash, në momentin e dorëzimit të saj, duke sjellë në vëmendje se kjo deklaratë është depozituar në ILDKPKI, përpara plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës periodike vjetore të vitit 2016”.

25.3 Në vijim të verifikimit të deklarameteve të subjektit, sa i përket likuiditeteve *cash*, duket se shuma prej 400,000 lekësh, e deklaruar prej tij si gjendje *cash* në momentin e fillimit të detyrës, referohet se është përdorur për krijimin e depozitës në qershor të vitit 2007, por e zëvendësuar brenda vitit e, në vijim, është përdorur për blerjen e automjetit tip “***” në korrik të vitit 2008, në dukje duke mos pretenduar zëvendësimin e kësaj shume në fund të vitit⁸¹. Pra, bazuar në deklaramet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka disponuar gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2008.

25.4 Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar më parë në ILDKPKI dhe as nuk ka pretenduar gjatë hetimit administrativ shtesë të likuiditeteve gjendje *cash* për vitet 2009 – 2011. Por, ka deklaruar se në fund të vitit 2012, ai dhe personi i lidhur kanë disponuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën prej rreth 1.5 milion lekësh, me burim krijimi të ardhurat e kthyer nga shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k., në janar të vitit 2012 (trajtuar si më sipër). Komisioni konstaton se subjekti ka pranuar pasaktësitë në deklarimin e likuiditeteve gjendje *cash*, duke pretenduar se shuma prej 1.5 milion lekësh, e disponuar në gjendje *cash* në fund të vitit 2012, së bashku me disa shtesa nga kursimet për vitet 2013 – 2016, kanë shërbyer si burim për mbulimin e shpenzimeve shtesë të mobilimit/arredimit të kryera në vitin 2016 dhe krijimin e pasurisë objekt vlerësimi – gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 1 milion lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka referuar disa vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke parashtruar se pasaktësitë e bëra prej tij në deklarimin e likuiditeteve *cash*, për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund ta ngarkojnë me përgjegjësi në kuadër të këtij procesi⁸².

⁸¹ Referojuni përgjigjeve të dhëna nga subjekti për pyetjen nr. 4, të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

⁸² Ka referuar pjesë arsyetuese nga vendimet si vijon: (i) vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 601, datë 19.12.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. M.D; (ii) vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 24 (JR), datë 28.7.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. L.H; (iii) vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 28 (JR), datë 23.10.2020, për subjektin e rivlerësimit, z. F. V; (iv) vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 241, datë 26.2.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. I.Gj; (v) vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 37 (JR), datë 24.11.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. S. N.

25.5 Komisioni vëren se, siç u evidentua edhe më sipër, në DIPP-në e vitit 2011, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. V.C, për kthim shume lekësh si diferencë midis vlerës së kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2007, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. – sipërmarrësi dhe A.Ç – porositësi dhe kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. – shitësi dhe A.P e Ervin Pollozhani – blerësit – shuma prej 4,446,000 lekësh”.*

25.6 Nga ana tjetër, në shpjegimet e dhëna me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni (të cituara si më sipër), subjekti ka deklaruar se kjo shumë gabimisht është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, pasi është marrë prej tij dhe bashkëshortes në janar të vitit 2012, por ky gabim ka ardhur pasi deklarata e vitit 2011 është plotësuar në mars të vitit 2012. Në vijim të deklarimeve të tij, subjekti parashtroi se në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar pakësimin e shumës prej 3,000,000 lekësh, nga të ardhurat e përfituara prej kthimit të shumës nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2012, rrjedhimisht duke nënkuptuar se pjesa e mbetur nga kjo shumë, duke qenë se nuk është deklaruar e pakësuar, ka qenë e disponuar në gjendje *cash* prej tij dhe bashkëshortes në fund të vitit 2012.

25.7 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2011 është deklaruar përfitimi i shumës 4,446,000 lekë në seksionin e ndryshimit të pasurive. Nisur nga pasaktësia e evidentuar në deklarimin e kësaj shume në DIPP-në e vitit 2011, si dhe duke vlerësuar logjikën e deklarimit të subjektit, të pranuar prej tij në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në kushtet kur në formularin e vitit 2011 nuk referohet dhe nuk evidentohet disponimi i kësaj shume në sistemin bankar, duket se të paktën deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së vitit 2011 (evidentuar si datë dorëzimi 23.3.2012) ajo ka qenë e disponuar në gjendje *cash* nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Rezulton se në formularin vijues të deklarimit të pasurive, në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit depozitë në Credins Bank, në shumën 3,000,000 lekë, me burim të ardhurat e përfituara si rezultat i kthimit të shumës nga shoqëria “****” sh.p.k., duke referuar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012. Por, rezulton se në këtë formular të deklarimit të pasurive (DIPP-ja e vitit 2012) subjekti nuk deklaroi pakësim të pjesës së mbetur të shumës prej 4,446,000 lekësh, e cila dukej se ishte deklaruar si gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2011, pavarësisht pasaktësisë së evidentuar në deklarimin e kësaj shume në këtë formular. Si rrjedhim, trupi gjykues vlerëson se duket i pranueshëm dhe i mbështetur në dokumentacion ligjor provues – deklarimi dhe sqarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ mbi disponimin *cash* në fund të vitit 2012, të pjesës së mbetur nga shuma e kthyer prej shoqërisë “****” sh.p.k. në janar të vitit 2012.

25.8 Për sa më sipër, nga shqyrtimi dhe analizimi i deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI në harmoni me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në konkluzionin se në fund të vitit 2012 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë disponuar shumën prej rreth 1.5 milion lekësh në gjendje *cash*, me burim të ardhurat e kthyera nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., në janar të vitit 2012.

25.9 Sa i përket pretendimeve të subjektit për shtesa të likuiditeteve *cash* përgjatë viteve 2013 – 2015, Komisioni çmon se ato mbeten të karakterit deklarativ dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare do të vlerësohet se si burim për mbulimin e shpenzimeve shtesë të arredimit/mobilimit të kryera në vitin 2016 dhe disponimin e gjendjes *cash* në fund të këtij viti – në shumën prej 1 milion lekësh, mund të kenë shërbyer kursimet në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej rreth 1.5 milion lekësh, vlerësuar si gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2012 dhe të padeklaruara si të pakësuara në deklaratat vijuese të pasurisë – përpara vitit 2016, si dhe vlerat e mundshme të kursyera prej të ardhurave nga paga e subjektit dhe e personit të lidhur për vitin 2016 (apo të ardhura të tjera të evidentuara gjatë këtij viti).

25.10 Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për disponimin në fund të vitit 2016 të shumës 1,000,000 lekë, deklaruar nga subjekti si pasuri në formë gjendje likuiditetesh *cash* edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 6

Analiza e treguesve financiarë për vitin 2016	Vlerat në lekë
A) Pasuri	-535 621
Apartament me sip. 113 m ² , ndodhur në rr. “****”, Tiranë	1 623 240
Ndryshim likuiditeti	-2 158 861
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	-535 621
D) Të ardhura	2 023 418
Të ardhura nga paga si gjyqtar, subjekti i rivlerësimit	1 142 192
Të ardhura nga paga, bashkëshortja subjektit (QSUT).	710 501
Të ardhura nga interesat e depozitës në Credins Bank	170 725
E) Shpenzime	2 283 954
Shpenzime jetike	940 368
Shpenzime për mobilimin e apartamentit	1 000 000
Shpenzime shkollimi, djali i subjektit – inst. arsimor “****”	283 391
Shpenzime për udhëtimi jashtë vendit	60 195
Balanca e fondeve (D-C-E)	275 085

25.11 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë vetëdeklaruar kursime të likuiditeteve *cash* deri në datën 31.12.2015 dhe kanë realizuar të ardhura për vitin 2016, të krijuara nga burime financiare të ligjshme, të cilat rezultojnë se mundësojnë plotësisht krijimin dhe disponimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 1,000,000 lekë, në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

❖ **Deklarimi veçmas i personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, znj.A.P**

26. Pasuria automjet tip “**”, vit prodhimi 2010, me vlerë 400,000 lekë, blerë në datën 17.1.2015, me të ardhurat nga: (i) shitja e automjetit tip “****”, datë 17.1.2015, në shumën 300,000 lekë; (ii) kursimet nga paga si mjeke pediatre. Më konkretisht, si burim krijimi ka referuar: “Automjet personal tip “****”, vit prodhimi 2003, shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2015, noter A.H, 300,000 lekë”.**

26.1 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në DIPP-në e vitit 2015, në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër të tjera, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Kontratë shitblerjeje automjeti (blerë) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2015, noter A.H. Blerë për shumën 400,000 lekë”.

26.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e DPSHTRR-së.

26.3 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

DPSHTRR-ja⁸³ konfirmon se bashkëshortja e subjektit, znj. A.P, ka pasur të regjistruar në emrin e saj automjetin me targë AA ***, i cili më parë ka mbajtur targën TR ***, tip “****”, deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti rezulton se është futur në territorin shqiptar në vitin 2010. Në vijim, konstatohet se: (i) në datën 17.1.2015, ky automjet është blerë⁸⁴ nga personi i lidhur për çmimin 400,000 lekë; (ii) në datën 25.1.2019, personi i lidhur e shet⁸⁵ këtë automjet për shumën 400,000 lekë.

Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara nga shitja në datën 17.1.2015 e automjetit tip “****”.

Rezulton se në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër të tjera, personi i lidhur ka deklaruar: “*Kontratë shitblerjeje automjeti (shitur) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2015, noter A.H. Shitur për shumën 250,000 lekë*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit – pjesë e dosjes së hetimit administrativ konstatohet se kemi të bëjmë me automjetin tip “****”, targuar TR *** (në vijim targuar AA ***), blerë nga personi i lidhur në datën 29.9.2010, shitur në datën 17.1.2015. Më konkretisht, nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja, Komisioni konstaton se: (i) në datën 11.9.2010, ky automjet ka hyrë në territorin shqiptar dhe janë kryer procedurat e zhdoganimit të tij, nga ku rezulton se vlera statistikore e tij është shënuar në shumën 240,528 lekë dhe se janë paguar detyrimet doganore në total në vlerën 148,841 lekë; (ii) në datën 29.9.2010, personi i lidhur e blen⁸⁶ këtë automjet nga shtetasi B. L., të patarguar, për shumën 300,000 lekë; (iii) në datën 17.1.2015, personi i lidhur e ka shitur këtë automjet në shumën 250,000 lekë. Në kontratën e shitjes është referuar se kjo shumë paguhet plotësisht, me para në dorë, në momentin e nënshkrimit të saj.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti/personi i lidhur ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me vlerën/të ardhurat e përfituara/ nga shitja e automjetit tip “****”, në datën 17.1.2015.

Nga ana tjetër, sikurse u evidentua më sipër, si burim tjetër për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, personi i lidhur ka deklaruar kursimet nga paga si mjekte pediatre. Por, pas verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, nuk rezulton që subjekti dhe/apo bashkëshortja e tij të kenë deklaruar shtesa/gjendje likuiditetesh *cash*, specifikisht me burim të ardhurat e personit të lidhur nga paga si mjekte. Po ashtu, duket se të ardhurat e saj nga paga, të përfituara në muajin janar 2015 (para blerjes së pasurisë objekt vlerësimi), nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar pjesën e mbetur të çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, krahas të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit tip “****”.

26.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për konstatimet e mësipërme

Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka referuar deklaratimet e bëra nga personi i lidhur në deklaratën e rivlerësimit kalimtar dhe në DIPP-në e vitit 2015, sa i përket pakësimit/shitjes së automjetit tip “****” dhe të ardhurave të përfituara si rrjedhojë e këtij transaksioni, duke evidentuar se deklarimi i bërë në formularin e vitit 2015 përputhet me faktin, pra se kjo pasuri

⁸³ Shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 23.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.9.2020.

⁸⁴ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2015, redaktuar nga noteri publik, z. A.H.

⁸⁵ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2019, redaktuar nga noteri publik, znj. Dh.Q

⁸⁶ Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme automjet nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. Sh.Gj.

është shitur në datën 17.1.2015, në shumën 250,000 lekë. Subjekti deklaron se bashkëshortja e tij, gabimisht, ka referuar në deklaratën *Vetting* se ky automjet është shitur në shumën 300,000 lekë.

Në vijim parashtron se po në të njëjtën datë që është kryer shitja e automjetit tip “****”, është blerë automjeti tip “****”, në shumën 400,000 lekë.

Sa i përket burimit të krijimit të shumës 400,000 lekë, paguar në datën 17.1.2015 për blerjen e automjetit tip “****”, subjekti ka deklaruar se pagesa është kryer *cash*, me burim të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “****”, në shumën 250,000 dhe vlerën 150,000 lekë nga kursimet familjare, pavarësisht se në deklaratën *Vetting* është shënuar nga bashkëshortja e tij specifikisht me të ardhurat e saj nga puna si mjeke. Në këtë kontekst, subjekti ka argumentuar se në muajin janar 2015 ka kaluar rroga e muajit dhjetor 2014, si dhe se në deklaratimet e mëparshme janë deklaruar likuiditete *cash*, të cilat kanë qenë gjendje në fund të vitit 2015. Pra, referon se ka pasur një situatë të shëndoshë financiare, e cila mundësonte tërësisht plotësimin e shumës 400,000 lekë për likuidimin e çmimit të blerjes së automjetit tip “****”, në datën 17.1.2015.

Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: (i) Sa i përket konstatimit të parë pranohet pasaktësia në deklarimin e bërë, por nga ana tjetër provohet se me dorëzimin e deklaratës *Vetting* ka depozituar dokumentacionin e shitjes së këtij automjeti, në të cilin evidentohet plotësisht çmimi i shitblerjes së kësaj pasurie (pasaktësia në deklarim në shumën prej 50,000 lekë). Në këtë aspekt, subjekti kërkon të mbahet në vëmendje nga Komisioni edhe përcaktimi i nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; (ii) Gjithashtu, edhe lidhur me konstatimin e dytë pranohet pasaktësia në deklarimin e bërë, duke evidentuar faktin se është kryer nga personi i lidhur, por edhe se praktikisht të ardhurat e përfituara prej saj nga puna si mjeke kanë shërbyer në ndihmë të ekonomisë familjare, duke u përzier në një farë kuptimi me likuiditetet *cash* që disponoheshin nga familja, megjithëse ato nuk kanë pësuar ndryshime në vlerën në fund të viteve përkatëse me burim konkret të ardhurat nga puna e personit të lidhur si mjeke. Gjithsesi, subjekti argumenton se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të disponuara në gjendje *cash*, të cilat së bashku me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “****” mundësojnë plotësisht pagesën e kryer për blerjen e automjetit tip “****”, në datën 17.1.2015.

26.5 Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

Pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2015, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoji në seancë dëgjimore, Komisioni arsyetoi sa vijon:

Së pari, sa i përket pasaktësisë së evidentuar në deklarimin e vlerës së shitjes së automjetit tip “****”, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* – e ardhur e referuar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, trupi gjykues krijoi bindjen se kemi të bëjmë me “lapsus” në deklarim, lehtësisht i identifikueshëm, për sa kohë rezultoi e provuar se bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kontratën e shitjes së kësaj pasurie (ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së), në të cilën referohet vlera e shitjes prej 250,000 lekësh, si dhe konstatohet se në DIPP-në e vitit 2015 personi i lidhur, krahas të dhënave të tjera lidhur me transaksionin e shitblerjes së kësaj pasurie, ka deklaruar vlerën e shitjes prej 250,000 lekësh e, në këtë kuptim, Komisioni vlerëson gjithashtu se ky deklarim përbën provë për efekt të këtij procesi, në përputhje me nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016.

Së dyti, edhe sa i përket evidentimit të faktit të mosdeklarimit specifikisht të shtesave të likuiditeteve *cash* me burim të ardhurat nga puna si mjeke e personit të lidhur dhe rrethanës së vlerësuar se të ardhurat nga paga e saj të përfituara në muajin janar të vitit 2015 (para blerjes së pasurisë objekt vlerësimi) nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar pjesën e mbetur të çmimit

të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, krahas të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit tip “***” konstatohet se subjekti ka pranuar pasaktësinë në deklarin e bërë duke referuar se kemi të bëjmë me deklarim të plotësuar nga personi i lidhur dhe se të ardhurat e përfituara prej saj kanë qenë ndihmesë e ekonomisë familjare – të cilat kanë bërë të mundur mospakësimin e likuiditeteve *cash*. Në këtë kontekst, për efekt të këtij procesi, ashtu sikurse ka argumentuar edhe subjekti, trupi gjykues i jep rëndësi analizimit të faktit nëse ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme (përfshirë këtu edhe të ardhurat e marra nga paga e personit të lidhur në fillim të muajit janar 2015) për të mundësuar likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, automjetit tip “***”.

Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për likuidimin e çmimit të blerjes së automjetit tip “***”, në datën 17.1.2015, në shumën 400,000 lekë – Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 17.1.2015, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 7

Analiza e treguesve financiar për periudhën 1.1.2015 – 17.1.2015	Vlerat në lekë
A) Pasuri	-1 056 342
Automjet tip “***”, blerë në datën 17.1.2015	400 000
Ndryshim likuiditeti	-1 456 342
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	-1 056 342
D) Të ardhura	399 159
Të ardhura nga paga e subjektit si gjyqtar	85 521
Të ardhura nga paga e personit të lidhur si mjeke (QSUT)	63 638
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “***”, në datën 17.1.2015	250 000
E) Shpenzime	41 783
Shpenzime jetike	41 783
Balanca e fondeve (D-C-E)	1 413 718

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, automjetit tip “***”. Në vijim të arsytimit, trupi gjykues çmon se bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasaktësitë e konstatuara në deklarim, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

27. Analiza financiare

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklarin e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhat tetor 2001⁸⁷ – shtator 2005, tetor 2005⁸⁸ – dhjetor 2005 dhe për vitet 2006 – 2016, nga ku rezulton se ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht

⁸⁷ Periudhë në të cilën evidentohet punësimi i parë i subjektit dhe të ardhura të përfituara prej tij nga kjo marrëdhënie.

⁸⁸ Periudhë që përkon me emërimin si gjyqtar dhe caktimin për të kryer stazhin profesional.

krijimin/shtesat e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhat objekt analize⁸⁹.

28. Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

28.1 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

28.2 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

28.3 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaratim nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

28.4 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

28.5 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

29. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

30. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁹⁰ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

⁸⁹ Referojuni tabelës përmbledhëse të analizës së treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

⁹⁰ Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 31.10.2017.

31. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.

32. Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja, të mundshme, të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani. AKSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit, mbas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës, për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, në veprimtari të kundërligjshme.

33. Në këtë kontekst, AKSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, por me vendimin nr. ***, datë 17.6.2022, të KDZH-së, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës⁹¹.

34. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

35. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

36. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, për periudhën tetor 2005 – qershor 2006, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit (stazhier) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; për periudhën nëntor 2006 – mars 2010 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; për periudhën prill 2010 – aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

37. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale⁹², i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dokumenteve ligjore/dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

37.1 Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ka shfaqur aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe në arsyetimin ligjor. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Konstatohet se ky gjyqtar ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, si dhe për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo

⁹¹ Dërguar raporti i kontrollit të figurës i deklasifikuar plotësisht, me shkresën e DSIK-së (sot AKSIK) nr. *** prot., datë 21.6.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.6.2022.

⁹² Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 23.11.2021.

presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

37.2 Por, gjithsesi, nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, në raport janë listuar disa gjetje e, më konkretisht: (i) në një rast nuk është respektuar afati standard i gjykimit; (ii) janë evidentuar raste ku vendi i zhvillimit të seancave gjyqësore (sallë apo zyrë) nuk është dokumentuar, si dhe seancat gjyqësore nuk janë regjistruar audio.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

38. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, nga ku duket se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me kriterin e vlerësimit profesional. Por, nga ana tjetër duket se qëndrojnë gjetjet e evidentuara në raportin për analizën e aftësive profesionale, për të cilat subjektit iu kërkuan shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit.

39. Në vlerësimin e gjyqtarit Ervin Pollozhani u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 23 denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të tyre, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës dhe/apo i kërkoi të japë shpjegime për çështje gjyqësore të gjykuara prej tij që lidhen me 12 ankesa të depozituara nga publiku. Kështu, Komisioni i kërkoi subjektit në mënyrë të përgjithshme të japë shpjegimet / sqarimet / argumentet e tij mbi këto ankesa, për të gjitha pretendimet e ngritura nga denoncuesit, gjetjet e evidentuara, si dhe të provojë e referojë me dokumente justifikuese ligjore veprimet e kryera prej tij në proceset gjyqësore që lidhen me çështjet objekt denoncimi.

40. Më specifikisht, për efekt të këtij procesi, trupi gjykues çmoi të analizojë dhe të shqyrtojë në këtë vendim problematikat e pretenduara dhe gjetjet e evidentuara nga trajtimi i 6 çështjeve gjyqësore që lidhen me denoncimet e depozituara nga publiku, si dhe shpjegimet dhe dokumentacionin provues të depozituar nga subjekti lidhur me to, për të cilat evidentohet se paraqesin në tërësi të gjitha problematikat, gjetjet dhe kërkesat e bëra nga Komisioni për 12 çështjet, për të cilat iu kërkuan shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit⁹³.

40.1 Denoncim i shtetasit G.B⁹⁴

Denoncuesi pretendon se në vendimin e dhënë gjyqtari Ervin Pollozhani ka kryer shkelje të ligjit dhe Kushtetutës (i referohet vendimit nr. ***, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) se janë përdorur prova të rreme, ekspertiza të pavlefshme, si dhe nuk janë marrë në shqyrtim provat shkresore dhe të ligjshme që ndodhen në dosjen gjyqësore (në dy shkallët e gjyqësorit).

Më konkretisht, në lidhje me gjyqtarin Ervin Pollozhani pretendon se: (i) ka injoruar dokumentacionin ligjor; (ii) ka pranuar një kundërpadi të paligjshme nga pala e paditur – duke bërë bashkimin e padisë me kundërpadinë dhe duke vijuar gjykimin e tyre në të njëjtën çështje; (iii) ka orientuar dy akte ekspertize të pathemelta ligjërisht dhe profesionalisht; (iv) i ka hequr çështjes bazat ligjore, duke u bazuar në baza joligjore, duke mohuar provat ekzistuese dhe duke marrë për të mirëqena si prova, fakte të paqena e të pavërteta.

⁹³ Për më tepër evidentohet se në prapësimet e tij – subjekti ka dhënë argumente të njëjta për çështje të ndryshme të denoncuar, lidhur për problematikat e pretenduara, gjetjet e evidentuara apo kërkesat e bëra nga Komisioni.

⁹⁴ Ankesë nr. *** prot., datë 14.12.2017.

Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁹⁵, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁹⁶ ka dërguar aktet e dosjes gjyqësore të vendimit nr. ***, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar që lidhet me çështjen objekt ankese, nga ku duket se denoncuesi shfaqet në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “****” sh.p.k., Komisioni konstaton se:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga gjyqtari Ervin Pollozhani, për çështjen gjyqësore civile me paditës i kundërpaditur shoqëria “****” sh.p.k.; i paditur kundërpaditës shoqëria “****” sh.p.k.; me objekt “1. Përmbushje detyrimi kontraktor duke detyruar palën e paditur të paguajë shumën 129,600 euro, si vlerë e punimeve të kryera. 2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë kushtin penal të parashikuar në kontratë. 3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë kamatat ligjore për pjesën e pashlyer të detyrimit. 4. Sigurimin e padisë...”, në datën 6.5.2013, ka vendosur⁹⁷: (1) Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; (2) Detyrimin e palës së paditur-kundërpaditëse shoqëria “****” sh.p.k., t’i paguajë palës paditëse “****” sh.p.k. shumën 35,841 euro si detyrim kontraktual i papaguar; (3) Rrëzimin e kërkesëpadisë për vlerat e tjera të kërimit dhe për kërkimet e pagimit të kushtit penal, si dhe të kamatave ligjore mbi këtë shumë; (4) Ligjërimin e sigurimit të kërkesëpadisë të marrë me vendimin e datës 6.1.2012; (5) Pranimin e kundërpadisë; (6) Detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur shoqëria “****” sh.p.k. të dëmshpërblejë palën e paditur-kundërpaditëse shoqëria “****” sh.p.k. në shumën 61,207 euro, për dëmin e shkaktuar asaj etj.

ii) Pas ankimit të bërë nga paditësi-i kundërpaditur, shoqëria “****” sh.p.k., në datën 8.10.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur⁹⁸ lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

iii) Kundër vendimit të Apelit ka paraqitur rekurs, si dhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, pala paditëse e kundërpaditur shoqëria “****” sh.p.k. Pas shqyrtimit të këtij rekursi, në datën 31.10.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: (1) Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse e kundërpaditur “****” sh.p.k., kundër vendimit nr. ***, datë 8.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë; (2) Prishjen e vendimit nr. ***, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr. ***, datë 8.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit për kundërpadinë.

Në arsyetimin e vendimit, ndër të tjera, Gjykata e Lartë ka argumentuar se në lidhje me kundërpadinë, të dyja gjykatat kanë bërë interpretim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Sipas Kolegjit të Gjykatës së Lartë, pala e paditur kundërpaditëse ka depozituar një kundërpadi me objekt shpërblim dëmi, me pretendimin se ky kërkim buron nga një marrëdhënie jashtëkontraktore. Kolegji ka vlerësuar se ky pretendim i palës së paditur për mënyrën si është kërkuar, nuk është i bazuar në ligj dhe nuk mund të ngrihet si i tillë, ndaj edhe duhet të vendoset prishja e të dyja vendimeve dhe pushimi i gjykimit të çështjes për kundërpadinë.

Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet/sqarimet e tij mbi pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe të provojë apo referojë me dokumente justifikuese veprimet e kryera prej tij në shqyrtimin e çështjes objekt denoncimi. Gjithashtu, iu kërkua të japë argumentet e tij për rrethanat e relatuar si më sipër, në referim të të cilave rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit për kundërpadinë, duke vlerësuar se është bërë interpretim i gabuar i ligjit material dhe procedural.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 19.5.2023, e Komisionit.

⁹⁶ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. *** prot., datë 19.5.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.5.2023.

⁹⁷ Vendimi nr. ***, datë 6.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁸ Vendimi nr. ***, datë 8.10.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve edhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, gjetjet dhe kërkesat e bëra, ka parashtruar se në bindjen e tij, vendimmarrja ka qenë e drejtë dhe e bazuar tërësisht në prova dhe në ligj. Referon se në dhënien e vendimit është treguar i paanshëm, duke mos favorizuar asnjërën palë, si dhe është udhëhequr si gjithmonë nga parimi i kontradiktoritetit. Në vijim argumenton se vetëm pas një hetimi të gjithanshëm, të plotë, duke marrë në shqyrtim të gjitha provat materiale dhe vetëm duke vepruar sipas dhe në referim të ligjit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe pranimin e kundërpadisë. Në përfundim, në arsyetimin e vendimit ka analizuar faktet dhe provat e paraqitura nga palët, si dhe ka arsyetuar shkaqet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja. Parashtron se ka cilësuar faktet dhe veprimet që lidhen me mosmarrëveshjen konkrete të lindur ndërmjet palëve. Në referim të neneve 6, 10, 14 dhe 20 e vijues të Kodit të Procedurës Civile ka gjykuar dhe është shprehur vetëm mbi kërkesat e palëve, si dhe se vendimmarrjen e ka mbështetur vetëm mbi faktet që janë paraqitur në proces nga palët ndërgjyqëse.

Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se vendimmarrja procedurale për pranimin për shqyrtim të kundërpadisë bashkë me kërkesëpadinë, kjo në referim të nenit 160 të Kodit të Procedurës Civile kishte të bënte me plotësimin e kushteve ligjore nga kjo dispozitë, pra lidhja midis tyre (koneksiteti) dhe mundësia e kompensimit, gjë që në bindjen e brendshme të gjykatës janë vlerësuar se plotësoheshin, kjo edhe për ekonomi gjyqësore. Kjo vendimmarrje është vlerësuar si e tillë pozitivisht edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë. Nga ana tjetër, referon se vlerësimi i ndryshëm i bërë nga Gjykata e Lartë ka ndodhur pas kohës që ankuesi ka paraqitur ankimin pranë Komisionit. Por, gjithsesi, kjo rrethanë pavarësisht koherencës/relevancës së saj në bindjen e gjykatës si një kriter kushtetues për dhënien e drejtësisë, është çmuar si e tillë. Vendimmarrjet procedurale për mbarëvajtjen e procesit, ku si e tillë është edhe ajo për shqyrtimin e padisë me kundërpadinë, janë tagër absolut i gjykatës, të cilat korrigjohen si të tilla nga sistemi gjyqësor hierarkik. Në këtë kuptim, subjekti argumenton se vendimmarrja e Gjykatës së Lartë ka të bëjë me pushimin e gjykimit të kundërpadisë si padi që nuk mund të ngrihej me shkakun ligjor të dëmit jashtëkontraktor, ndërkohë që marrëdhënia buronte nga ajo kontraktore.

Subjekti prapëson se referuar vendimit unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, lidhur me shkakun ligjor të kërkesëpadisë/kundërpadisë, gjykata, nisur nga parimi *iuria novit curia* (gjykata e njeh ligjin) çmon se në rastin konkret shkakun ligjor i kundërpadisë ka qenë i qartë dhe i kuptueshëm në lidhje me objektin e kërtimeve të pretenduara. Sipas këtij vendimi është unifikuar se gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit, duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar. Në këtë aspekt, thekson se të gjitha pretendimet që ankuesi paraqet lidhen me themelin e çështjes, ndërkohë që për këtë fakt asnjë gjykatë që ka shqyrtuar këtë çështje nuk ka analizuar dhe konkluduar se gjyqtari: (i) ka injoruar dokumentacionin ligjor; (ii) ka orientuar dy akte ekspertize të pathemelta ligjërisht dhe profesionalisht; (iii) i ka hequr çështjes bazat ligjore, duke u bazuar në baza joligjore, duke mohuar provat ekzistuese dhe duke marrë për të mirëqena si prova, fakte të paqena e të pavërteta. E vetmja vendimmarrje e Gjykatës së Lartë ka qenë ajo e prishjes së vendimit dhe pushimit të gjykimit të çështjes si kundërpadi që nuk mund të ngrihej për këtë shkak ligjor (dëm jashtëkontraktor).

Në vijim, subjekti deklaron se në bindjen e tij të brendshme ka bërë analizimin e çështjes dhe se në kuptim të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e, konkretisht, referuar në nenin 72/4 të tij, i cili përcakton se “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrehtësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa

zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 40 - 45 të tij, kjo vendimmarrje e Gjykatës së Lartë nuk mund të ndikojë në vlerësimin e aftësive profesionale apo të përbjë premise për masë disiplinore.

Lidhur me këtë moment, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit rekomandimin e Këshillit të Ministrave të Evropës, drejtuar vendeve anëtare CM/Rec (2010)12, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17.11.2010, ku përcakton në nenin 23 të tij se: “Gjykatat superiore nuk duhet t’u japin udhëzime gjyqtarëve lidhur me mënyrën se si duhet të vendosin në raste individuale, me përjashtim të vendimeve paraprake ose kur vendoset për mjete juridike sipas ligjit”.

Po kështu, argumenton se lidhur me “imunitetin” e magjistratëve në shprehjen e opinioneve ligjore, një ndër standardet më të rëndësishme në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale është garantimi i opinioneve ligjore të shprehura në vendimmarrje nga magjistratët gjatë punës së tyre, të cilat janë objekt vlerësimi nga Komisioni apo Kolegji.

Në vijim të prapësimeve lidhur me këtë denoncim subjekti referon se në opinionin “*Amicus Curiae*” drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga Komisioni i Venecias u theksua se: “[...] nga pikëpamja e pavarësisë së gjyqësorit, gjatë vlerësimit të aftësive profesionale, Gjykata Kushtetuese mund të marrë në konsideratë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ⁹⁹”. Evidenton gjithashtu se i njëjti qëndrim u mbështet edhe nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjit të *Vetting*-ut, nr. 2, datë 18.1.2017, ku, ndër të tjera, gjykata vlerësoi të theksonte se: “Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale¹⁰⁰”.

Subjekti referon se një garanci e tillë është parashikuar edhe në ligjin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, dispozitat e të cilit gjejnë zbatim për aq sa mundet edhe në rivlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve në kuadër të realizimit të procesit të *Vetting*-ut. Konkretisht, ky ligj parashikon se “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet¹⁰¹”, dispozitë e cila sipas subjektit thirret për zbatim nga ligji nr. 84/2014, me referim në parashikimin e nenit 43, pika 1 e tij¹⁰². Kështu që, nisur nga ky parashikim, por edhe nga qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, argumenton se vendosja e këtij standardi e ka kufizuar kompetencën lëndore të organeve të rivlerësimit në vlerësimin që këto të fundit i bëjnë kriterit të aftësive profesionale. Në këtë kuptim, parashtron se vlerësimi profesional nga organet e rivlerësimit analizon aftësitë profesionale të një gjyqtari nga një këndvështrim relativisht teknik, i cili nuk gjykon korrektësinë e vendimit dhe në asnjë rast themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet¹⁰³.

⁹⁹ Shihni: CDL-AD (2016) 036 Opinion *Amicus Curiae* për Gjykatën Kushtetuese “Për ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, paragrafi 35.

¹⁰⁰ Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, paragrafi 54.

¹⁰¹ Shihni pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁰² Shihni nenin 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: “Procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm”.

¹⁰³ Referon vendimin nr. 3, datë 4.3.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 35.6.

Në përfundim të prapësimeve të tij lidhur me çështjen objekt denoncimi, subjekti ka referuar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në rivlerësimin e subjektit G.M, ku orientohet rivlerësimi i aftësive profesionale dhe është parashtruar, ndër tjera se: *“Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, ka rëndësi garantimi se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, duke iu referuar opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias¹⁰⁴”.*

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim

Komisioni, pasi vlerësoi dhe shqyrtoi me objektivitet në tërësi këtë ankesë në raport me prapësimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në këtë kuadër, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet e evidentuara dhe pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe se nuk konstatohen problematika thelbësore të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale.

40.2 Denoncimi i shtetasit S.H (subjekti me emër tregtar “**”)¹⁰⁵ dhe denoncimi i avokatit E.J¹⁰⁶**

Duket se ankesa e subjektit tregtar “****”, person fizik, përfaqësuar nga shtetasi S. H, paraqitet në formën e një kallëzimi penal ndaj subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Ervin Pollozhani, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, dërguar për dijeni Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga verifikimi i këtij materiali duket se denoncuesi ka paraqitur rrethanat e fakteve, si vijon:

- Fillimisht informon se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është depozituar kërkesëpapia me paditës: shoqëria “****” sh.a.; të paditur: (1) shoqëria “****” sh.p.k.; (2) shoqëria “****” sh.p.k.; (3) “****”, person fizik, me emër tregtar “****”; me objekt: Pavlefshmëri të titujve ekzekutivë; Pezullimi i ekzekutimit të detyrueshëm (regjistruar me nr. *** akti, datë 25.6.2018).

- Më herët, në një proces tjetër gjyqësor ku palë ka qenë shoqëria “****” sh.a., sipas shortit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ajo çështje do të gjykohej nga gjyqtari Ervin Pollozhani, i cili ka dhënë dorëheqjen nga ky gjykim, ku ka treguar shkaqet e dorëheqjes nga ai gjykim, shkaqe të cilat denoncuesi referon se janë pranuar nga kryetari i gjykatës, duke proceduar me miratimin e kërkesës së dorëheqjes së gjyqtarit Ervin Pollozhani nga gjykimi i procesit, për çështjen civile të regjistruar me nr. *** akti, datë 18.1.2016.

- Në procesin civil, ku denoncuesi shfaqet në cilësinë e të paditurit, ai hedh dyshime se kjo çështje jo rastësisht i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit Pollozhani, i cili ka vijuar me regjistrimin e çështjes dhe se nëpërmjet sistemit të gjykatës është njohur me datën e seancës së parë gjyqësore, datë 9.7.2018. Duke pasur dyshimin se çështja mund të gjykohej në një mënyrë të padrejtë, pasi në rastin e parë gjyqtari Pollozhani dha dorëheqjen, denoncuesi referon se ka paraqitur në sekretarinë e gjykatës kërkesën për përjashtimin e tij.

- Sipas denoncuesit, në seancën e datës 9.7.2018, gjyqtari Ervin Pollozhani, pasi relatoi çështjen objekt gjykimi, në vijim relatoi kërkesën e bërë për përjashtimin e tij, të depozituar në sekretarinë e gjykatës, duke marrë vendimin *“Pavarësisht kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, do të paraqesë kërkesë për dorëheqje përpara Kryetarit të Gjykatës”* dhe ndërpret seancën, duke shpjeguar se për seancën e radhës do të njoftohen me fletëthirrje.

¹⁰⁴ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 21 (JR), datë 13.9.2019, paragrafi 16.

¹⁰⁵ Ankesë nr. *** prot., datë 13.7.2018.

¹⁰⁶ Ankesë nr. *** prot., datë 12.8.2022.

- Pas përfundimit të seancës, brenda një ore gjyqtari ka caktuar seancën e radhës datë 11.7.2018, me arsyetimin se kryetarja e gjykatës nuk e ka marrë për bazë dorëheqjen e gjyqtarit Ervin Pollozhani. Ndërkohë, sipas denoncuesit kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit Ervin Pollozhani është regjistruar me nr. çështje ***, datë 9.7.2018, dhe sipas shortit të hedhur kjo çështje do të gjykohet nga gjyqtari A. A dhe deri në orën 16:00 të datës 11.7.2018, dosja nuk ka kaluar pranë gjyqtarit për të caktuar seancën (gjykimi në dhomë këshillimi),

- Në vijim, denoncuesi parashtron se në seancën e datës 11.7.2018, gjyqtari Ervin Pollozhani, pasi relatoi prezencën e palëve, vijoi për zhvillimin e seancës përgatitore me arsyetimin se sipas objektit të padisë është kërkuar edhe pezullimi i ekzekutimit të urdhrave të ekzekutimit, duke i dhënë fjalën palës paditëse që të paraqiste pretendimet. Sipas denoncuesit, megjithëse përfaqësuesi i tij ligjor kërkoi menjëherë fjalën, duke kundërshtuar me argumentin se kishin bërë kërkesë për përjashtimin nga ky gjykim, pra se derisa të gjykohet kjo kërkesë ai nuk mund të vazhdonte të zhvillonte seancën, pasi ligji ka parashikuar se edhe sikur të vazhdonte seancën, nuk kishte të drejtë të merrte vendime (neni 75 i Kodit të Procedurës Civile). Por, sipas denoncuesit, gjyqtari Pollozhani, ka vijuar me procesin duke i dhënë fjalën palës paditëse, ku kërkoi saktësim dhe shtim të objektit të padisë, sigurimin e padisë.

- Në përfundim, denoncuesi pretendon se avokati i tij nuk mundi dot të parashtronte në mënyrë të saktë kundërshtimet dhe provat, pasi disa herë gjyqtari e refuzoi duke e ndërprerë. Ndërsa, me palën paditëse nuk veprroi në të njëjtën mënyrë, pasi referon se jo vetëm pranoi ta dëgjojë për gjithçka që tha, por edhe e orientoi për ato që kërkonte, pasi me kërkesat e reja doli jashtë objektit të padisë, ndryshoi tërësisht kërkimin dhe në rast se gjyqtari Pollozhani do të linte pa i ndërhyrë avokatit të palës paditëse nuk do të kishin vendim pezullimi. Denoncuesi pretendon se edhe pse pala paditëse kërkoi sigurimin e padisë sipas kërkimit të ri, gjyqtari vendosi për kërkimin e parë në kërkesëpadi, pezullimin e ekzekutimit të urdhrave ekzekutivë.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se denoncimi i avokatit E.J lidhet me denoncimin e bërë nga subjekti tregtar “***”. Në denoncimin e bërë, ky shtetas referon se gjyqtari Pollozhani ka bërë kallëzim penal të padrejtë ndaj tij duke pretenduar se: (i) ka përdorur stemën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në shkresat e veta personale; (ii) ka ushtruar ankim pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duke dashur të justifikojë vendimin e paligjshëm të dhënë ndaj klientit të tij (subjektit tregtar “***”, person fizik); (iii) në të gjitha veprimet e kryera ndaj tij ka shfrytëzuar postin për interesa personale; (iv) ka dhënë disa vendime, të cilat janë dukshëm të njëanshme, duke vepruar me dy standarde. Gjithashtu, në ankesë janë pasqyruar me detaje rrethana procedurale të gjykimit që lidhen me çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse “***”, ku denoncuesi identifikohet si përfaqësues ligjor i kësaj pale, duke u pretenduar shkelje të shumta të kryera nga gjyqtari Pollozhani.

Pas kërkesave të bëra nga Komisioni¹⁰⁷: (1) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹⁰⁸ dërgoi kopje të vendimit nr. *** akti, datë 11.7.2018, me paditës shoqëria “****” sh.a., duke informuar se aktet e këtij vendimi janë pjesë e dosjes gjyqësore me nr. *** vendimi, datë 19.6.2019, vendim i cili është me statusin “ankimuar” dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (2) Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm¹⁰⁹ ka dërguar dosjen gjyqësore me nr. *** vendimi, datë 19.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që lidhet me çështjen objekt denoncimi.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës duke i kërkuar të japë shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij shteruese mbi këto denoncime për të gjitha pretendimet e ngritura nga denoncuesit dhe të provojë apo referojë me dokumente justifikuese

¹⁰⁷ Shkresat e Komisionit: (i) nr. *** prot., datë 19.5.2023; (ii) nr. *** prot., datë 24.5.2023.

¹⁰⁸ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. *** prot., datë 19.5.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.5.2023.

¹⁰⁹ Shkresa e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. *** prot., datë 16.6.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.6.2023.

veprimet e kryera prej tij në procesin gjyqësor të referuar në ankesat e bëra dhe mbi vendimmarrjen përkatëse. Gjithashtu, iu kërkua të deklarojë duke konfirmuar nëse ka dijeni mbi depozitimin e kallëzimeve penale ndaj tij që lidhen me çështjen objekt denoncimi e, në këtë kontekst, nëse është thërritur dhe pyetur nga Prokuroria lidhur me këtë çështje e, nëse po, të japë detaje mbi fazën në të cilën ndodhet kallëzimi/procedimi penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e prapësimeve, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore publike lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, gjetjet dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar sa vijon:

- Në lidhje me denoncimin e kryer nga shtetasi S.H, për të cilin ka vendosur me anë të vendimit nr. *** regj. themeltar, datë 11.7.2018, pretendon se vendimmarrja e tij ka qenë e drejtë dhe e bazuar tërësisht në prova dhe në ligj, si edhe në dhënien e vendimit jopërfundimtar është treguar i paanshëm, duke mos favorizuar asnjërën palë dhe është udhëhequr si gjithmonë nga parimi i kontradiktoritetit. Subjekti parashtron se vetëm pas një hetimi të gjithanshëm, të plotë, duke marrë në shqyrtim të gjitha provat materiale dhe vetëm duke vepruar sipas/dhe në referim të ligjit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërimit të kërkesëpadisë për pezullimin e zbatimit të titujve ekzekutivë.

Gjithashtu deklaroi se në përfundim, në arsyetimin e vendimit ka analizuar faktet dhe provat e paraqitura nga palët, si dhe ka arsyetuar shkaqet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja e tij. Ka cilësuar faktet dhe veprimet që lidhen me mosmarrëveshjen konkrete të lindur ndërmjet palëve. Në referim të neneve 6, 10, 14 dhe 20 e vijues të Kodit të Procedurës Civile ka gjykuar dhe është shprehur vetëm mbi kërkesat e palëve, si dhe se vendimmarrjen e ka mbështetur vetëm mbi faktet që janë paraqitur në proces nga palët ndërgjyqëse. Sipas subjektit, zhvillimi i procesit është drejtuar duke garantuar parimin e kontradiktoritetit në kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm dhe në përputhje të plotë me ligjin.

Subjekti evidenton faktin se ky vendim është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj nr. ***, datë 29.10.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 11.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Referon se në këtë vendim të Gjykatës së Apelit në mënyrë shteruese në faqen 9 të tij, shpjegohet dhe argumentohet tërësisht gjithë ligjshmëria e veprimeve procedurale të marra nga trupi gjykues (i shkallës së parë), duke cituar në prapësimet e tij, pjesë të këtij vendimi.

Ndërsa, lidhur me kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues (përjashtimin e tij) të gjykuar nga trupi tjetër gjykues, me gjyqtar A.A, citon se nga ky i fundit me vendimin nr. *** akti, datë 16.7.2018, është disponuar me rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e këtij trupit gjykues duke çmuar se gjykata nuk ka shkaqe ligjore për përjashtimin e këtij trupit gjykues. Deklaron se nga kjo çështje është larguar vetëm pas paraqitjes së kërkesës për heqje dorë për shkak të kallëzimit penal të paraqitur nga pala ankuese, duke u gjetur tashmë kjo kërkesë e drejtë nga kryetari i gjykatës, në referim të nenit 72/3 të Kodit të Procedurës Civile.

Po kështu, referon se për këtë vendim është paraqitur kallëzim penal ndaj trupit gjykues dhe për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin datë 1.8.2018, ka vendosur: “Të mos fillojë procedim penal për materialin e kallëzuar të paraqitur nga shtetasi S. H, në cilësinë e përfaqësuesit të personit fizik “****” sh.p.k., ndaj shtetasit Ervin Pollozhani, me detyrën gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Subjekti informon Komisionin se ndaj këtij vendimi është ushtruar ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku kjo e fundit me vendimin nr. (***) ***, datë 16.10.2018, ka vendosur “Të mos pranojë kërkesën e kërkuarit S.H, të datës 17.9.2018, me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, datë 1.8.2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, si të pabazuar në ligj”. Gjithashtu, subjekti evidenton faktin se ky shtetas ka paraqitur ankimi ndaj tij dhe në ILD dhe se kjo e fundit, me vendimin nr. *** prot., datë 15.5.2023, ka vendosur “Arkivimin e ankesave

të bashkuara nr. *** prot., datë 23.7.2018, datë 28.9.2018, të ankuesit S.H ”, duke mos gjetur shkelje ligjore¹¹⁰.

Në referim të të gjitha rrethanave të parashtruara si më sipër, subjekti pretendon se ndaj tij nuk është konstatuar asnjë lloj shkelje procedurale apo interpretim i gabuar i zgjidhjes së çështjes objekt denoncimi, si edhe nuk janë konstatuar elemente të veprës penale “shpërdorimi i detyrës”.

- *Sa i përket ankesës së bërë nga avokati E.J, e cila lidhet me çështjen objekt denoncimi, deklaron se i qëndron tërësisht dhe plotësisht të gjitha sqarimeve të sipërcituara për ankimin e z. S.H me shtesën se në bazë të kallëzimit të bërë prej tij, me vendimin penal nr. ***, datë 23.2.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 22.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në këtë mënyrë: “Deklarimin fajtor të të pandehurit E.J për veprën penale “fyerja e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 1 (një) muaj burgim. Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe detyrohet i pandehuri të kryejë një punë në interes publik pa kundërshtëpërblim në masën e 60 orëve punë pranë Bashkisë Tiranë...”*

Referon se paralelisht janë për shqyrtim edhe padia civile e paraqitur prej tij ndaj këtij avokati për shpërblim dëmi jopasuror, si dhe procedimi disiplinor në Komitetin e Disiplinës pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë për ankimin e paraqitur për masë disiplinore ndaj tij.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e ankuesit se gjyqtari: (i) ka përdorur stemën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në shkresat e veta personale; (ii) ka ushtruar ankim pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duke dashur të justifikojë vendimin e paligjshëm të dhënë ndaj klientit të tij (subjektit tregtar “***”, person fizik); (iii) në të gjitha veprimet e kryera ndaj tij ka shfrytëzuar postin për interesa personale; (iv) ka dhënë disa vendime që janë dukshëm të njëanshme, duke vepruar me dy standarde – subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se është e vërtetë se kallëzimin e ka bërë nëpërmjet zyrës së protokollit të Gjykatës pasi këtë kallëzim e ka bërë me cilësinë e gjyqtarit dhe për veprën penale “fyerja e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal, pra për shkak të cilësisë së veçantë dhe jo si individ. Deklaron se këtë praktikë e ka ndjekur në të gjitha kallëzimet e tjera të mëparshme që ka bërë si ndaj individëve apo zyrtarëve të tjerë (noterëve) dhe e konsideron më se legjitime dhe aspak intimiduese këtë standard. Lidhur me pretendimet e tjera të sipërcituara vlerëson se janë shpifje të mirëfillta, të pabazuara në asnjë rrethanë konkrete të shfaqur ndaj tij dhe se i drejtohen Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me qëllimin e vetëm për të dëmtuar figurën e gjyqtarit. Deklaron se këto shpifje të ulëta janë të papajtueshme me etikën dhe profesionalizmin e shfaqur prej tij në gjykim apo edhe jashtë tij.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim:

Nga shqyrtimi në tërësi i këtyre denoncimeve, shpjegimeve të depozituara nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit si edhe dokumentacionit shkresor të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk vërehen fakte apo rrethana të cilat mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektin e rivlerësimit z. Ervin Pollozhani. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim duken bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

¹¹⁰ Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar si provë të re shkresën e ILD-së që referon trajtimin e ankesave të shtetasit S. H.

40.3 Denoncim i shtetasës A.Ç¹¹¹

Shtetasja A.Ç, e cila duket se është administratore falimenti e licencuar, pretendon se gjyqtari Ervin Pollozhani ka kryer shkelje të etikës profesionale dhe shkelje të rënda procedurale në gjykimin e çështjes së falimentit të shoqërisë “****”.

Në denoncim referohet: (a) vendimi nr. *** regj., datë 18.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkarkimin e administratorit të falimentit të shoqërisë “****”; (b) dosja e regjistruar me nr. **, datë 28.2.2018, shprehur në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 19.6.2018. Më konkretisht, shkeljet e pretenduara nga denoncuesja listohen si vijon:

i) Mosrespektimi i afatit për shqyrtimin e ankimit të veçantë, brenda 30 ditëve.

ii) Konflikt i interesit. Denoncuesja pretendon se bashkëshortja e subjektit, znj. A.Ç, është kushërirë e parë me bashkëshortin e motrës së administratores së caktuar, znj. Sh.B. Motra e administratores së re të caktuar, noterja R.H, nga tetori 2015 dhe në vazhdimësi ka dhënë shërbimin e saj si notere për certifikimin e ankandëve dhe shitjeve të realizuara nga shoqëria “****”. Pra, pretendon se ky gjyqtar ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit (rang i dytë krushqie) – duke referuar nenin 73 të Kodit të Procedurës Civile, rrethanë për të cilën thotë se është vënë në dijeni pas përfundimit të procesit në Apel.

iii) Mosrespektimi i parimit të “Kontradiktoritetit”. Sipas denoncueses, gjyqtari ka shkelur parimin e “Kontradiktoritetit”, nenet 18 dhe 20 të Kodit të Procedurës Civile, pasi ka thirrur mbledhjen e kreditorëve në datën 18.2.2018 dhe ka dalë me vendim në po këtë mbledhje për: shkarkimin e Administratores së Falimentit të shoqërisë në faliment “****” sh.p.k., znj. A.Ç, dhe caktimin e një administratori të ri falimenti, duke e bërë këtë vendim të cenusshëm proceduralisht, pasi: (a) Dhe pse u pranua nga gjyqtari “Kërkesa datë 23.11.2017”, e Komitetit të Kreditorëve, depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 5.12.2017, pa pasur kuorumin e duhur – në kundërshtim me nenin 59 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentin”, po ashtu dhe në mungesë të kuorumit vijuan shkeljet e tjera; (b) Ka shkelur të drejtat e kreditorëve në pjesëmarrje në votim; (c) Ka shkelur të drejtat e kreditorëve në lidhje me të drejtën e votës; (ç) Referuar Kodit të Procedurës Civile, në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të këtij ligji, nuk gjykoj mosmarrëveshjen, por imponoi me forcë përfaqësuesit e kreditorëve pjesëmarrës në këtë mbledhje, që të shpreheshin jashtë vullnetit të tyre për shkarkimin e administratorit; (d) Në shkelje të nenit 67 të Kodit Civil, ai ka imponuar edhe kalimin e të drejtës së përfaqësimit, në kundërshtim të hapur me kushtin ligjor “Kufijtë dhe pasojat e përfaqësimit”, pasi të gjithë përfaqësuesit e kreditorëve në këtë mbledhje nuk kishin autorizim të specifikuar, ku të ishte shprehur tagri i dhënë për shkarkimin e administratorit të falimentit dhe motivi i shkarkimit i kërkuar sipas “Rendit të Ditës”. Referon se ky fakt të paktën nuk u dëgjua prej asnjërit në seancë dhe seancat vijuese; (dh) Vendimet janë marrë nën *indicien* e veprimeve juridike të pavlefshme; (e) Gjyqtari e ka marrë vendimin e tij në datën 18.12.2017, bazuar në kërkesën e një organi jolegjitim për këtë proces.

iv) Sipas denoncueses, duket se ligjërisht “Komiteti i Ri i Kreditorëve” nuk arriti të konstituohej në numër dhe emra, atëherë të gjitha aktet e nxjerra prej tij janë nul.

v) Vendime të marra mbi akte juridikisht të pavlefshme: sipas denoncueses, gjyqtari ka marrë vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 18.12.2017, në kundërshtim me nenin 59 të ligjit “Të procedurës së falimentit” nr. 8901, datë 23.5.2002, i ndryshuar, pasi ai është bazuar në dokumente të manipuluar e jo të vërteta si: (a) procesverbali i mbledhjes së kreditorëve datë 10.11.2017; (b) kërkesa e datës 23.11.2017 e Komitetit të Kreditorëve, ku shprehet vendimi i marrë prej tyre i formuluar me të meta të rënda procedurale, duke listuar në vijim edhe shkelje të tjera procedurale të pretenduara.

¹¹¹ Ankesë nr. *** prot., datë 11.9.2018.

vi) Shkelje e Kodit të Etikës në mënyrë të qëllimshme. Sipas denoncueses, vendimi i tij është në kundërshtim me nenin 46 të ligjit “Për falimentin”. Pretendon se gjyqtari Ervin Pollozhani ka paragjykuar veprimtarinë e administratorit të falimentit, duke referuar pjesë nga arsyetimi i vendimit të tij dhe argumentet e saj në mbështetje të këtij pretendimi.

Pas kërkesës së bërë nga Komisioni¹¹², Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹¹³ dërgoi aktet e dosjes gjyqësore nr. *** regj. themeltar, e vitit 2014, ku përfshihet edhe vendimi “Për shkarkimin e administratores së falimentit të shoqërisë në falimentim ***” me nr. *** regj. themeltar, datë 18.12.2017, duke informuar se kjo çështje ndodhet në gjykim pranë gjyqtarit Ervin Pollozhani. Gjithashtu, kjo Gjykatë informon se nga verifikimet e kryera në sistem rezulton se nuk ka çështje/kërkesë të regjistruar me nr. *** (***) akti/vendimi, datë 28.2.2018.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës duke i kërkuar të japë shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij mbi këtë denoncim – për të gjitha pretendimet e ngritura nga denoncuesi dhe të provojë e referojë me dokumente justifikuese veprimet e kryera prej rij në këtë proces gjyqësor.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e prapësimeve, si dhe me shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se *kemi të bëjmë me një nga denoncimet më abuzuese të kryera nga kjo shtetase (i referohet denoncueses), e cila sipas tij në mënyrë flagrante dhe totalisht joprofesionale shpif dhe përpiqet të mbulojë gjithë shkeljet e saj ligjore në periudhën e ushtrimit të këtij funksioni (administratore falimenti), të cilat jo vetëm janë bërë premisë për shkarkimin e saj shumë të vonuar madje si vendim, porse më tej edhe për gjorbitjen e më pas ndjekjen e saj penale dhe për të cilën është dënuar me vendimin penal nr. *** vendimi, datë 27.12.2017, për “Pengim të ekzekutimit të vendimit të gjykatës” në bazë të nenit 320/1 të Kodit Penal, për mosdorëzimin e masës së falimentit dhe dokumentacionit shoqërues, gjë që ka ndodhur nëpërmjet shërbimit përmbartimor si një rast i paprecedent.*

Subjekti argumenton se vendimmarrja e tij për shkarkimin e saj me vendimin nr. *** regj. themeltar datë 18.12.2017, është marrë thjesht dhe jo vetëm në bazë të kërkesës dhe miratimit të Komitetit të Kreditorëve si nismëtar të këtij vendimi, por edhe në vazhden e gjithë përpjekjeve për sensibilizimin dhe përgjegjshmërinë e saj për kryerjen e detyrave ligjore duke njoftuar paraprakisht disa herë vetë Agjencinë e Falimentit si autoriteti që licencon administratorët e falimentit dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre, ministren e Drejtësisë, për sjelljen e saj të paprecedent, abuzuese me detyrën, çka ende sot e kësaj dite procesi i falimentit për shoqërinë “***” sh.a., në kohën që kjo shtetase ka qenë administratore e falimentit, po e vuan ende. Kjo, sipas tij, për shkak se me mosveprimet e saj në shkelje të ligjit kanë sjell dëme ekonomike të mëdha dhe të pariparueshme. Në vijim, subjekti pretendon se të gjitha shprehjet e mësipërme nga ana e ankueses janë shpifje të mirëfillta, të pabazuara në asnjë rrethanë konkrete të shfaqur gjatë gjykimit dhe i drejtohen Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me qëllimin e vetëm për të dëmtuar figurën e gjyqtarit. Sipas subjektit, këto shpifje të ulëta janë të papajtueshme me etikën dhe profesionalizmin e shfaqur prej tij në gjykim.

Subjekti i rivlerësimit evidenton faktin se vendimi i tij me nr. *** regj. themeltar, datë 18.12.2017, për shkarkimin e administratores së falimentit, znj. A.Ç, pas ankimit, është “Lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. *** vendimi, datë 19.6.2018”. Më tej, informon se për shkak të mosrealizimit të detyrimit për dorëzimin e masës së falimentit

¹¹² Shkresë nr. *** prot., datë 19.5.2023, e Komisionit.

¹¹³ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. *** prot., datë 19.5.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.5.2023.

dhe akteve shkresore si një situatë e paprecedentë, fillimisht është marrë masë disiplinore ndaj saj me vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 1.4.2019, me gjobitjen me masën 50,000 lekë, në referim të nenit 45/3, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentin”, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. *** vendimi, datë 8.7.2019, nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe për të cilin Gjykata e Lartë me vendimin e saj nr. *** vendimi, datë 25.11.2020, ka vendosur “Mospranim e ankimit të paraqitur nga pala ankuese A.Ç ndaj vendimit nr. *** vendimi, datë 8.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë”. Më tej, sa citon më sipër, referon se për shkak të mosrealizimit të detyrimit për dorëzimin e masës së falimentit dhe akteve shkresore është paraqitur kallëzimi penal ndaj saj nga administratorja e falimentit që e zëvendësoi (znj. B dhe me miratimin e Komitetit të Kreditorëve), për të cilën shpjegon se është caktuar nga lista e administratorëve të falimentit të miratuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit me dakordësinë e Komitetit të Kreditorëve, duke u ngritur akuzë për pengim të ekzekutimit të vendimit dhe kjo ankuese është dënuar penalisht, për këtë qëllim me gjobë, në masën 200,000 lekë. Nisur nga pretendimi i ngritur nga denoncuesja, subjekti deklaroi se çdo aludim për raportet e tij subjektive në proces, lidhjet familjare dhe elemente të tjera me administratoren e falimentit të caktuar, znj. B, janë tërësisht të pabaza dhe aludime për të mbuluar përgjegjësinë e saj ligjore.

Në përfundim të prapësimeve lidhur me këtë denoncim, subjekti evidenton faktin se shtetasja A.Ç ka paraqitur ankim edhe në ILD ndaj tij dhe se kjo e fundit, me vendimin nr. *** prot., datë 15.3.2023, ka vendosur “Arkivimin e ankesës nr. *** prot., datë 22.2.2021 të paraqitur nga shtetësia A.Ç”, duke mos gjetur shkelje ligjore¹¹⁴.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim

Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara lidhur me çështjen objekt denoncimi, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi pretendimet e ngritura në këtë ankesë dhe si rrjedhojë nuk konstatohen problematika të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe as nuk vërehen rrethana, të tilla që, të çonin në një vlerësim negativ të mundshëm për cenim të etikes nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.

40.4 Denoncimet e shoqërisë “**” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi D.B¹¹⁵**

Nga verifikimi i kësaj ankese duket se denoncuesi ngre pretendime për çështjen e gjykuar nga gjyqtari Ervin Pollozhani, për të cilën është dhënë vendimi nr. ***, datë 24.12.2019. Më konkretisht, denoncuesi parashtron se gjyqtari Pollozhani gjatë gjykimit të kësaj çështjeje:

- i) Nuk njeh apo njeh, por nuk zbaton haptazi ligjin në kundërshtim me funksionin e dhënies së drejtësisë.
- ii) Arsyeton në mënyrë alogjike dhe interpreton me keqdashje provat në kundërshtim me parimin për kryerjen e një hetimi të thellë e të plotë gjyqësor.
- iii) Jep vendime kontradiktore duke reflektuar haptazi shkeljen e ligjit në favor të palëve të caktuara.
- iv) Nuk i ka dhënë përgjigje dhe i është shmangur analizës së një pjese të pretendimeve të ngritura nga denoncuesi, si palë e paditur në gjykim.
- v) Nuk ka analizuar faktin e provuar se shtetasja F. M nuk legjitimohet t’i kërkojë shumë prej 35,000 euro shoqërisë “****” shpk., por ajo duhet t’ia kërkojë personit të tretë K.H, pasi asaj ia ka kaluar në llogari dhe tek ajo duhet të adresonte kërkesën e saj. Gjykata ishte e detyruar të

¹¹⁴ Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar si provë të re shkresën e ILD-së që referon trajtimin e ankesës së shtetasës A. Ç.

¹¹⁵ Ankesa nr. *** prot., datë 3.2.2020 dhe ankesa e përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 5. 2.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.2.2020.

analizonte saktë marrëdhëniet juridike të krijuara ndërmjet palëve ndërgjyqëse, fakt i cili nuk është bërë as gjatë gjykimit dhe as në vendimin përfundimtar.

vi) Shuma e dytë e pretenduar nga shtetasi H.M prej 117,000 USD, konvertuar në 85,840 euro, është një veprim juridik i kryer në kushtet e përfaqësimit pa tagër. Gjykata nuk i ka hetuar, madje i ka anashkaluar provat e depozituara prej tyre në dosjen gjyqësore, të cilat vërtetonin se shoqëria “****” (sot “****” sh.p.k.) huat i merrte vetëm pas miratimit nga asambleja e përgjithshme e ortakëve dhe jo me vendim të administratorit, siç është pranuar nga gjykata për rastin objekt gjykimi.

vii) Lidhur me shumën e tretë prej 55,000 euro, të pretenduar nga paditësi H.M, Gjykata nuk ka analizuar fare as nga pikëpamja ligjore dhe as nga pikëpamja faktike, se si është vërtetuar ekzistenca e marrëdhënies juridike të huas për shumën 55,000 euro, pasi për këtë shumë nuk ekziston asnjë provë shkresore që vërteton marrëdhënien e huas. Deklarimet e personave të tretë në gjykim janë kontradiktore dhe duhet të analizoheshin në raport me fuqinë e tyre provuese.

viii) Gjatë gjykimit, gjyqtari nuk ka vlerësuar as nuk ka marrë në shqyrtim kërkesën e tyre të shpeshtë për origjinën e shumave të pretenduara të dhëna hua shoqërisë “****” sh.p.k.

ix) Grafiku i seancave të këtij gjykimi ka qenë aq i shpeshtë, duke lënë vend për dyshime të arsyeshme në kushtet e ngarkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilat është ditur që përcaktohet një seancë në muaj nga gjyqtarët, ndërkohë që gjyqtari Ervin Pollozhani ka lënë seancë çdo 3 ditë për gjykim.

x) Ka pasur qëndrim favorizues të gjyqtarit Ervin Pollozhani ndaj përfaqësuesit (avokatit J.M) të palës paditëse gjatë gjykimit.

Gjithashtu, denoncuesi pretendon se vendimi objekt ankimi është i paarsyetuar, duke cenuar parimin kushtetues, i cili kërkon shprehimisht arsyetim të vendimeve gjyqësore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga nenet 42 dhe 14/1 të Kushtetutës, si dhe në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata nuk i ka dhënë përgjigje dhe i është shmangur analizës së një pjese të pretendimeve të ngritura prej denoncuesit si palë e paditur në gjykim. Pretendon se vendimi i gjykatës është kontradiktor dhe ka kundërthënie në përmbajtjen e tij.

Parashtron se gjyqtari në vendimin e tij ka referuar se provohet me dokumentacion bankar kalimi i këtyre shumave, pra, se këto shuma kanë kaluar nga llogaria bankare e paditësve në llogarinë bankare të të paditurve përmes sistemit bankar. Nga ana tjetër, po në këtë vendim, shprehet se: *“Në datën 3.12.2013, paditësi H.M i ka paguar në dorë shumën prej 55,000 euro shoqërisë “****” edhe ky veprim i bërë në vazhden e sjelljeve reciproke dhe marrëdhënieve familjare, është bërë në mirëbesim dhe, për këtë arsye, nuk ekziston ndonjë provë shkresore, porse ky fakt u dëshmuua dhe u deklarua edhe nga personi i tretë në gjykim znj. K.H”*.

Sipas denoncuesit, deklarimet e bëra nga ana e personit të tretë K.H nuk përbëjnë pohime gjyqësore të pranuar nga palët ndërgjyqëse (paditës – të paditur), si dhe as nuk konsiderohen si dëshmi në kuptim të neneve 231-245 të Kodit të Procedurës Civile, për rrjedhim këto deklarime nuk kanë fuqi të plotë provuese, siç janë vlerësuar dhe pranuar nga Gjykata në vendimet e saj. Në vijim të këtij pretendimi, sqaron se personi i tretë në bazë të nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile konsiderohet si “pjesëmarrës” në procesin gjyqësor civil, i cili nuk përfshihet në rrethin e palëve ndërgjyqëse (paditës – i paditur), të cilët mbartin/heqin të drejta dhe detyrime nga vendimi gjyqësor, për rrjedhim edhe deklarimet e bëra nga ana e tyre në gjykim nuk konsiderohen si pohime gjyqësore në bazë të neneve 214 dhe 282 të Kodit të Procedurës Civile. Po ashtu, deklarimet e saj nuk janë as dëshmi sipas nenit 231 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pasi shtetasja K.H nuk ka marrë pjesë në gjykim në cilësinë e dëshmitarit, pasi nuk ekziston një vendim i ndërmjetëm për marrjen e provës me dëshmitarë, për rrjedhim ajo (K.H) nuk është betuar dhe pyetur në këtë cilësi (dëshmitare), fakt që tregon se deklarimet e saj nuk mund të konsiderohen si dëshmi para gjykatës.

Në vijim të këtij pretendimi, denoncuesi sqaron se *edhe sikur të pranojmë që deklaratimet e personit të tretë, znj. K.H, janë pohime gjyqësore, Gjykata, në bazë të nenit 214 të Kodit të Procedurës Civile, kishte detyrimin që këto deklarime t'i çmonte "pa nënvlerësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes"*.

Arsyetimi i Gjykatës për vlerësimin e pohimeve të znj. K.H, si provë me dëshmitarë, me argumentin se ekziston një "fillim prove me shkresë", është haptazi i kundërligjshëm. Në lidhje me këtë pretendim denoncuesi thekson se në këtë rast Gjykata ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 233, shkronja "b" e Kodit të Procedurës Civile, dispozitë e cila parashikon se: *"Rregullat e caktuara në dy nenet e mësipërme nuk zbatohen dhe lejohen prova me dëshmitarë: b) kur ka një fillim prove me shkresë"*.

Po ashtu, sipas denoncuesit, qëndrimi i Gjykatës se nuk është e nevojshme forma shkresore, pasi palët kanë qenë në "marrëdhënie të posaçme", është i pavërtetë dhe i kundërligjshëm. Në lidhje me këtë pretendim sqaron se përcaktimi *nëse jemi apo jo para marrëdhënies së posaçme, merr rëndësi vetëm nëse palët ndërgjyqëse i kërkojnë Gjykatës që një apo disa pretendime të caktuara t'i vërtetojnë nëpërmjet provës me dëshmitarë. Ky qëndrim bazohet në nenin 233, shkronja "ç" e Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: "Rregullat e caktuara në dy nenet e mësipërme nuk zbatohen dhe lejohet prova me dëshmitarë: ç) kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose marrëdhëniet të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë"*.

Sipas denoncuesit, gjatë gjykimit të kësaj mosmarrëveshjeje nuk është thirrur dhe pyetur asnjë person në cilësinë e dëshmitarit, për rrjedhim, nuk është vërtetuar marrëdhënia juridike e huas për shumën 55,000 euro. Referon se në kundërshtim me sa arsyeton Gjykata, vetëm fakti që palët kanë qenë në marrëdhënie të posaçme familjare nuk e provon *apriori* ekzistencën e marrëdhëniet juridike të pretenduara në gjykim dhe nuk i përjashton paditësit nga detyrimi për të provuar pretendimet e ngritura në gjykim, për rrjedhim, gjykata nuk ka të drejtë t'i konsiderojë të vërtetuara të gjitha pretendimet e paditësve, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Denoncuesi pretendon se në arsyetimin e saj Gjykata ka pranuar "si të mirëqena" fakte, që nuk kanë lidhje me gjykimin dhe për të cilat nuk ka asnjë provë në dosjen gjyqësore. Në përfundim, denoncuesi hedh dyshime për qëndrim favorizues të mbajtur nga gjyqtari Ervin Pollozhani në favor të palës paditëse, reflektuar edhe në dyshimin për lidhje të krijuar mes gjyqtarit dhe avokatit të palës paditëse, pasi sipas tij i janë pranuar të gjitha kërkesat e bëra.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit duke i kërkuar të japë shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij mbi këtë denoncim – për të gjitha pretendimet e ngritura nga denoncuesi dhe të provojë e referojë me dokumente justifikuese veprimet e kryera prej tij në këtë proces gjyqësor.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit

Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e prapësimeve, si dhe me shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se vendimmarrja e tij ka qenë e drejtë dhe e bazuar tërësisht në prova dhe në ligj. Referon se në dhënien e vendimit është treguar i paanshëm, duke mos favorizuar asnjërin palë, si dhe është udhëhequr si gjithmonë nga parimi i kondradiktoritetit. Deklaron se vetëm pas një hetimi të gjithanshëm, të plotë, duke marrë në shqyrtim të gjitha provat materiale dhe vetëm duke vepruar sipas/dhe në referim të ligjit, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Gjithashtu, ka parashtruar se në arsyetimin e vendimit ka analizuar faktet dhe provat e paraqitura nga palët, si dhe ka arsyetuar shkaqet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja. Ka cilësuar faktet dhe veprimet që lidhen me mosmarrëveshjen konkrete të lindur ndërmjet palëve. Në referim të neneve 6, 10, 14, 20 e vijues të Kodit të Procedurës Civile ka gjykuar dhe është shprehur vetëm mbi kërkesat e palëve, si dhe vendimmarrjen e tij e ka mbështetur vetëm mbi faktet që janë paraqitur në proces nga

palët ndërgjyqëse. Referon se zhvillimi i procesit është drejtuar duke garantuar parimin e kontradiktoritetit, në kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe në përputhje të plotë me ligjin.

Në vijim, subjekti ka argumentuar se nga i padituri në këtë proces është drejtuar kërkesa për përjashtimin e tij nga shqyrtimi i kërkesëpadisë, kërkesë e cila nuk është pranuar. Në këto kushte ka vijuar procesin gjyqësor në respektim të plotë të ligjit procedural civil dhe atij material. Referon se pala e paditur është ankuar, duke pretenduar se vendimmarrja e tij ka qenë e pabazuar në prova dhe në ligj, si dhe nuk janë marrë në shqyrtim prova të paraqitura prej tyre. Por, nga ana tjetër, ka parashtruar se provat, të cilat i nënshtrohen procesit civil janë vetëm ato që përmbushin kushtet e nenit 213 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo çdo shkresë, që nuk përmban elemente formale të kërkuara prej tij.

Subjekti ka parashtruar se pretendimet që ngre denoncuesi/ankuesi janë kryesisht të lidhura me themelin e çështjes dhe përmbajnë një analizë të vendimit gjyqësor, arsyetimit dhe konkluzionet e gjykatës, të cilat në fakt janë bërë objekt ankimi dhe janë shqyrtuar apo presin të shqyrtohen nga gjykata më të larta dhe, konkretisht, nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ndërsa, për sa i përket pretendimeve mbi mënyrën e drejtimit të procesit dhe kërkesave të pranuar apo jo të palëve në gjykim, ashtu si më lart thekson se ky gjykim është zhvilluar në respektim të plotë të drejtave të palëve ndërgjyqëse. Grafiku i seancave ka qenë në përputhje me ngarkesën e tij si gjyqtar, duke e bërë të papranueshëm çdo pretendim për “seanca të shpeshta”, siç pretendon denoncuesi, palë e cila në mënyrë të pabazuar ka tentuar në të njëjtën kohë të zvarrisë gjykimin.

Subjekti pretendon se është i papranueshëm, i paligjshëm dhe i pabazuar në asnjë provë apo rrethanë tjetër pretendimi se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje ai ka shfaqur qëndrim favorizues ndaj njëres apo tjetres palë dhe aq më pak ndaj përfaqësuesve të tyre. Deklaron se vendimmarrja e tij është bazuar vetëm mbi provat e ndodhura në dosjen gjyqësore, të trajtuara dhe të hetuara gjatë zhvillimit të procesit. Pretendimet e ngritura nga denoncuesi se ai si gjyqtar: (1) Është bazuar në fakte të provuara në procese të tjera gjyqësore; (2) Ka qenë i gatshëm të jepte me ekzekutim të përkohshëm vendimin gjyqësor për të gjitha vlerat e pretenduara; (3) Ka krijuar lidhje me avokatin e palës paditëse duke e favorizuar atë, duke i pranuar çdo kërkesë apo pyetje drejtuar ekspertëve; (4) Ka diskutuar dhe miratuar paraprakisht të gjitha kërkesat e parashtruara në gjykim në lidhje me formën dhe përmbajtjen – i konsideron shpifje të mirëfillta, të pabazuara në asnjë rrethanë konkrete të shfaqur gjatë gjykimit, për të cilat referon se janë të papajtueshme me etikën dhe profesionalizmin e shfaqur prej tij në gjykim.

Në vijim të prapësimeve të tij lidhur me këtë çështje të denoncuar, subjekti i rivlerësimit sqaron se gjatë shqyrtimit të çështjes është shprehur për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm. Gjithashtu, argumenton se është shprehur brenda një afati të arsyeshëm vetëm mbi kërkesat që janë parashtruar në padi pa kaluar kufijtë e saj, si dhe ka mbështetur vendimin në provat e paraqitura nga palët dhe të marra në seancë gjyqësore. Në këtë kontekst, referon se ligji parashikon se gjykata çmon provat që ndodhen në akte, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre të rrethanave të çështjes, por pa favorizuar asnjërën palë.

Si përfundim thekson se në këtë proces gjyqësor, por edhe në çdo rast tjetër ka trajtuar palët ndërgjyqëse në mënyrë të barabartë me kujdesin maksimal që të mos cenohen të drejtat e tyre, duke u përprjekur njëkohësisht që edhe vetë palët të perceptojnë trajtimin e tyre nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara nga procedura civile. Kjo sjellje, tërësisht e paanshme dhe me etikë maksimale, si dhe trajtimi i procesit në përgjithësi dhe i palëve në veçanti, rezulton e provuar edhe nga vendimet gjyqësore të gjyqtarëve të tjerë, të cilët kanë refuzuar kërkesat e paraqitura për përjashtimin e tij nga çështja gjyqësore.

Komisioni vëren se, edhe për këtë rast, subjekti sjell në vëmendje standardet e sipërcituara lidhur me imunitetin e magistratëve në shprehjen e opinioneve ligjore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit evidenton faktin se ky vendim për themelin e tij nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kjo e provuar sipas vërtetimit datë 12.7.2023, të kryesekretares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vërtetimit datë. 12.7.2023, të kryesekretares së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, dokumente të depozituara si prova të reja me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim

Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, shpjegimeve të depozituara nga subjekti dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk vërehen fakte apo rrethana të cilat mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektin e rivlerësimit z. Ervin Pollozhani. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim duken bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

40.5 Denoncim i shtetasit Y.K¹¹⁶

Komisioni konstaton se ky shtetas ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, e konkretisht ka bërë ankesë kundër tyre lidhur me gjykimet e zhvilluara për një mosmarrëveshje pronësie në të cilën pretendon se ishin përdorur dokumente të falsifikuara. Paralelisht me gjykimet civile, ai ka depozituar kallëzime penale. Denoncuesi sqaron se çështja në rigjykim i ra gjyqtarit Pollozhani, i cili ashtu sikurse gjyqtarja, F. B., nuk përmendi fare vendimin nr. *** akti, datë 29.1.2007 (vendim penal), por donte t'i plotësonte kërkesën palës së paditur për të bërë një ekspertim të tretë, por me kundërshtimin e tyre, nuk u bë ekspertimi i tretë. Në vijim referon se gjyqtarit i bënë një kërkesë për sigurimin e padisë, sepse i padituri mund ta prishte banesën, por ai e refuzoi kërkesën e, përfundimisht, mori vendimin nr. ***, datë 30.12.2011. Edhe ky vendim u ankimua në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Parashtron se një javë para se të fillonte gjykimi në apel, i padituri A.M prishi shtëpinë në datën 16.10.2012 dhe mbi truallin e saj filloi të ndërtojë pa leje një shtëpi dykatëshe, fakt për të cilin bëri kallëzim në Prokurori dhe njoftoi edhe Gjykatën e Apelit që po shqyrtonte çështjen. Sipas denoncuesit, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit kishin pritur me padurim prishjen e banesës sepse këtë fakt e përdorën për pushimin e gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 21.3.2013, me arsyetim skandaloz, jashtëligjor, të pambështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe në asnjë logjikë, duke hedhur dyshimet se ka qenë një vendim i ndikuar nga veprime korruptive.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur këtij denoncimi konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga gjyqtari Ervin Pollozhani, për çështjen me palë paditëse B.K, të paditur V.P, Y.K, A.M, S.M, T.B dhe ZVRPP Tiranë, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tri kontratave të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme – që duket se lidhen me një pasuri të paluajtshme të llojit apartament; zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të mësipërme – duke specifikuar veprimet konkrete që duhet të ndërmerren; dhe sigurimin e padisë, bllokimin e veprimeve në ZVRPP për pasurinë objekt gjykimi”, e cila ishte kthyer për rigjykim sipas vendimit nr. ***, datë 15.2.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në datën 30.12.2011 ka vendosur¹¹⁷: “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; (i) konstatimin tërësisht absolutisht të pavlefshëm të tri kontratave të shitblerjeve të pasurisë objekt gjykimi; (ii) zgjidhjen e pasojave të këtyre pavlefshmërie – duke specifikuar në dispozitiv pasojat që zgjidhen; (iii) rrëzimin e kërimit për sigurimin e kërkesëpadisë”.

¹¹⁶ Ankesë nr. *** prot., datë 16.3.2021.

¹¹⁷ Vendimi nr. ***, datë 30.12.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pasi kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim pala paditëse dhe palët e paditura, Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 21.3.2012, ka vendosur¹¹⁸ “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 30.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Në arsyetimin e vendimit të saj, ndër të tjera, Gjykata e Apelit parashtron se: *“Duke pasur parasysh se objekti konflikti mes palëve është e drejta mbi banesën objekt gjykimi, e drejtë kjo që nuk ekziston aktualisht në kushtet kur sendi/banesa objekt i të drejtës së pronësisë në rastin konkret nuk ekziston më (është shkatërruar), çmohet se gjykimin në rastin konkret i ka humbur lënda e tij, në rrethanat kur në mungesë të sendit/banesës objekt gjykimi nuk mund të ketë të drejtë pronësie mbi të dhe, për rrjedhojë, as konflikt në lidhje me këtë të drejtë. Në këto kushte, lidhur me kërkimin e padisë, të paraqitur si zgjidhje e pasojave të pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike objekt gjykimi nëpërmjet kthimit të sendit/banesës objekt gjykimi dhe regjistrimit të tij në pronësi të pronarëve/bashkëpronarëve, paditës B. K dhe të paditurit Y. K, gjykata e apelit ka çmuar se gjykimi i çështjes nuk mund të vazhdojë”*.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, pa dashur t’i hyjë themelit të çështjes, Komisioni i kërkoj subjektit të japë shpjegimet e tij shteruese dhe të argumentojë mbi arsyet/rrethanat/provat në të cilat u bazua për të refuzuar kërkesën për sigurimin e padisë që lidhet me çështjen objekt ankimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Me dërgimin e prapësimeve, si dhe me shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, evidenton faktin se lidhur me kërkimin për sigurimin e padisë rezulton se në vendim është shprehur se: *“Gjykata çmon se kjo pasuri e paluajtshme objekt konflikti aktualisht në ZRPP figuron me barrë hipotekore për llogari të T.B dhe nuk ekziston asnjë mundësi efektive që ajo të mund të tjetërsohet, pa miratimin e bankës. Po kështu, duke qenë se referuar edhe kësaj vendimmarrjeje, ekzekutimi nuk provohet se mund të bëhet i vështirë apo i pamundur për t’u kryer, atëherë për këtë kërkim gjykata çmon të mos e pranojë atë pasi e gjen të pabazuar në prova dhe në ligj”*. Në këtë kontekst deklaroi se arsyet e vetme për refuzimin e marrjes së kësaj mase sigurimi janë këto të shprehura në pjesën arsyetuese të vendimit dhe asnjë arsye tjetër.

Në vijim të prapësimeve ka sqaruar se kërkitimi i sigurimit të padisë si pjesë e objektit të kërkesëpadisë ka qenë vetëm në lidhje me urdhërimin e gjykatës për mostjetërsimin e kësaj pasurie tek të tretët dhe pasqyrimin e saj në ZVRPP (moskryerjen e veprimeve juridike shitblerjeje të mëtejshme) dhe jo kërkitimi për ndalimin e prishjes fizike të saj, etj. Në këtë kuptim, pretendon se gjykata nuk ka pasur asnjë *indicie* gjatë procesit gjyqësor për fatin fizik të sendit, aq më tepër që ky proces prishjeje i sendit ka ndodhur sipas pjesës arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Apelit vetëm në datën 16.10.2012, pra kohë pasi është shpallur vendimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (shpallur më 30.12.2011). Në këtë kontekst referon se mosmarrja e masës së sigurimit të padisë apo edhe nëse ajo do të merrej, nuk do të kishte asnjë efekt mbi procesin e prishjes së ndërtesës që ka ndodhur më pas. Si përfundim parashtron se nëse pala ankuese e ka pasur *indicien* për këtë veprim (prishjen), ka pasur gjithë të drejtën për të paraqitur kërkesë përsëri në kohë reale për sigurimin e padisë me objekt të posaçëm në gjykatën në të cilën ndodhej çështja (në Gjykatën e Apelit), gjë që rezulton se nuk e ka kryer.

Komisioni vëren se edhe për këtë rast, subjekti shprehet se një ndër standardet më të rëndësishme në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale është garantimi i opinionëve ligjore të shprehura në vendimmarrje nga magjistratët gjatë punës së tyre, të cilat janë objekt vlerësimi nga Komisioni apo Kolegji. Gjithashtu, subjekti evidenton faktin se denoncuesi ka paraqitur ankim edhe në ILD ndaj tij dhe se kjo e fundit, me vendimin nr. *** prot., datë

¹¹⁸ Vendimi nr. ***, datë 21.3.2012, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

17.6.2021, ka vendosur “Arkivimin e ankesës nr. *** prot., datë 16.3.2021, të paraqitur nga shtetasi Y.K”, duke mos gjetur asnjë shkelje¹¹⁹.

Vlerësimi i përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim

Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara lidhur me çështjen objekt denoncimi, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi pretendimet e ngritura në këtë ankesë dhe si rrjedhojë nuk konstatohen problematika të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale.

40.6 Denoncim i shtetasit P. L¹²⁰

Denoncuesi hedh dyshime se në çështjen gjyqësore të gjykuar nga gjyqtari Ervin Pollozhani, i ndikuar nga veprime korruptive, ka caktuar avokatin e palës tjetër nëpërmjet sekretares gjyqësore. Ai pretendon se ka pasur zvarritje të gjykimit. Në vijim të ankesës së bërë denoncuesi referon se këtij gjyqtari i janë rrëzuar shumë vendime nga apeli, duke pretenduar se raporti i vendimeve të prishura rezulton të jetë shumë i lartë. Gjithashtu, ai hedh dyshime se nga ana e këtij gjyqtari ka pasur përfitim të paligjshëm të pasurisë, por pa referuar të dhënë konkrete.

Pas kërkesës së bërë nga Komisioni¹²¹, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm¹²² ka dërguar dosjen gjyqësore me nr. *** vendimi, datë 25.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që lidhet me çështjen objekt denoncimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga anëtarët e trupit gjykues – gjyqtarët Ervin Pollozhani, A. K., dhe N. C. për çështjen me palë paditëse P.L, me palë të paditur R.P, me objekt: “1. Përbushjen e detyrimit në shumën prej 120,000 euro të njohur me deklaratën noteriale, datë 23.10.2012 dhe kamatëvonesat në vlerën prej 20,608 euro sipas aktit të ekspertimit të ekspertes...2. Detyrimin e të paditurit të paguajë kamatëvonesat sipas interesit bankar të Bankës së Shqipërisë nga data 6.7.2018 e në vazhdim deri në momentin e ekzekutimit përfundimtar etj.”, në datën 25.3.2019 ka vendosur¹²³ rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, si edhe heqjen e masës së sigurimit të padisë të dhënë me vendimin nr. *** (***), datë 20.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësi, shtetasi P. L (ankim i depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 5.4.2019). Duket se kjo çështje nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Apelit.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi dhe materialeve të administruara në këtë kuadër, duket se nuk vërehen fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova për gjetje thelbësore në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.

Sa i përket pretendimit për zvarritje të gjykimit, bazuar në të dhënat e evidentuara në vendimin e sipërcituar, duket se gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore civile nga subjekti i rivlerësimit nuk është realizuar në respektim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij mbi këtë denoncim – si dhe të provojë e referojë me dokumente justifikuese veprimet e kryera prej tij në shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore

¹¹⁹ Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar si provë të re shkresën e ILD-së që referon trajtimin e ankesës së shtetasit Y.K.

¹²⁰ Ankesë nr. *** prot., datë 14.1.2022.

¹²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2023, e Komisionit.

¹²² Shkresa e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. *** prot., datë 16.6.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.6.2023.

¹²³ Vendimi nr. ***, datë 25.3.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

civile, që nga momenti i marrjes në dorëzim të kërkesëpadiisë/ve deri në dhënien e vendimit, në përpjekje për ta shqyrtuar këtë çështje brenda afateve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e propozimeve, si dhe me shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se vendimmarrja e tij ka qenë e drejtë dhe e bazuar tërësisht në prova dhe në ligj. Referon se në dhënien e vendimit është treguar i paanshëm, duke mos favorizuar asnjërën palë, si dhe është udhëhequr si gjithmonë nga parimi i kontradiktoritetit. Deklaron se vetëm pas një hetimi të gjithanshëm, të plotë, duke marrë në shqyrtim të gjitha provat materiale dhe vetëm duke vepruar sipas/dhe në referim të ligjit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadiisë. Ndërsa, për vonesën në përfundimin e gjykimit, konkretisht, në lidhje me këtë pretendim, si dhe në rastin e mësipërm kërkon që të mbahet parasysh vendimi nr. 2, datë 17.2.2022, i Gjykatës Kushtetuese e, po kështu, edhe vendimi nr. ***, datë 5.7.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimi i GJEDNJ-së, në çështjen B dhe K kundër Shqipërisë, bërë përfundimtar në datën 28.2.2022.

Krahas sa ka argumentuar më sipër, kërkon të mbahet parasysh se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar gjykimin brenda afateve ligjore (çfarë mund të vërehet në caktimin e aq seancave sa ka vlerësuar të nevojshme për të zgjidhur çështjen). Në këtë drejtim pretendon se nuk kanë qenë veprimet e tij si gjyqtar ato që kanë sjellë vonesën në përfundimin e gjykimit të çështjes, por rrethana të tjera që referuar procesverbalit të seancave respektive, konstatohet si vijon:

- Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.7.2017, pasi ka ardhur me vendim për moskompetencë tokësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pranë gjyqtarës E. C, e cila ka caktuar seancën e parë gjyqësore në datën 18.9.2017. Në këtë datë, kjo gjyqtare ka paraqitur dorëheqjen për shkaqe objektive dhe çështja ka kaluar për shqyrtim pranë gjyqtarës B.K.

- Gjyqtarja Brunilda Kadi ka caktuar seancën e parë përgatitore, më 28.9.2017, dhe nga ana e saj janë zhvilluar në vijim 4 seanca përgatitore dhe vetëm me vendimin e datës 21.12.2017 ka kaluar për shqyrtim çështja në seancë gjyqësore për në datën 7.2.2018, me trup gjykues të kryesuar prej gjyqtarës B. K dhe anëtarë, gjyqtarët Ervin Pollozhani dhe A.K.

- Pra, evidenton faktin se vetëm në seancën gjyqësore të datës 7.2.2018, ai është bërë pjesë e trupës gjyqësore të kësaj çështjeje, fillimisht, me cilësinë e anëtarit të saj. Sqaron se seanca e kësaj date (7.2.2018) nuk është zhvilluar, pasi anëtarja e trupës gjykuese, znj. A.K, nuk është paraqitur në punë (rast vdekjeje) sipas procesverbalit të mbajtur në audio dhe seanca e radhës është caktuar për në datën 4.4.2018. Referon se edhe kjo seancë gjyqësore nuk është zhvilluar përsëri për të njëjtat shkaqe (mosformim trupi gjykues për shkak të mungesës së gjyqtarës A.K – për arsye shëndetësore).

- Parashtron se në vijimësi janë zhvilluar seancat gjyqësore ku, trupi gjykues, në bazë të kërkesave procedurale të palës paditëse që lidhen me objektin e padiisë, ka disponuar me caktimin e ekspertës, thirrjen dhe betimin e saj dhe dhënien e detyrave e, më pas, me marrjen e aktit të ekspertimit dhe dhënien kohë të palëve për t'u njohur me aktin, veprime procedurale të gjitha këto të kryera në intervalin e disa seancave gjyqësore deri në datën 26.7.2018.

- Gjithashtu, referon se seancat vijuese janë shtyrë për kërkesa procedurale të palës paditëse për saktësimin e objektit të padiisë, ndërkohë që më tej gjyqtarja kryesuese e trupës gjykuese B. K, për shkak të zgjedhjes së saj si anëtare e KLGJ-së, për shkak të përcaktimit ligjor, ka dhënë dorëheqjen nga kjo çështje. Në vijim, çështja nga kancelari/kryesekretaria është hedhur në short, ku kryesues është caktuar gjyqtari A. F. Ky i fundit, në seancën që ka caktuar dhe ka njoftuar anëtarët për në datën 1.2.2019, e në këtë seancë ka kërkuar të jepte dorëheqjen në kushtet kur nuk do të duhet të ishte ai kryesuesi, pasi sipas rregullores kryesimi i dosjes duhej

të merrej nga njëri nga anëtarët e mbetur (znj. K ose z. P). Pas kësaj kërkesë të pranuar nga ana e Kryetarit për heqjen dorë edhe nga gjyqtar i çështjes, me shortin dhe procesverbalin e datës 8.2.2019, subjekti deklaroi se është caktuar ai me cilësinë e kryesuesit të trupës dhe, më tej, në datën 11.2.2019, ka kërkuar plotësimin e trupës gjyqësore me anëtarin e ri që, si i tillë, është caktuar gjyqtari N.C, kjo sipas procesverbalit të datës 14.2.2019. Referon se vetëm në datën 11.3.2019 është zhvilluar seanca vijuese me trup gjyqësor të përbërë me kryesues gjyqtarin Ervin Pollozhani dhe anëtarët A.K dhe N. C. Pas këtij momenti, në kushtet kur anëtari i ri në referim të nenit 181 të Kodit të Procedurës Civile ka kërkuar që të vazhdojë gjykimi në gjendjen që ndodhen aktet, janë zhvilluar vetëm dy seanca gjyqësore dhe janë administruar provat dhe, më pas, është shpallur vendimi në datën 25.3.2019.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se referuar gjithë kronologjisë së veprimeve procedurale, si dhe referuar procesverbaleve të çdo seance të sipërcituar, çmon se që nga momenti i marrjes së cilësisë së kryesuesit të çështjes nuk ka kryer asnjë zvarritje të këtij gjykimi, përkundrazi pretendon se me shumë rigorozitet është përpjekur të përfundojë procesin brenda gjithë mundësive dhe afateve ligjore në kohën që është caktuar si kryesues i trupës gjyqësore. Thënë këto, deklaroi se e rëndësishme është që, nuk ka ndonjë veprim procedural të parashikuar nga ligji që ai ta këtë anashkaluar apo duhej dhe ai nuk e ka kryer.

Gjithashtu, subjekti ka evidentuar faktin se ky vendim nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kjo e provuar sipas vërtetimit datë 3.7.2023, të kryesekretares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, depozituar si provë nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim

Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, shpjegimeve të depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit si edhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjyqësor arrin në përfundimin se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim duken bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

41. Për sa më sipër, Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet prapësimet e subjektit të rivlerësimit të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse, çmon se ai ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor sa i përket gjetjeve të evidentuara në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e depozituara nga publiku, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

42. Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

43. Trupi gjyqësor vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe në rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga prej tij, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 24.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Pamela QIRKO
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

Tabela përmbledhëse e analizë financiare - sipas periudhave përkatëse. Vlerat në Lek.	1.10.2001 - 30.9.2005	1.10.2005 - 31.12.2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	650,000	358	204,762	15,401,016	446,885	962,348	1,429,326	1,329,442	4,186,071	2,538,070	18,106,484	-539,898	-535,621
Automjet ***, vit prodhimi 1985, blerë në datë 18.1.2004.	250,000												
Automjet ***, vit prodhimi 1994, blerë në datë 17.8.2006.			200,000										
Apartament me sipërfaqe 117 m2, rruga ****, porositur nga shoqëria **** sh.p.k., datë 18.9.2007.				14,146,470									
Automjet ***, vit prodhimi 2002, blerë në datë 23.7.2008.					964,424	40,000							
Automjet ***, vit prodhimi 2003, blerë në datë 4.5.2009.						1,000,000							
Automjet ***, vit prodhimi 2003, blerë në datë 29.9.2010.							300,000						
Automjet ***, vit prodhimi 2006, blerë në datë 27.10.2010.							1,000,000						
Automjet ***, vit prodhimi 2007, blerë në datë 16.2.2011.								1,100,000					
Automjet ***, vit prodhimi 2010, blerë në datë 11.1.2013										1,628,374			
Apartament me sipërfaqe 113 m2, rruga ***, prorositur nga shoqëria **** sh.p.k., datë 22.9.2014.											15,131,880		1,623,240
Automjet ***, vit prodhimi 2010, blerë në datë 17.1.2015.												400,000	
Automjet ***, vit prodhimi 2006, blerë në datë 8.7.2015.												500,000	
Ndryshim likuiditeti	400,000	358	4,762	1,254,546	-517,539	-77,652	129,326	229,442	4,186,071	909,696	2,974,604	-1,439,898	-2,158,861
B) Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) Pasuri neto (A-B)	650,000	358	204,762	15,401,016	446,885	962,348	1,429,326	1,329,442	4,186,071	2,538,070	18,106,484	-539,898	-535,621
D) Të ardhura	1,408,057	218,889	955,287	15,625,781	1,562,662	2,180,992	2,209,237	2,331,670	5,868,341	3,672,067	20,191,344	3,557,465	2,023,418
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, subjekti rivlerësimi	921,675				38,880					21,600		35,888	
Të ardhura nga paga si jurist pranë Parkut Urban të Udhëtarëve, Bashkia Tiranë (subjekti rivlerësimi)	334,414												
Të ardhura nga paga si jurist pranë Shërbimit Lëvizës Falas, Tiranë (subjekti rivlerësimi)	151,968												
Të ardhura nga paga si gjyqtar, subjekti rivlerësimi.		180,189	815,607	851,241	804,926	819,986	825,123	873,251	861,714	857,500	1,048,876	1,123,329	1,142,192
Të ardhura nga paga si pedagog, subjekti rivlerësimi.		38,700	139,680	128,070	71,460	24,840		33,096		137,200			
Të ardhura nga paga FSHF, subjekti rivlerësimi.									27,000	45,000			
Të ardhura nga I. F.C (***)subjekti rivlerësimi.												375,000	
Të ardhura nga ***										119,000			
Të ardhura nga bashkëshortja para martesës (për blerjen e pasurisë së paluajtshme 117,000 euro).				14,146,470									
Të ardhura nga paga bashkëshortja (DFSDKSH Tropojë).													
Të ardhura nga paga bashkëshortja (Qendra Shëndetësore B/Tropojë).					533,711								
Të ardhura nga paga bashkëshortja (përfaqësues mjekësor).													
Të ardhura nga paga bashkëshortja (QSUT).					76,591	336,166	384,114	425,323	533,627	766,900	714,811	652,703	710,501
Të ardhura nga interesat e depozitës në ISP Bank					37,094					346,962			
Të ardhura nga interesat e depozitës në Credins Bank										177,905	213,357	170,545	170,725
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 1985, shitur në datë 15.2.2007.				250,000									
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 1994, shitur në datë 21.11.2007.				250,000									
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 2002, shitur në datë 9.5.2009.							1,000,000						
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 2003, shitur në datë 25.10.2010.								1,000,000					
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 2006, shitur në datë 11.2.2011.									1,000,000				
Të ardhura sipas deklaratës notoriale të **** sh.p.k., me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2012.									4,446,000				
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 2007, shitur në datë 11.1.2013.										1,200,000			
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 117 m2, rruga ****, datë 28.8.2014.											18,214,300		
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 2003, shitur në datë 17.1.2015.												250,000	
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, vit prodhimi 2010, shitur në datë 1.7.2015.												950,000	
E) Shpenzime	454,388	49,446	177,594	136,620	783,778	757,950	692,731	620,076	494,329	618,665	897,658	2,869,854	2,283,954
Shpenzime jetike	399,890	27,389	109,557	136,620	193,545	273,240	364,320	409,860	423,072	423,072	714,994	897,104	940,368
Shpenzime për qiranë e apartamentit në Tiranë											100,000	150,000	
Shpenzime për mobilimin e apartamentit të porositur 18.9.2007, tek **** sh.p.k.					318,000	364,000	318,000						
Shpenzime për mobilimin e apartamentit të porositur 22.9.2014, tek **** sh.p.k.												1,822,750	1,000,000
Shpenzime shkollimi për djalin, inst.arsimor ****.													283,391
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	54,498	22,057	68,037	0	272,233	120,710	10,411	210,216	71,257	195,593	82,665	0	60,195
Balanca e fondeve (D-C-E)	303,669	169,085	572,931	88,145	331,999	460,694	87,180	382,152	1,187,941	515,332	1,187,202	1,227,509	275,085